



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në

“Logopedi” ofruar nga

Institucioni i Arsimit të Lartë

Universiteti i Mjekësisë, Tiranë

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Gjergj Koja

2. Dr. Glodiana Sinanaj

Tetor/ 2024

**Për Programin e studimit Master i shkencave në “Logopedi” ofruar nga Institucioni i
Arsimit të Lartë Universiteti i Mjekësisë, Tiranë**

Nr.		
1	IAL aplikues:	Universiteti i Mjekësisë Tiranë
2	Njësia bazë që e ofron:	1. Departamenti i Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor dhe Infermieristikës në Kirurgji dhe në Obstetrikë Gjinekologji; 2. Departamenti i Lëndëve Klinike dhe Infermieristikës së Përgjithshme dhe Infermieristikës në Sëmundje të Brendshme dhe në Pediatri; 3. Departamenti i Lëndëve Paraklinike
3	Emërtimi i programit të studimit:	Master i Shkencave në “Logopedi”
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	VKM Nr. 744, date 05.09.2013
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	UMAS Nr. 151 datë 30.03.2016
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër nr. 105, datë 12.07.2018
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	-
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	2 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	120 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	-
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 7
17	Stafi akademik PAE/ PAK për programin e studimit:	11 PAE



		9 SSHU ¹ 11 PAK
18	Numri i studentëve: (3 vitet e fundit)	20 studentë
19	Komente / të tjera:	

PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN MASTER SHKENCOR NË LOGOPEDI

UMT si institucion publik i arsimit të lartë mjekësor në Shqipëri formon profesionistë të shëndetit, të aftë për të përballuar sfidat e zhvillimit në fushat e shkencave mjekësore. [Evidenca 170 Plani strategjik i zhvillimit të UMT 2021-2024]. Fakulteti i cili ushtron veprimtarinë e tij në pajtim me Kushtetutën, Ligjin 80-2015 [Evidenca 5 Rregullore e FSHMT-Neni 2] dhe që ka numrin më të madh të studentëve-3000 studentë aktiv por edhe numrin më të madh të programeve të studimeve është FSHMT. Përbëhet nga tre njësi bazë dhe rreth 348 personel akademik të punësuar në këto njësi. Masteri Shkencor në Logopedi është program Studimi i Ciklit të dytë të Studimeve që ofrohet në Fakultetin e Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë Tiranë, është hapur me Vendim të KM nr. 744, datë 5.9.2013 Për kuotat e pranimit dhe tarifat e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve, me kohë të plotë “Master i shkencave” për vitin akademik 2013 – 2014. Programi i studimit Master Shkencor në Logopedi është hartuar bazuar në ligjin nr.80/2015” Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me Strategjinë kombëtare të zhvillimit, interesin kombëtar, strategjinë e zhvillimit institucional të UMT dhe FSHMT, Strategjinë kombëtare të punësimit, Strategjinë kombëtare për shkencën si dhe me fushën dhe veprimtarinë e FSHMT. Masteri Shkencor Logopedi zgjat 2 vite, 4 semestra akademikë me kohë të plotë, me 120 kredite në total. Mbarëvajtja e veprimtarisë së programit Master Shkencor monitorohet nga autoritetet drejtuese përkatëse. Programi i studimit Master shkencor në Logopedi ka qëllim të pajisë studentët me njohuri të mira të teknikave dhe metodave të reja të trajtimit rehabilitues logopedik në pacientët me patologji të ndryshme, trajtimit ambulator dhe hospitalor të tyre. Ky program formon logopedistë profesionistë me njohuri të thella lidhur me zhvillimin gjuhësor, problematikat që prekin gjuhën receptive dhe gjuhën ekspresive gjatë moshës evolutive të pacientët pediatrikë dhe adultë me çrregullime të të folurit. Programi e zhvillon veprimtarinë e tij në bazë të parimeve të lirisë dhe cilësisë akademike. [Evidenca 21 Rregullore Msc Logopedi]. Programi ofrohet nga 3 departamente: 1. Departamenti i Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor dhe Infermieristikës në Kirurgji dhe në Obstetrikë Gjinekologji; 2. Departamenti i Lëndëve Klinike dhe Infermieristikës së Përgjithshme dhe Infermieristikës në Sëmundje të Brendshme dhe në Pediatri; 3. Departamenti i Lëndëve Paraklinike.

¹ Struktura shëndetësore universitare (SSHU) spitalore dhe jospitalore të rregulluara me VKM të posaçme



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Raporti i Vlerësimit të Jashtëm është dokument i hartuar në kuadër të akreditimit të programit të studimit Msc. në “Logopedi” i ofruar nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike në Universitetin e Mjekësisë Tiranë. Ky Raport Vlerësimi përmbledh procedurën e realizimit të këtij procesi, vlerësimin përkundrejt standarteve dhe kriterëve për programin e studimit, pjesë e Kodit të Cilësisë së Arsimit të Lartë miratuar me VKM, konstatimet, gjetjet dhe vlerësimin për çdo fushë studimi. Vlerësimi i jashtëm është fokusuar në 6 fusha vlerësimi:

- I. Ofrimi i programit të studimeve,
- II. Organizimi, drejtimi dhe administrimi i programit të ciklit të dytë;
- III. Mësimdhënia, mësimnxënia, vlerësimi dhe kompetencat;
- IV. Burimet njerëzore, financiare, infrastruktura, logjistika për realizimin e programit të studimit;
- V. Studentët dhe mbështetja e tyre;
- VI. Sigurimi i cilësisë së programit të studimit.

Shkalla e përmbushjes për çdo fushë është përcaktuar sipas 4 niveleve:

- Standartet nuk përmbushen;
- Standartet përmbushen pjesërisht;
- Standartet përmbushen kryesisht;
- Standartet përmbushen plotësisht;

Bazuar në hartimin e raporteve dhe gjykimëve të arritura janë analizuar, studiuar dhe shqyrtuar shumë dokumente dhe informacione të cilat institucioni i vendosi në dispozicion në faza të ndryshme të vlerësimit të jashtëm nga ASCAL si dhe u aksesuan informacione të publikuara në faqen zyrtare të institucionit. Procesi i vlerësimit është koordinuar nga Koordinatori Teknik i ASCAL nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit AMS.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm është i përbërë nga Dr. Gjergj Koja, Dr. Glodiana Sinanaj. Koordinatorë Teknike e ASCAL për këtë process vlerësimi është Msc. Aviola Bardhi.

Bazuar në afatet e përcaktuara dhe në procedurën e vlerësimit, procesi u realizua në disa faza:

- Vlerësimi i brendshëm ku institucioni ka dorëzuar dosjen e vetëvlerësimit, ku përfshihet Raporti i Vlerësimit të Brendshëm dhe dokumentacioni mbështetës (DVV). Gjatë kësaj faze janë kërkuar nga ASCAL saktësime dhe plotësime në dokumentacionin e dërguar.
- Shqyrtimi i raportit dhe dokumentacionit, përgatitja e materialeve për vizitën në institucion. Në këtë fazë janë kryer takime, janë hartuar draftet paraprake, është propozuar axhenda e vlerësimeve dhe lista e pyetjeve të mundshme sipas takimeve përkatëse.
- Vizita në FSHMT e zhvilluar në datat 5-6 Mars 2024. Në institucion janë kryer mjaft takime të rëndësishme me aktorë dhe faktorë të institucionit në funksion të programit të studimit.



- Hartimi i raportit paraprak dhe finalizimi i tij.

Informacionet e mbledhura dhe të shqyrtuara në këtë fazë të procesit kanë ndihmuar GVJ të arrijë në konkluzionet e veta mbi nivelin e përmbushjes së standarteve për këtë program studimi.

Konstatimet, gjetjet dhe vlerësimet pasqyrojnë me korrektësi, qartësi, paanësi dhe profesionalizëm cilësinë në të cilën ofrohet aktualisht programi i studimit Msc. në Logopedi nga ana e FSHMT.

GVJ vlerëson maksimalisht dhe pozitivisht angazhimin e gjithë institucionit, Grupin e Vlerësimit të Brendshëm dhe personelin akademik për gadishmërinë e treguar në dhënien e informacioneve të kërkuara në funksion të procesit të vlerësimit të jashtëm gjatë vizitës në institucion.

Më datë 19.09.2024, përmes sistemit AMS dhe me shkresë zyrtare Nr. 86/28 Prot., datë 19.09.2024, dërgohet në Institucion Draft- Raporti i Vlerësimit të Jashtëm.

Universiteti i Mjekësisë kthehu përgjigje në sistemin AMS më datë 26.09.2024 dhe me shkresë zyrtare Nr. 315/20, datë 27.09.2024.

IAL nuk ka komente mbi draftin, kështu drafti kthehet në raport final.



Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Dytë Master i Shkencave në “Logopedi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi I.1	
Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare, si dhe në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të tij.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Programi Master i Shkencave në Logopedi i ofruar nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë Tiranë është hapur si program studimi Diplomë e Nivelit të Dytë në vitin 2013 me VKM Nr. 744, datë 05.09.2013. IAL ka deklaruar në AMS se programi ofrohet nga 3 departamente: 1. Departamenti i Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor dhe Infermieristikës në Kirurgji dhe në Obstetrikë Gjinekologji; 2. Departamenti i Lëndëve Klinike dhe Infermieristikës së Përgjithshme dhe Infermieristikës në Sëmundje të Brendshme dhe në Pediatri; 3. Departamenti i Lëndëve Paraklinike. Programi ka qëllim të formojë logopedistë profesionistë me njohuri të mira të teknikave dhe metodave të reja të trajtimit rehabilitues –logopedike, në pacientët me patologji të ndryshme, trajtimin ambulator dhe hospitalor të tyre si dhe kompetencë të lartë në njohuritë e etikës dhe deontologjisë profesionale, legjislacionit mjekësor dhe ruajtjen e sekretit profesional. Programet që ofron Institucioni janë në përputhje me interesat dhe strategjitë kombëtare të zhvillimit të vendit dhe në përputhje me profilin e institucionit. Programet e studimit të ofruara nga institucioni kanë si synim ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare dhe janë në përputhje të plotë me misionin e UMT si dhe objektikat dhe fushën e veprimtarisë së FSHMT. [Evidenca 1 Statuti UMT]. [Evidenca 2 Rregullore UMT]. [Evidenca 5 Rregullore e FSHMT-Neni 2]. [Evidenca 21 Rregullore Msc Logopedi]. [Evidenca 170 Plani Strategjik i Zhvillimit të UMT].
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Referuar dokumentacionit mbështetës dhe RVB, GVJ konstaton se programi i studimit MSC në logopedi i hartuar, është në përputhje të plotë me qëllimet dhe misionin e institucionit UMT dhe fushës së veprimtarisë së FSHMT sipas akteve ligjore dhe rregullatore të IAL. Misioni ka për qëllim zhvillimin e arsimit cilësor, edukimit dhe kërkimit-shkencor në fushën e mjekësisë. Mbarëvajtja e veprimtarisë së programit Msc në logopedi monitorohet nga autoritetet drejtuese përkatëse. Programi Msc në logopedi u mundëson studentëve aftësi profesionale të përparuara në trajtimin e situatave mjekësore logopedike, njohjen e teknikave dhe metodave të ndryshme rehabilituese për trajtimin e grupmoshave të

	ndryshme të pacientëve. Institucioni u ofron studentëve përveç tre cikleve të studimit tashmë për vitin akademik 2023-2024 Doktoraturë në logopedi dhe Rehabilitim mbështetur në kodin 0915 i ISCED 2013. [Evidenca 1 Statuti UMT]. [Evidenca 2 Rregullore UMT]. [Evidenca 170 Plan Strategjik i Zhvillimit të UMT]. [Evidenca 21 Rregullore Msc Logopedi]. [Evidenca 206 ISCED].
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit dhe në përputhje me fushat e drejtimet akademike së Institucionit.	FSHMT ofron programin e studimit Msc në “Logopedi” duke u bazuar në misionin, objektivat e institucionit ku objektivi kryesor përkon me formimin e profesionistëve të shëndetit të aftë për të përballuar sfidat e zhvillimit në fushat e shkencave mjekësore. Programi i integruar i nivelit të dytë synon pajisjen e studentëve me njohuri të thelluara teorike dhe praktike në fushën e mjekësisë, njohuri të mira të teknikave dhe metodave të reja të trajtimit reabilitues logopedike, në pacientët me patologji të ndryshme, trajtimit ambulator dhe hospitalor të tyre. Programi Msc Logopedi është hartuar dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të Strategjisë për Zhvillim, Rregulloren dhe Statutin e Institucionit mbështetur në drejtimet dhe fushat akademike. Për vitin akademik 2023-2024 në këtë program studimi janë të regjistruar në Ciklin e Dytë të studimeve 21 studentë. [Evidenca 1 Statuti UMT]. [Evidenca 2 Rregullore UMT]. [Evidenca 5 Rregullore e FSHMT]. [Evidenca 170 Plan Strategjik i Zhvillimit të UMT]. [Evidenca 202 Lista e futesve Msc 2023-2024].
Kriteri 4. Programi i studimit hartohet e zhvillohet në përputhje me strategjitë kombëtare të zhvillimit, interesit kombëtar dhe prirjet globale të zhvillimit mbështetur në dokumentacionin përkatës vendas dhe atë ndërkombëtar.	UMT ofron formimin dhe edukimin e profesionistëve të shëndetit në të tre ciklet e edukimit sipas standarteve më të larta profesionale si dhe formon specialistë të kualifikuar për brenda dhe jashtë vendit. Mbështet prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të sistemit shëndetësor në vend, duke frymëzuar dhe promovuar risitë në fushën e shkencave mjekësore. UMT ofron 94 programe studimi nga niveli i parë te niveli i tretë. Programi i studimit Master Shkencor në Logopedi është hartuar bazuar në ligjin nr.80/2015” Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në intitucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, në përputhje me Strategjinë kombëtare të zhvillimit, interesin kombëtar, strategjinë e zhvillimit institucional të UMT dhe FSHMT, Strategjinë kombëtare të punësimit, Strategjinë kombëtare për shkencën si dhe me fushën dhe veprimtarinë e FSHMT. [Evidenca 170 Plan Strategjik i Zhvillimit të UMT]. [Evidenca 86 Program Msc Logopedi]. [Evidenca 91 Plan mësimor Msc logopedi].
Konkluzione	Msc në logopedi është hartuar konform misionit dhe qëllimeve të UMT, fushës akademike dhe veprimtarisë së FSHMT si dhe njësisë bazë

	përgjegjëse për programin e studimit që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike të njësive kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	UMT është qendra më e madhe mësimdhënëse publike e formimit universitar dhe pasuniversitar në shkencat mjekësore në vendin tonë, që ofron ekspertizën profesionale më të lartë në didaktikë, kërkim shkencor dhe përgatitjen e specialistëve të të gjitha fushave të mjekësisë. Formon dhe edukon profesionistë të shëndetit në të tre ciklet e edukimit sipas standarteve më të larta profesionale si dhe të formojë specialistë të kualifikuar. Mbështet prioritetet strategjike dhe interesat e zhvillimit të sistemit shëndetësor në vend, duke frymëzuar dhe promovuar risitë në fushën e shkencave mjekësore. Është i vetmi institucion në vend në fushën e mjekësisë që ka përgjegjësinë e mësimin, krijimit dhe daljes së profesionistëve të rinj në fushën e mjekësisë të cilët ofrojnë shërbime cilësore në vend. UMT me një eksperiencë të gjatë në ofrimin e programeve, është një institucion i arsimit të lartë i licensuar me VKM Nr. 48, datë 23.01.2013, riorganizuar me UMAS Nr. 151 datë 30.03.2016. Sipas deklaratimit të IAL, ky program ofrohet nga 3 departamente: 1. Departamenti i Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor dhe Infermieristikës në Kirurgji dhe në Obstetrikë Gjinekologji; 2. Departamenti i Lëndëve Klinike dhe Infermieristikës së Përgjithshme dhe Infermieristikës në Sëmundje të Brendshme dhe në Pediatri; 3. Departamenti i Lëndëve Paraklinike (Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike). Universiteti i Mjekësisë, Tiranë përbëhet nga 4 njësi kryesore. Kjo tregon se institucioni ka krijuar profilin e vet në mënyrën e organizimit, funksionimit dhe përmirësimit të kapaciteteve infrastrukturore, që disponon dhe burime njerëzore në staf akademik dhe mbështetës. Programi Msc në Logopedi është hapur me VKM Nr. 744, datë 05.09.2013 Për kuotat e pranimin dhe tarifën e shkollimit në institucionet publike të arsimit të lartë për ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë "Master i Shkencave" për vitin akademik 2013-2014. Ky program realizohet në FSHMT. Institucioni ka kapacitetet, burimet e duhura në fushën akademike, burimet financiare dhe logjistike që mundësojnë ofrimin e programit. GVJ konstaton se pikë e rëndësishme është infrastruktura që disponon institucioni për realizimin e praktikave mësimore në dispozicion të studentëve, të cilat ndihmojnë në njohuritë e

	marra nga studentët dhe praktikimin e aftësive.GVJ konstatoi se institucioni ka kapacitete akademike të mjaftueshme ku shumica e lëndëve mbulohen jo vetëm nga stafi akademik efektiv por dhe ai me kontratë. FSHMT ka staf akademik në fushën e mjekësisë që zotërojnë tituj dhe grada shkencore. Fakulteti i Shkencave Mjekesore Teknike për vitin akademik aktual 2023-2024 në të tre departamentet ka 69 personel akademik PAE dhe 260 personel akademik PAK. Për zhvillimin e programit të studimit Msc në Logopedi për vitin akademik 2023-2024 angazhohen 10 personel akademik PAE dhe 21 personel akademik PAK. Për realizmin e praktikës profesionale të studentëve FSHMT dhe UMT kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetësore shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë si QSUNT, KLINIKA “PROGRES”, KLINIKA “ANTIGONI THE TALK DOC”, Spitali “Shefqet Ndroqi”, Materniteti “Koço Gliozheni”, Materniteti “Mbretëresha Geraldinë”. [Evidenca 1 Statuti UMT]. [Evidenca 2 Rregullore UMT]. [Evidenca 5 Rregullore e FSHMT]. [Evidenca 202 Lista e fituesve Msc 2023-2024]. [Evidenca 97 Tabela përmbledhëse ASCAL logopedi Msc i rishikuar]. [Evidenca 122 Marrëveshje bashkëpunimi praktika logopedi]. [Evidenca 118 Infrastruktura në funksion të mësimdhënies]. [Evidenca 25VKM Msc Logopedi nr 744 datë 05.09.2013]. Takimi me stafin drejtues Vizita e ambjenteve
Kriteri 2. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Programi i studimit Msc në Logopedi por edhe programet e tjera të studimit që ofron UMT synojnë transmetimin e dijeve dhe përgatitjen e profesionistëve të shëndetit që të praktikojnë kujdes cilësor ndaj pacientit. Orientimi në fushën e mjekësisë është një pikë e fortë, fushë në të cilën përfshihet ky program studimi. Përmbajtja e programit Msc në Logopedi i pajisë studentët me kompetencë të lartë në njohuritë e etikës dhe deontologjisë profesionale, legjislacionit mjekësor, ruajtjen e sekretit profesional si dhe i pajis me njohuri të mira të teknikave dhe metodave të reja të trajtimit reabilitues – logopedike, në pacientët me patologji të ndryshme, trajtimin ambulator dhe hospitalor të tyre. UMT si Universiteti i parë gjithëpërfshirës i arsimit të lartë publik në shkencat mjekësore dhe i kërkimit shkencor në vend ofron programet e studimit, të cilat kanë fushë të përgjithshme dhe specifike në përputhje me fushën kryesore të UMT, referuar Statutit UMT Rregullores së Universitetit, Planit Strategjik të Zhvillimit, Rregulloren e Fakulteteve. Bazuar në Udhëzimin nr.31 për Kodifikimin e Programeve të Studimit të ofruara nga IAL në Republikën e Shqipërisë datë 15.11.2022 institucioni ka kryer kodifikimin e programit në përputhje me udhëzimin e direktivës

	duke zbatuar çdo udhëzim dhe akte nënligjore të publikuara. FSHMT ofron programe të ciklit të parë, të dytë dhe të tretë të studimit. FSHMT ofron programin e studimit Msc në Logopedi referuar nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të kualifikimeve. Ky program ofrohet nga 3 departamente: 1. Departamenti i Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor dhe Infermieristikës në Kirurgji dhe në Obstetrikë Gjinekologji; 2. Departamenti i Lëndëve Klinike dhe Infermieristikës së Përgjithshme dhe Infermieristikës në Sëmundje të Brendshme dhe në Pediatri; 3. Departamenti i Lëndëve Paraklinike (Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike). Profili i programit Msc në Logopedi dhe fusha e përgjithshme dhe specifike përputhet me atë të njësisë kryesore. Klasifikimi/kodifikimi i programit të studimit është kryer sipas direktivave dhe udhëzimeve në fuqi për IAL. [Evidenca 1 Statuti UMT]. [Evidenca 2 Rregullore UMT]. [Evidenca 5 Rregullore e FSHMT]. [Evidenca 170 Plan Strategjik i Zhvillimit të UMT]. [Evidenca 189 Udhëzim Nr.31 Kodifikimi i programeve të studimit].
Kriteri 3. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Ky program studimi ofrohet në nivel njësie kryesore.
Kriteri 4. Në rastet kur institucioni ofron program “Master profesional” në një drejtim specifik, jashtë profilit të institucionit, cilësia e tij garantohej nga institucionet partnere.	N/A
Kriteri 5. Institucioni i arsimit të lartë ofron trajnime profesionale të mëtijshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	Qendra e karrierës dhe orientimit të studentëve -ALUMNI ushtron veprimtarinë e saj për informimin, orientimin, këshillimin dhe mbështetjen e studentëve të FSHMT -së për karrierën profesionale. FSHMT ka bashkëpunime që vlejné për tu vlerësuar me shumë IAL. FSHMT favorizon punësimin e studentëve. Gjithashtu shërben si një urë midis atyre që ndjekin studimet, të diplomuarve dhe institucioneve shëndetësore, klinikave. Përmes platformës GRADUA studentët pas diplomimit plotësojnë formularin dhe përditësojnë vazhdimisht të dhënat individuale. FSHMT dhe UMT kanë rolin e urës lidhëse me Ministrinë e

	Shëndetësisë nëpërmjet marrëveshjeve, midis të diplomuarve dhe tregut të punës duke qënë punëdhënësi kryesor në fushën e shëndetësisë. UMT përsona i përket edukimit në vazhdim ka organizuar trajnime, ë orkshope, evente si: Konkursi i Punimeve Kërkimore 5, “Projekti READ”, Panairi i Masterit dhe Praktikës së Punës në SHBA, Trajnim Paketa “Office” ofruar nga projekti CleanScore, Takim informues me përfaqësuesit e AADF për projektet, Edicioni i 4-t i “Konkursit të Punimeve Kërkimore” organizuar nga projekti CleanScore. [Evidenca 1 Statuti UMT]. [Evidenca 192 Zyra e karrierës]. [Evidenca 44 Projekte ndërkombëtare të fituara]. [Evidenca 45 Lista e projekteve kombëtare të aplikuara dhe të fituara]. [Evidenca 46 Memorandume bashkëpunimi UMT me MSHMS].			
Konkluzione	GVJ vlerëson se standardi I.2 përmbushet plotësisht. UMT është qendra më e madhe mësimdhënëse publike e formimit universitar dhe pasuniversitar në shkencat mjekësore në vendin tonë, që ofron ekspertizën profesionale më të lartë në didaktikë, kërkim shkencor dhe përgatitjen e specialistëve të të gjitha fushave të mjekësisë. Ky program ofrohet nga 3 departamente: 1. Departamenti i Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor dhe Infermieristikës në Kirurgji dhe në Obstetrikë Gjinekologji; 2. Departamenti i Lëndëve Klinike dhe Infermieristikës së Përgjithshme dhe Infermieristikës në Sëmundje të Brendshme dhe në Pediatri; 3. Departamenti i Lëndëve Paraklinike (Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike). Universiteti i Mjekësisë, Tiranë përbëhet nga 4 njësi kryesore. FSHMT ka personel akademik efektiv në fushën e infermierisë dhe mjekësisë që zotërojnë grada dhe tituj shkencor. Profil i programit Msc në Logopedi dhe fusha e përgjithshme dhe specifike përputhet me atë të njësisë kryesore. FSHMT favorizon punësimin e studentëve nëpërmjet marrëveshjeve të bashkëpunimit, midis të diplomuarve dhe tregut të punës duke qënë punëdhënësi kryesor në fushën e shëndetësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.3	
Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimin profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe	Veprimtaria e UMT zhvillohet në përputhje me rregullat dhe parimet e hapësirës evropiane të arsimit të lartë, ligjin për arsimin e lartë, aktet

mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësiwe përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	përkatëse nënligjore, organizohet dhe realizohet përmes njësive përbërëse të saj si dhe nga organet dhe autoritetet drejtuese që veprojnë mbështetur në kompetencat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, në status dhe në rregullore. UMT përfshin në rrjetin e saj formues struktura shëndetësore universitare, struktura shëndetësore spitalore dhe jospitalore. Strukturat shëndetësore universitare miratohen dhe funksionojnë si të tilla si pjesë e UMT bazuar në legjislacionin në fuqi. FSHMT është pjesë e UMT. FSHMT ofron arsim gjithëpërfshirës të studentëve, kualifikimin e tyre, kërkimin shkencor dhe veprimtari të tjera në fushën e shkencave mjekësore. FSHMT ofron 22 programe studimi në të tre ciklet e studimit, ku përfshihet dhe programi i studimit Msc në Logopedi. (Rregullorja e FSHMT). Format e bashkëpunimit të spitaleve kryesore në vend me UMT përcaktohen në VKM, në sajë të së cilës u vendos Miratimi i Qendrës Spitalore Universitare “Nënë Tereza”, dhe Spitali Universitar i Traumës si struktura shëndetësore universitare të përgjithshme të cilat përveç funksioneve diagnostikuese dhe trajtuese në ofrimin e kujdesit shëndetësor realizojnë dhe funksione mësimore kërkimore shkencore për të realizuar formimin universitar të specialistëve të shëndetësisë si pjesë e UMT. Në funksion të programit të studimit, institucioni ka angazhuar të gjithë strukturën dhe logjistikën që disponon. Gjatë takimit me drejtues të fakultetit dhe departamenteve në realizimin e programit të studimit një rol të rëndësishëm luan bashkëpunimi i ngushtë që egziston midis departamenteve të FSHMT. Bashkëpunimi dhe detyrat brenda njësisë bazë apo programeve bazohen në rregulloren e funksionimit të FSHMT dhe departamenteve ku realizohet programi i studimit Msc në Logopedi dhe analizohen çdo vit akademik në raportin vjetor të analizës së veprimtarisë së departamenteve. Për realizimin e procedurave të ndryshme vlerësuese, projekteve, hartimin e buxhetit, rekrutim stafi akademik etj funksionojnë ngritja e grupeve “ad hoc” në përbërje të të cilit janë anëtarë të stafit akademik të FSHMT. Në fillim të çdo viti akademik, dekanati koordinon orarin mësimor dhe ngarkesën mësimore të stafit akademik midis njësive bazë të FSHMT apo departamenteve ku realizohet praktika profesionale në funksion të realizimit të programit mësimor në këtë program studimi. [Evidenca 1 Statuti UMT]. [Evidenca 5 Rregullore e FSHMT]. [Evidenca 112 Lista e Shërbimeve të Qëndrave Spitalore Universitare]. [Evidenca 118 Infrastruktura në funksion të mësimdhënies UMT]. [Evidenca 144 VKM për qendrat spitalore].
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet	FSHMT vazhdimisht realizon veprimtarinë e saj në funksion të një mësimdhënie cilësore dhe kërkimi shkencor të arrirë duke bashkëpunuar me të gjithë partnerët që UMT ka nënshkruar marrëveshje. GVJ vlerëson: Memorandum bashkëpunimi midis MSHMS dhe UMT i cili thekson si objektiva: a) Përmirësimin e kapaciteteve profesionale dhe akademike të



homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	studentëve që diplomohen nga UMT për të mundësuar në të ardhmen ofrimin e shërbimit shëndetësor cilësor për popullatën tonë. b) Rritjen dhe forcimin e kapaciteteve të kërkimit shkencor të UMT-së. c) Promovimin e mekanizmave transparente për punësimin e studentëve të UMT-së në sistemin shëndetësor në vend dhe nxitjen e studentëve ekselentë për tju bashkuar këtij sistemi. Ky memorandum është lidhur për një afat kohor të pacaktuar. Një tjetër Memorandum Bashkëpunimi që vlerësohet nga GVJ është ai midis Universitetit të Romës, Tor Vergata dhe Universitetit të Mjekësisë, Tiranë marrëveshje e nënshkruar në kuadër të bashkëpunimit dhe promovimit të ndryshimeve multilaterale në funksion të zhvillimit institucional. Kjo marrëveshje është e vlefshme për një periudhë 5-vjeçare nga dita e nënshkrimit (2018). GVJ vlerëson Marrëveshjet Kombëtare, Ndërkombëtare me Institucione të Arsimit të Lartë, Institucione apo Organizata të tjera përkatësisht për vitet 2019, 2020, 2021, 2022, 2023. Këto evidenca janë vendosur në dispozicion të GVJ në faqen ASCAL. Janë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me Universitetin e Salernos Itali; Universitetin e Janinës Greqi; Universitetin Internacional European Ukrainë; Universiteti Semmelweis Hungari; Universiteti i Novi Sad; Universiteti i Romës” La Sapienza” Itali; Universiteti Ndërkombëtar i Shkencave të Shëndetit Saint Camillus, Itali; Universiteti i Mjekësisë dhe Farmacisë së Kraioves Rumani; Universiteti Polis; Universiteti Western Balkans; Universiteti i Beogradit; Universiteti i Shkencave Mjekësore Turqi; Universiteti Altinbas. Marrëveshje të nënshkruara me IAL Kombëtare në vitet 2019, 2020, 2021 janë: Universiteti Aldent; Universiteti Marin Barleti; UET; Universiteti Luarasi. Të tjera marrëveshje të nënshkruara me institucionet në vitet 2019, 2020, 2021, 2022, 2023 janë: Fondacioni Spitalor i Nënës dhe Fëmijës; Agjensia Kombëtare e Barnave dhe pajisjeve mjekësore; MSHMS; Albanian American Development Foundation; Qendra Media dhe çështjet shoqërore; Akademia e Shkencave të Shqipërisë; ABC Health Foundation; New Generation Tiranë; AMPLE. GVJ vlerëson Marrëveshjet e Bashkëpunimit mbi zhvillimin e praktikës mësimore në fushën e Logopedisë midis FSHMT dhe Qendrës së Rehabilitimit Antigoni; midis FSHMT dhe Klinikës për zhvillimin e fëmijëve Progres. Këshillimi i karrierës është një element kryesor i praktikës së përgjithshme të këshillimit. Zyra e Këshillimit të Karrierës duke u fokusuar në tre tipare kryesore si: aftësitë personale të studentëve, personalitetin e studentëve, fushën e interesave të studentëve, ndihmon studentët të realizojnë ambiciet e tyre për karrierë, të gjejnë veshen në tregun e punës, të bëjnë aplikime të efektshme, të zhvillojnë aftësitë e tyre dhe për rrjedhojë të përmbushin kriteret e punëdhënësve UMT dhe FSHMT kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për mobilitetin e pedagogëve dhe studentëve në kuadër të programit ERASMUS, si dhe një sërë projekte ndërkombëtare (evidenca të vëna në
--	--



	dispozicion të GVJ në faqen ASCAL) në funksion të edukimit dhe kërkimit shkencor. [Evidenca 48 Shembull Marrëveshje Bashkëpunimi me IAL Ndërkombëtare]. [Evidenca 101 Lista e Bashkëpunimeve me Institucione të tjera]. [Evidenca 107 Manuali i këshillimit të karrierës]. [Evidenca 108 Aktivitete të zyrës së karrierës]. [Evidenca 118 Infrastruktura në funksion të mësimdhënies UMT]. [Evidenca 144 VKM për miratimin e strukturave shë ndetë sore universitare]. [Evidenca 46 Memorandume bashkëpunimi UMT me MSHMS]. [Evidenca 49 Lista e bashkëpunimeve me IAL kombëtare, ndërkombëtare dhe institucione të tjera].
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj, dhe bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, për realizimin e kërkimeve shkencore dhe mobilitetit të personelit akademik dhe studentëve.	Praktikat profesionale, klinike zhvillohen në institucione publike apo private sipas profilit të përgatitjes së studentit dhe nën drejtimin e stafit akademik të caktuar nga departamenti përkatës. Departamenti është përgjegjës për kryerjen e praktikës profesionale, si dhe kryen ndarjen e studentëve në institucionet pritëse duke respektuar dhe propozimet e tyre. Departamenti cakton pedagogë përgjegjës të cilët drejtojnë praktikën profesionale si dhe harton programin e praktikës i cili miratohet nga Drejtuesi i departamentit. Gjatë kryerjes së praktikës profesionale, klinike apo stazhit pedagogu përgjegjës mban lidhje me institucionin ku kryhet praktika. Në funksion të realizimit të praktikave Fakulteti ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunime të vlefshme me Institucione të Arsimit të Lartë si p.sh Qendrat Komunitare, Qendrat Rehabilituese për zhvillimin e praktikave profesionale, klinike etj. Me disa kompani të caktuara FSHMT ka krijuar në mënyrë efektive bashkëpunime nëpërmjet impenjimit të përfaqësuesve të tyre në trajnime të personelit, apo angazhimit të studentëve në konferenca apo leksione të hapura të cilat zhvillohen nga Fakulteti. Institucionet dhe Organizatat bashkëpunuese në rang Programi/studimi për Praktikat profesionale me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë janë: QSUNT, Klinika PROGRES, Klinika ANTIGONI THE TALK DOC. Në realizimin e aktivitetit shkencor evidentohet qartazi prirja për bashkëpunim mes kolegësh, studentësh dhe bashkëpunimi me të tretët. Në bashkëpunimin me Brain Storm, KKSHM 1, DDRSHIKIOGJ ka realizuar 57 punime nga të cilat 31 punime si autor i parë, 26 punime si bashkëautor dhe 9 punime me studentët e vet. FSHMT në vitin 2023 ka realizuar bashkëpunime me Universitetin e Vlorës dhe Elbasanit (Konferenca e Universitetit të Vlorës dhe FSHMT) ku në total morrën pjesë 32 abstrakte, nga të cilat 16 abstrakte si autor i parë dhe 16 abstrakte si bashkëautor. Bazuar në evidencë janë raportuar 5 artikuj ndërkombëtarë dhe 5 abstrakte ndërkombëtare. UMT dhe FSHMT kanë nënshkruar marrëveshje

	bashkëpunimi për mobilitetin e pedagogëve dhe studentëve në kuadër të programit ERASMUS. [Evidenca 5 Rregullore e FSHMT]. [Evidenca 82 Raporti vjetor FSHMT 2022-2023]. [Evidenca 79.1 Raporti vjetor UMT 2021-2022]. [Evidenca 19 Aktiviteti datë 14 Nëntor 2023 në FSHMT]. [Evidenca 37 Shembull kërkesë miratim aktiviteti FSHMT staf]. [Evidenca 18 Konferenca vjetore libri i abstrakteve FSHMT]. [Evidenca 196 Kërkimi shkencor 3 vite në FSHMT]. [Evidenca 30 Konferenca Vjetore 2023 FSHMT në bashkëpunim me UV dhe UISH]. [Evidenca 49 Lista e bashkëpunimeve me IAL kombëtare, ndërkombëtare dhe institucione të tjera]. [Evidenca 152 Lista e botimeve të Revistës Shkencore të FSHMT]. [Evidenca 166 Lista e mobiliteteve hyrëse dhe dalëse analizë statistikore].
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Universiteti i Mjekësisë, Tiranë ka nënshkruar shumë Marrëveshje Kombëtare dhe Ndërkombëtare me Institucione të Arsimit të Lartë, Institucione/Organizata të tjera. GVJ vlerëson dokumentacionin e vendosur në dispozicion nga Institucioni. UMT ka bashkëpunuar me disa universitete të huaja, në kuadër të programit ERASMUS+ dhe shkëmbimit të studentëve, stafit akademik dhe atij administrativ. UMT dhe njësia bazë çdo vit analizojnë punën dhe produktet e bashkëpunimit të cilat janë publikuar në Raportet Vjetore UMT, FSHMT. FSHMT si njësia bazë e (UMT) ku realizohet ky program studimi, në mënyrë periodike analizojnë përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit Msc. në Logopedi si ecuria e zhvillimit të praktikës profesionale, realizimin e aktiviteteve të përbashkëta me institucionet arsimore dhe shëndetësore, realizimin e projekteve të ndryshme apo mobilitetin e studentëve dhe pedagogëve. [Evidenca 46 Memorandume bashkëpunimi UMT me MSHMS]. [Evidenca 47 Shembull Marrëveshje për diploma të përbashkëta]. [Evidenca 48 Shembull Marrëveshje Bashkëpunimi me IAL Ndërkombëtare]. [Evidenca 49 Lista e bashkëpunimeve me IAL kombëtare, ndërkombëtare dhe institucione të tjera]. [Evidenca 112 Lista e shërbimeve të QSU]. [Evidenca 144 VKM për miratimin e strukturave shëndetësore universitare]. [Evidenca 154 Analiza për aktivitetin kërkimor shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik të UMT]. [Evidenca 79.1 Raporti vjetor UMT 2021-2022, 2023]. [Evidenca 82 Raporti vjetor FSHMT 2022-2023]. [Evidenca 85 Analiza vjetore 2022-2023 DDRSHIKIOGJ].

Konkluzione	GVJ vlerëson se standardi I.3 përmbushet plotësisht. Në funksion të programit të studimit, institucioni ka angazhuar të gjithë strukturën dhe logjistikën që disponon. Bashkëpunimi dhe detyrat brenda njësisë bazë apo programeve bazohen në rregulloren e funksionimit të FSHMT dhe departamenteve ku realizohet programi i studimit Msc në Logopedi dhe analizohen çdo vit akademik në raportin vjetor të analizës së veprimtarisë së departamenteve. FSHMT vazhdimisht realizon veprimtarinë e saj në funksion të një mësimdhënie cilësore dhe kërkimi shkencor të arrirë duke bashkëpunuar me të gjithë partnerët që UMT ka nënshkruar marrëveshje. FSHMT si njësi bazë e (UMT) ku realizohet ky program studimi, në mënyrë periodike analizon përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit Msc. në Logopedi			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË

Standardi II.1	
Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, veprimtaritë formuese, të vlerësuara në kredite, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi Master i Shkencave në Logopedi i ofruar nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë Tiranë është hapur si program studimi Diplomë e Nivelit të Dytë në vitin 2013 me VKM Nr. 744, datë 05.09.2013. IAL ka deklaruar në AMS se programi ofrohet nga 3 departamente: 1. Departamenti i Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor dhe Infermieristikës në Kirurgji dhe në Obstetrikë Gjinekologji; 2. Departamenti i Lëndëve Klinike dhe Infermieristikës së Përgjithshme dhe Infermieristikës në Sëmundje të Brendshme dhe në Pediatri; 3. Departamenti i Lëndëve Paraklinike. Përgjegjës në nivel fakulteti është Departamenti i DDRSHIKIOGJ me kontributin e çdo njësie dhe strukture të fakultetit dhe univesitetit. Ky program i referohet nivelit të 7 të KSHK, është i organizuar me 120 kredite, kohëzgjatje 2 vite akademike, në gjuhën shqipe, me kohë të plotë studimi, të ndara në lëndë/module bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 bazuar në aktet nënligjore dhe Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve [Vendim Senati riorganizim programesh]. Në përfundim të studimeve lëshohet diploma Master i Shkencave në Logopedi. Programi përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit të përcaktuar në VKM nr.41 datë.24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese të cilat realizohen me kredite ECTS dhe janë të grupuara në: A. Lëndë bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (A)15% - 20% (kredite) B. Lëndë karakterizuese – përgatitje për disiplinën shkencore (B) 50% - 55% (kredite) C. Lëndë ndërdisiplinore/integruese nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (C) 12% -15% (kredite) D. Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (D)10-15% (kredite) E. Detyrimë përmbyllëse dhe Diploma 3%-5% (kredite) GVJ konstaton se shpërndarja e lëndëve në programin e studimit në veprimtari formuese sipas kategorive A, B, C, D, E në ECTS, përqindje përputhet me ato të parashikuara në VKM nr. 41/2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. [Evidenca 97 Tabelat përmbledhëse RVB logopedi Msc. i rishikuar].
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të	Programi i studimit është organizuar në përputhje me VKM Nr. 744, datë 05.09.2013. “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga

veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.	institucionet e arsimit të lartë”. Programi i studimit ju ofron studentëve njohuri të mira të teknikave dhe metodave të reja të trajtimit rehabilitues –logopedike, në pacientët me patologji të ndryshme, trajtimin ambulator dhe hospitalor të tyre; aftësi në mënyrën e komunikimit midis kolegëve, eprorëve, vartësve, pacientëve dhe familjarëve për përdorimin e mjeteve informatike dhe telematike në fushat me kompetenca specifike; kompetencë në kryerjen e studimeve dhe hulumtimeve shkencore me vlerë në fushën e logopedisë. Programi i studimit synon formimin e logopedistëve profesionistë me njohuritë dhe kompetencat e nevojshme që të punojnë në klinika spitalore, poliklinika, shtëpi kujdesi, shkolla, kopshte etj., për organizimin e punës në drejtim të edukimit Logopedik të të gjithë pacientëve me këto probleme si në sektorin publik dhe privat nëpërmjet ofrimit të një shërbimi cilësor në grupmosha të ndryshme. Gjithashtu programi i studimit synon rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e logopedisë dhe siguron informacionin bazë për përgatitjen logopedëve me formim të plotë dhe të gjithanshëm. Njohuritë e fituara në këtë program studimi i krijon njohuri studentit që të përshtatet me kërkesat e tregut të punës dhe zgjerimin e njohurive të tyre profesionale që i shërbejnë si bazë për kualifikime të mëtejshme. Programi ka objektiva të përcaktuara në përputhje me misionin dhe strategjinë e zhvillimit të institucionit. Në kurrikulën e tij përfshihen lëndë specifike për profilin specifik të logopedit që lidhen me nevojat e tregut të punës. Njohuritë e përfituara i shërbejnë studentëve të aftësohen me kompetenca të përparura në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikuara me pacientin. [Evidenca 1 Statuti UMT]. [Evidenca 189 Udhëzim nr. 31 datë 15.11.2022 kodifikimi i programeve të studimit IAL].
Kriteri 3. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Programi i studimit në “Master i Shkencave - Logopedi” zgjat 2 vite dhe ndahet në 4 semestra në total 120 ECTS. Semestrat ndahen në modulet përkatëse. Një kredit ka 25 orë mësimore, nga të cilat 12 janë orë në auditor dhe 13 janë orë individuale. Në fund të çdo moduli studenti shlyen lëndët përkatëse (të detyrueshme) me një provim për çdo lëndë të modulit. Nota e modulit llogaritet si shuma e prodhimit të notave të lëndëve me kreditet përkatëse të tyre, pjesëtuar me shumën e krediteve të të gjithë modulit. MSH mbyllet me mikrotezë, e cila vlerësohet nga një komision i ngritur ad-hoc, me urdhër të Këshillit të Fakultetit. Mikroteza vlerëson aftësitë profesionale të integruara të logopedistit, dhe punën e pavarur të tij. Mbrojtja e mikrotezës shoqërohet me lëshimin e një Diplome Universitare “Master i Shkencave “, në Logopedi. Praktika profesionale ka 12 kredite (ECTS) dhe mikroteza ka 18 kredite (ECTS). Institucioni për realizimin në mënyrë efektive të praktikës profesionale ka organizuar marrëveshje bashkëpunimi me institucione shëndetësore dhe praktika udhëhiqet nga një pedagog përgjegjës i cili mbikëqyr realizimin e praktikës në institucionin përkatës. Në programin mësimor

	praktika zë (300orë mësimore) ndërsa mikroteza ka 108 orë punë të pavarur. [Evidenca 91 Plani mësimor Msc logopedi].
Kriteri 4. Programet e ciklit të dytë “Master” në Mësuesi, që formojnë mësues të arsimit fillor janë plotësim i ciklit të parë Bachelor në arsimin Fillor. Programet Master në Mësuesi për formimin e mësuesve të arsimit të mesëm të ulët dhe të lartë organizohen si programe të ciklit të dytë të studimeve “Master”, sipas fushave përkatëse të formimit.	Nuk i përket këtij programi studimi.
Kriteri 5. Programet “Master” në fushën e mësuesisë organizohen me 120kredite dhe duhet të përmbajnë 25 për qind të krediteve në shërbim të formimit të përgjithshëm psiko-pedagogjik. Programet “Master”, që formojnë mësues të së njëjtës fushë të mësuesisë, duhet të kenë së paku 80 për qind të kurrikulës me përmbajtje të ngjashme.	Nuk i përket këtij programi studimi.
Kriteri 6. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadrin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Ky program nuk i përket programeve me status të veçantë. Programi i studimit Msc në Logopedi realizohet në përputhje me Ligjin Nr. 80/2015, “Për Arsimin e lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 3, neni 25, neni 42 pika 7, neni 69 pika 3, Statutit të UMT neni 5, neni 12, neni26, neni 44, neni 86 dhe Rregullores së UMT-së si dhe mbështetur në ligjin Nr.9718, datë 19.4.2007 Për Urdhrin e infermierit në Republikën e Shqipërisë, në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, mbështetur në akte të tjera ligjore, urdhërit të Infermierit dhe orientimeve që iniciohen nga statusi i profesioneve të rregulluara. Aktet rregullatore të përpiluara nga Institucioni, janë në përputhje me kuadrin ligjor si dhe të gjitha procedurat në lidhje me format e organizimit të studimeve, pranimin e studentëve dhe financimin e tyre, realizohen në përputhje me këtë ligj dhe VKM përkatëse, si dhe në udhëzime të ministrisë përgjegjëse për arsimin. Kriteret për pranimin e studentëve si dhe kuotat e pranimiit zbatohen duke ndjekur një procedurë standarte sipas kuadrit ligjor dhe miratohen me vendim të senatit akademik të universitetit. Pra, Njësia Bazë harton kërkesat të cilat

	përmes Njesisë Kryesore i përcillen Senatit Akademik për miratim. Më pasi përcillen MAS dhe QSHA. [LIGJI Nr.9718, datë 19.4.2007 Për Urdhrin e infermierit në Republikën e Shqipërisë]. [Evidenca 1 Statuti UMT]. [Evidenca 2 Rregullore UMT]. [Evidenca 5 Rregullore e FSHMT]. [Evidenca 189 Udhëzim nr.31 datë 15.11.2022 Kodifikimi i programeve të studimit]. [Evidenca 205 Direktiva Evropiane për profesionet e rregulluara]. [Evidenca 206 ISCED International Standart Classification]. ISCED level 7.
Kriteri 7. Programet e studimit, të ciklit të dytë Master, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtësë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit Msc në logopedi realizohet nga DDRSHIKIOGJ të FSHMT në përputhje me misionin dhe objektivat e këtij institucioni. Bazuar në udhëzimin Nr.31, datë 15/11/2022 për Proçedurat, për Kodifikimin e Programeve të Studimit të ofruara nga IAL në Republikën e Shqipërisë në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës dhe pikës 9” Për specifikimet dhe përmbajtjen e kodifikimit të programeve të studimit të ofruara nga IAL në Republikën e Shqipërisë” UMT ka përcaktuar kodet e programeve të studimeve që ofron në fushën e saj. Referuar këtyre përcaktimeve ky program studimi rezulton ngjashmëri në përmbajtje 70%.
Kriteri 8. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Ky program i përket Nivelit 7 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve dhe shoqërohet me kodin përkatës 747, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga Ministria përgjegjëse për Arsimin dhe Shkencën. Lëndët dhe modulet që realizohen në këtë program studimi janë të pajisur me një kod unik që përputhet me kodin që ka në syllabus dhe programin mësimor.
Kriteri 9. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Departamenti nuk ofron programe të tilla të ngjashme.
Konkluzione	Programi Master i Shkencave në Logopedi i ofruar nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë Tiranë është hapur si program studimi Diplomë e Nivelit të Dytë në vitin 2013. Ky program i referohet nivelit të 7 të KSHK, është i organizuar me 120 kredite, kohëzgjatje 2 vite akademike, në gjuhën shqipe, me kohë të plotë studimi, të ndara në lëndë/module bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 bazuar në aktet nënligjore dhe Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve.

	Programi përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit të përcaktuar në VKM nr.41 datë.24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë". Shpërndarja e lëndëve në programin e studimit në veprimtari formuese sipas kategorive A, B, C, D, E në ECTS, përquindje përputhet me ato të parashikuara në VKM nr. 41/2018. Në përfundim të studimeve lëshohet diploma Master i Shkencave në Logopedi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2

Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	FSHMT ushtron veprimtarinë në pajtim me Kushtetutën, ligjin 80-2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë" Statutin dhe Rregulloren e UMT, Tiranë, Kodin e Punës, Kodin e Proedurave administrative si dhe Akteve të tjera Ligjore dhe Nënligjore. Programi Master i Shkencave në Logopedi i ofruar nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë Tiranë është hapur si program studimi Diplomë e Nivelit të Dytë në vitin 2013 me VKM Nr. 744, datë 05.09.2013. IAL ka deklaruar në AMS se programi ofrohet nga 3 departamente: 1. Departamenti i Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor dhe Infermieristikës në Kirurgji dhe në Obstetrikë Gjinekologji; 2. Departamenti i Lëndëve Klinike dhe Infermieristikës së Përgjithshme dhe Infermieristikës në Sëmundje të Brendshme dhe në Pediatri; 3. Departamenti i Lëndëve Paraklinike. Në kuadër të riorganizimit të programeve, në vitin 2018, programi u riorganizua në përputhje me Ligjin Nr.80/2015 për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, bazuar në aktet nënligjore dhe Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve diktuar nga nevoja e përmirësimit të vazhdueshëm të programeve të studimit. [Vendim Senati riorganizim programesh]. DDRSHIKIOGJ si njësia bazë mësimore-kërkimore nxit dhe bashkëpunon veprimtarinë e mësimdhënies, veprimtarinë kërkimore dhe ato të shërbimeve ndaj të tretëve mbështetur në ligjin 80-2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë". Departamenti ka angazhuar në programet e studimit staf akademik efektiv dhe me kontratë të cilët zotërojnë tituj akademik, grada shkencore apo Msc dhe staf ndihmës akademik laborant. Struktura organizative e departamentit/programit përbëhet nga grupi mësimor,

	grupi kërkimor shkencor dhe administrata (sekretaria mësimore, personeli mbështetës për laboratorët mësimor). Programi përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit të përcaktuar në VKM nr.41 datë.24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Për vitin akademik 2021-2022 ka 34 (tridhjetë e katër) pedagogë prej të cilëve 10(dhjetë) janë personel akademik efektiv PAE dhe 24 (njëzet e katër) janë personel akademik me kontratë PAK. Nga stafi PAE 2 (dy) janë të kategorisë Prof.Dr, 4 (katër) të kategorisë Prof.Asoc, 4 (katër) të kategorisë Dr/ PhD. Nga stafi PAK 1 (një) është i kategorisë Prof.Dr, 3 (tre) të kategorisë Prof.Asoc, 8 (tetë) të kategorisë Dr/ PhD, 12(dymbëdhjetë) asistentë me Msc. Raporti PAE/PAK është 10/24. Për vitin akademik 2022-2023 ka 34 (tridhjetë e katër) pedagogë prej të cilëve 10(dhjetë) janë personel akademik efektiv PAE dhe 24 (njëzet e katër) janë personel akademik me kontratë PAK. Nga stafi PAE 2 (dy) janë të kategorisë Prof.Dr, 4 (katër) të kategorisë Prof.Asoc, 4 (katër) të kategorisë Dr/ PhD. Nga stafi PAK 1 (një) është i kategorisë Prof.Dr, 3 (tre) të kategorisë Prof.Asoc, 8 (tetë) të kategorisë Dr/ PhD, 1 (një) është në process Dr, 11 (njëmbëdhjetë) asistentë me Msc. Raporti PAE/PAK është 10/24. Për vitin akademik 2023-2024 ka 31 (tridhjetë e një) pedagogë prej të cilëve 10(dhjetë) janë personel akademik efektiv PAE dhe 21 (njëzet e një) janë personel akademik me kontratë PAK. Nga stafi PAE 3 (tre) janë të kategorisë Prof.Dr, 3 (tre) të kategorisë Prof.Asoc, 4 (katër) të kategorisë Dr/ PhD. Nga stafi PAK 1 (një) është i kategorisë Prof.Dr, 3 (tre) të kategorisë Prof.Asoc, 8 (tetë) të kategorisë Dr/ PhD, tre (tre) janë në process Dr. 6 (gjashtë)asistentë me Msc. Raporti PAE/PAK është 10/21. GVJ rekomandon rishikimin e të dhënave në tabelat përkatëse. [Evidenca 97 Tabelat përmbledhëse RVB logopedi Msc. i rishikuar]. [Evidenca 5 Rregullore e FSHMT]. [Evidenca 8 Historiku i FSHMT]. [Evidenca 6 Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ].
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.	Njësia bazë ku realizohet ky program studimi ka angazhuar staf akademik dhe ndihmës akademik mësimor për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike, klinike, praktikave profesionale. Stafi ndihmës akademik asiston pedagogët për realizimin e programit mësimor. Për realizimin e programit Msc në logopedi janë angazhuar staf akademik efektiv dhe me kontratë që zotërojnë tituj akademik, gradë shkencore apo Msc.Për realizimin e praktikave profesionale angazhohen mjekë logopedistë nga qendra spitalore. Pjesë e stafit të programit është stafi ndihmës akademik me karakter mësimor/ laborant me formimin e duhur profesional që është përgjegjës për organizimin e praktikave laboratorike mësimore, asiston pedagogët në realizimin e tyre, si dhe studentët në praktikimin e teknikave të ndryshme logopediste. Njësia kryesore merr masat për



	krijimin e kushteve për realizimin e praktikave profesionale të parashikuara në programin e studimit me një numër të caktuar kreditesh. Praktikave profesionale zhvillohen në kompani/institucione publike ose private, sipas profilit të përgatitjes së studentit nën drejtimin e stafit akademik. [Evidenca 97 Tabelat përmbledhëse RVB logopedi Msc. i rishikuar].			
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Drejtuesi i Njesisë Bazë është autoriteti më i lartë drejtues në departament i cili mbikqyr dhe koordinon aktivitetin mësimdhënës dhe kërkimor shkencor në departament. Me propozim të shefit të departamentit dekan emëron përgjegjësit e grupit mësimor dhe kërkimor shkencor të cilët organizojnë dhe ndjekin realizimin e procesit mësimor dhe atij kërkimor shkencor. Fakulteti cakton çdo vit një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Detyrat dhe mënyra e raportimit janë të dokumentuara në rregulloren e funksionimit të programit. Koordinatori në mënyrë të vazhdueshme informon Dekanin e FSHMT nëpërmjet takimeve të herëpashershme, dhe merr pjesë në mbledhjet e departamentit në lidhje me mbarrëvajtjen e procesit mësimor si dhe problematikave nëse do ketë. [Evidenca 5 Rregullore e FSHMT]. [Evidenca 87 Shembull Mbledhje Departamenti].			
Konkluzione	GVJ vlerëson se standardi II.2 përmbushet plotësisht. DDRSHIKIOGJ si njësia bazë mësimore-kërkimore nxit dhe bashkëpunon veprimtarinë e mësimdhënies, veprimtarinë kërkimore dhe ato të shërbimeve ndaj të tretëve mbështetur në ligjin 80-2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë". Departamenti ka angazhuar në programet e studimit staf akademik efektiv dhe me kontratë të cilët zotërojnë tituj akademik, grada shkencore apo Msc dhe staf ndihmës akademik laborant. Për realizimin e praktikave profesionale angazhohen mjekë logopedistë nga qendra spitalore. Bazuar në rregulloren e programit të studimit Msc. në Logopedi, programi ka koordinatorin e programit të emëruar me vendim të drejtuesit të njesisë bazë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3 Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të dytë.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve

Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit të ciklit të dytë, disponon informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ pas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion si dhe dokumentave shtesë pas vizitës në institucion konstaton se departamenti zotëron, disponon informacionin e nevojshëm lidhur me organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit Msc në Logopedi, të cilat ju vihen në dispozicion studentëve që ndjekin këtë program studimi nga pedagogu i çdo lënde si dhe sekretaria mësimore. Dosja e programit të studimit përfshin: informacion për institucionin, informacion për stafin akademik, syllabuset e lëndëve, rregullorja e programit të studimit. [Evidenca 86 programi i studimit Msc. në Logopedi] [Evidenca 21 Rregullore Msc.Logopedi].
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestral, ngarkesën mësimore të lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, GVJ konstaton se struktura programi i studimit Msc. në Logopedi përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e tij të përcaktuar në VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”, Kategoritë e veprimtarive formuese, që karakterizojnë një program studimi. a) Programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese, të cilat realizohen me kredite ECTS. Plani mësimor përfshin lëndët, disiplinat, praktikën dhe mbrojtjen e tezës si dhe veprimtari jashtë kurrikulare. Veprimtaritë formuese, që karakterizojnë një program studimi, përbëhen nga komponentët mësimorë, të cilët ndahen në: i) mësim në auditor, si leksione, seminare, lëndë individuale artistike, ushtrime, laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor; ii) studim individual, si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektesh; iii) përgatitje për provime; iv) përgatitje e tezës së diplomës; v) veprimtari të tjera, si praktika profesionale, praktika në terren apo stazh pranë subjekteve publike ose private. Programi i studimit në “Master i Shkencave - Logopedi” është i organizuar në lëndë dhe praktikë profesionale të vlerësuara me kredite sipas sistemit Evropian të vlerësimit të cilat zhvillohen në 4 semestra të cilët ndahen në modulet përkatëse, me kohë të plotë me 120 kredite (ECTS) në total. Një kredit ka 25 orë mësimore, nga të cilat 12 janë orë në auditor dhe 13 janë orë individuale. Në fund të çdo moduli studenti shlyen lëndët përkatëse (të detyrueshme) me një provim për çdo lëndë të modulit. Nota e modulit llogaritet si shuma e prodhimit të notave të lëndëve me kreditet përkatëse të tyre, pjesëtuar me shumën e krediteve të të gjithë modulit. [Evidenca 21 Rregullore Msc.Logopedi].



Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Ky program i referohet nivelit të 7 të KSHK, është i organizuar me 120 kredite, kohëzgjatje 2 vite akademike, në gjuhën shqipe, me kohë të plotë studimi, të ndara në lëndë/module bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 bazuar në aktet nënligjore dhe Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve [Vendim Senati riorganizim programesh]. Në përfundim të studimeve lëshohet diploma Master i Shkencave në Logopedi. Programi përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit të përcaktuar në VKM nr.41 datë.24.01.2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese të cilat realizohen me kredite ECTS dhe janë të grupuara në: A. Lëndë bazë – përgatitje metodologjike dhe kulturë e përgjithshme (A)15% - 20% (kredite) B. Lëndë karakterizuese – përgatitje për disipinën shkencore (B) 50% - 55% (kredite) C. Lëndë ndërdisiplinore/integruese nëndisiplina, profile dhe grup-lëndë me zgjedhje (C) 12% -15% (kredite) D. Lëndë plotësuese – gjuhë të huaja, njohuri informatike, praktika profesionale (D)10-15% (kredite) E. Detyrimë përmbyllëse dhe Diploma 3%-5% (kredite) GVJ konstaton se shpërndarja e lëndëve në programin e studimit në veprimtari formuese sipas kategorive A, B, C, D, E në ECTS, përqindje përputhet me ato të parashikuara në VKM nr. 41/2018 “Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit konstaton se institucioni ka informacion për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin Msc. në Logopedi. Në takimin me studentët rezultoi se studentët kishin informacion dhe institucioni aplikon kritere specifike përzgjedhëse në pranime të vendosur me VKM. [Evidenca 5 Rregullore e FSHMT]. [Evidenca 21 Rregullore Msc.Logopedi]. Takimi me studentët.
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit përmban informacionin lidhur me syllabuset që zhvillohen në programin Msc.në Logopedi. Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacionin e nevojshëm mbi tematikën e lëndës, ndarjen në leksione, seminare, punët laboratorike, detyrat e kursit, projektet e kursit, praktikën profesionale, ETC përkatëse, pedagogun që zhvillon lëndën, formën, kohën e vlerësimit dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të dijeve të studentit dhe literaturën përkatëse. Drejtuesi i Departamentit cakton pedagogët përgjegjës, të cilët drejtojnë praktikën profesionale. Pedagogu përgjegjës harton “Programin e praktikës” i cili miratohet nga drejtuesi i departamentit. Studentët kanë detyrim kryerjen e 100% të orëve të



	praktikës profesionale. Gjatë kryerjes së praktikës profesionale mban lidhje me institucionin ku kryhet praktika. Nga shqyrtimi i dokumentacionit GVJ konstaton: Syllabuset janë organizuar/formatuar në përputhje me VKM nr.41 datë 24.01.2018“Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. - Në disa syllabuse titullarët e lëndëve janë me titullin <i>Dr. dhe Msc.të cilët duhet të jenë të kategorisë profesor sipas Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 58 “Statusi i personelit akademik”.</i> - Në disa syllabuse mungon tipologjia e lëndës dhe kodi i lëndës. - Në disa syllabuse mungon viti i botimit të literaturës bazë dhe të rekomanduar. Rekomandime: <i>Rishikimin e titullarëve të lëndëve dhe emërtimin sipas kategorisë profesor.</i> <i>Rishikimin e shpërndarjes së lëndëve sipas formimit profesional të pedagogut.</i> [Evidenca 21 Rregullore Msc.Logopedi]. [Evidenca 92.4 Logopedi Msc viti I 23-24]. [Evidenca 92.5 Logopedi Msc viti II 23-24].
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë në shqip dhe anglisht.	Departamenti ku zhvillohet programi i studimit ka përkthyer procedurën për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit. Në fillim të çdo viti akademik bëhet rishikimi i syllabuseve dhe literaturës për çdo lëndë. Në këtë proces përfshihen dhe studentët. Lëndët që kanë leksione të shkruara rishikohen çdo vit dhe leksionet arkivohen me syllabuset në formë hard copy dhe elektronike në departament dhe në drejtorinë e kurrikulave. [Evidenca 5 Rregullore e FSHMT]. [Evidenca 91 Plani mësimor MSH logopedi].
Konkluzione	Struktura programi i studimit Msc. në Logopedi përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e tij të përcaktuar në VKM nr.41 datë 24.01.2018 “Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë”. Programi i studimit përmban informacionin lidhur me syllabuset që zhvillohen në programin Msc.në Logopedi. Syllabuset e lëndëve përmbajnë informacionin e nevojshëm mbi tematikën e lëndës, ndarjen në leksione, seminare, punët laboratorike, detyrat e kursit, projektet e kursit, praktikat profesionale, ETC përkatëse, pedagogun që zhvillon lëndën, formën, kohën e vlerësimit dhe mënyra e testimit dhe vlerësimit të dijeve të studentit dhe literaturën përkatëse. Programi i studimit në “Master i Shkencave - Logopedi” është i organizuar në lëndë dhe praktikë profesionale të vlerësuara me kredite sipas sistemit Evropian të vlerësimit të cilat zhvillohen në 4 semestra të

	cilët ndahen në modulet përkatëse, me kohë të plotë me 120 kredite (ECTS) në total. Syllabuset janë organizuar/formatuar në përputhje me VKM nr.41 datë 24.01.2018“Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. - Në disa syllabuse titullarët e lëndëve janë me titullin Dr. dhe Msc.të cilët duhet të jenë të kategorisë profesor sipas Ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” neni 58 “Statusi i personelit akademik”. - Në disa syllabuse mungon tipologjia e lëndës dhe kodi i lëndës. - Në disa syllabuse mungon viti i botimit të literaturës bazë dhe të rekomanduar. Institucioni ka informacion për studentët lidhur me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve në programin Msc. në Logopedi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.4 Struktura dhe organizimi i programit të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Ky program i referohet nivelit të 7 të KSHK, është i organizuar me 120 kredite, kohëzgjatje 2 vite akademike, në gjuhën shqipe, me kohë të plotë studimi, të ndara në lëndë/module bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 bazuar në aktet nënligjore dhe Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve. Programi është hartuar në mënyrë të tillë që u shërben studentëve për të thelluar dijet profesionale teorike dhe praktike në fusha të specializuara si Logopedia të përshtatura me kërkesat e tregut të punës. Në programin e studimit Msc në Logopedi shpërndarja e lëndëve dhe praktikave ofron mundësi në përvetësim të aftësive dhe njohurive për punësimin e studentëve. Në programin mësimor një vënd të rëndësishëm zë praktika profesionale me orët përkatëse. Orët e praktikës profesionale kanë një peshë të rëndësishme në strukturën e programit, ato përbëjnë 300 orë praktikë profesionale. Format e mësimdhënies janë leksione Seminare, ushtrime/laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor, praktikë profesionale, diploma/provim formimi. Në vitin akademik 2023-2024 janë: leksione 504 orë, seminare 108 orë, ushtrime/laboratorë 290 orë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor 330 orë, Diploma/Provim Formimi 108 orë, total 1340 orë.

	[Evidenca 21 Rregullore Msc.Logopedi]. [Evidenca 91 Plani mësimor MSH logopedi]. [Evidenca 97 Tabelat përmbledhëse RVB logopedi Msc. i rishikuar].
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe kërkimit shkencor.	Ky program është organizuar sipas ligjit 80/2015 VKM nr 41 datë 24.01.2018 e ndryshuar. Është përcaktuar pika 2, 5 e VKM. Programi realizohet në 4 semestra akademikë dhe në përfundim të programit student fiton 120 kredite. Organizimi dhe realizimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore orë/ ECTS ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit, marrjen e rezultateve dhe përfitimin e aftësive të nevojshme profesionale. Me njohuritë e marra në këtë program, studentët e ndjejnë veten të aftë në vendet e tyre të punës dhe dijet e marra janë në funksion të plotë të veprimtarisë së përditshme të tyre. Gjatë takimit me studentët, ata theksojnë faktin se kanë qenë të sigurtë në zgjedhjen e tyre duke qenë se kjo është një degë ndërdisiplinore dhe një tjetër arsye është rritur kërkesa në tregun e punës si pasojë e rritjes së numrit të personave me problematika. Në vitin e parë zhvillohen lëndë që bëjnë pjesë të Shkencat e Komunikimit, në Epidemiologji dhe Mjekësi Preventive, në Metodologjinë e Kërkimit Shkencor, në Shkencat Pediatrike 1, në Shkencat Neuropsikiatrike 1, në Shkencat e Rehabilitimit Interdisiplinar, në Metodologjinë e Rehabilitimit Logopedik 1 si dhe lëndë me zgjedhje. Në vitin e dytë zhvillohen lëndë si Shkenca Neuropsikiatrike, Metodologjia e Rehabilitimit Logopedik 2, Logopedia Edukuese Shkollore, lëndë me zgjedhje, praktika dhe Mikroteza. Praktikat profesionale zhvillohen në institucione publike ose private, nën drejtimin e stafit akademik të caktuar nga departamenti. Nga praktika e zhvilluar në spitale ata pyeten në lidhje me vlerësimin e rastit të parë në klinikë. Studentët kryejnë 100% të orëve të praktikës profesionale sipas rregullores së institucionit pritës. Rregullorja e departamenteve përcakton elementet specifike të zhvillimit dhe vlerësimit të praktikës profesionale. Edhe labororet e logopedisë kanë peshën e vet specifike në zhvillimin e praktikës pasi aty mundet të shihet nga afër një praktikë. [Evidenca 91 Plani mësimor MSH logopedi]. [Evidenca 5 Rregullore e FSHMT]. Takimi me studentët
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Në rastet e programit të studimit "Master Profesional", ky program duhet të sigurojë aftësi,	Gjatë takimit me stafin drejtues dhe stafin akademik u deklarua se raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe përfaqëson me programe të ngjashme ndërkombëtare. Studentët që mbarojnë programin e Msc në Logopedi, një pjesë punësohen jashtë vendit, kryesisht në vendet perëndimore. Një pjesë tjetër kanë hapur edhe studio e tyre duke punuar në bashkëpunim me specialist-në ekip multidisciplinar. Ngjashmëria në programe të njëjta vërehet gjatë njehsimit të diplomave të studentëve që punojnë në vende të ndryshme të BE.

kompetenca dhe formim të thelluar profesional.	Referuar RVB Takimi me Stafin Drejtues të FSHMT Takimi me Personelin akademik [Evidenca 91 Plani mësimor MSH logopedi]. [Evidenca 197 Model kurrikule e huaj].
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Ndarja në kategori sipas veprimtarive formuese dhe raportet e ngarkesës së tyre bazuar në legjislacionin në fuqi, ndikon në arritjen e objektivave të programit dhe transferimin, mobilitetin e studentëve në programe të tjera studimi të ngjashme. Njohuritë e marra në këtë program dhe kurrikula e tij, ju krijojnë mundësi punësimi studentëve në sektorin publik dhe privat brenda dhe jashtë vendit. Strukturimi i vazhdueshëm i programit me qëllim formimin profesional të logopedit, aftësimin e tij, licensimin dhe punësimin në tregun e punës ka ndihmuar në njohjen e programit në vende të BE, USA dhe integrim në tregun europian. Studentët janë të interesuar dhe bashkëpunues. Në takimin me studentë u referua se nuk janë kanë kryer mobilitete në programet erasmus [Evidenca 91 Plani mësimor MSH logopedi].
Kriteri 5. Syllabuset (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	FSHMT dhe njësitë bazë kanë një praktikë të mirë dokumentuar lidhur me rishikimin në mënyrë të vazhdueshme të programit apo syllabuseve të lëndëve duke u bazuar në literaturë ndihmëse dhe të detyruar. Titullari i lëndës paraqet në njësinë bazë/dekanat programin e përditësuar të lëndës për vitin akademik përkatës, një javë para fillimit të vitit akademik. Departamenti ju siguron studentëve literaturën bazë që janë tekste mësimorë të pedagogëve të UMT apo cikle leksione të shkruara të përgatitura nga pedagogët e lëndës. Tekset mësimorë për pjesën teorike, seminare, laboratore, ushtrime propozohen nga titullarët e lëndëve dhe miratohen nga departamenti. Ky informacion gjendet në fund të çdo syllabusi. Formatit i hartimit të teksteve mësimore është i miratuar me vendim të senatit akademik. Në takimin me pedagogët u referua që platforma online classroom ofron informacion për studentë. Gjithashtu një platformë tjetër e aksesueshme dhe efikase është E-Learning UMT e cila mundëson (Administrim të pedagogëve dhe studentëve në nivel lënde, Komunikim me pedagogët, Menaxhimin e leksioneve online, Menaxhimin e detyrave/projekteve, Menaxhim i seminareve/praktikave dhe laboratoreve të lëndës). Në syllabuset e paraqitura të programit të studimit Msc. në Logopedi vërehet se përmbajnë informacionet e nevojshëm në lëndët (syllabuset janë të detajuara) për secilën lëndë. <i>GVJ konstaton se në një pjesë të syllabuseve nuk paraqitet kodi i lëndës, tipologjia e lëndës, si dhe nuk paraqiten vërejtjet përfundimtare nga pedagogu i lëndës.</i> <i>Në disa syllabuse mungon viti i botimit të literaturës bazë dhe të rekomanduar.</i> <i>Gjithashtu u vërejt se forma e syllabuseve nuk është e njëjtë.</i>



	<i>Në këtë program studimi duhet të rishikohet përditësimi i literaturës së lëndëve të ofruara e cila duhet ti përmbahet 5 viteve të fundit.</i> [Evidenca 91 Plani mësimor MSH logopedi]. [Evidenca 21 Rregullore Msc.Logopedi].			
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit u shërben studentëve për përfitimin e njohurive të mira të teknikave dhe metodave të reja të trajtimit rehabilitues-logopedike, në pacientët me patologji të ndryshme, trajtimit ambulator dhe hospitalor të tyre; kompetencë në kryerjen e studimeve dhe hulumtimeve shkencore me vlerë në fushën e logopedisë. Përmbajtja e programit i shërben rritjes së kapaciteteve në fushën e logopedisë, aftësimin teorik dhe praktik. [Evidenca 91 Plani mësimor MSH logopedi]. [Evidenca 21 Rregullore Msc.Logopedi].			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Përmbajtja e programit Msc.në Logopedi dhe u mundëson atyre vijimin e studimeve të mëtejshme. Lëndët që zhvillon studenti në këtë program përbëjnë bazën e përfitimit e kompetencës profesionale për punësimin e tyre dhe përshtatjen e tyre me kërkesat në tregun e punës. [Evidenca 21 Rregullore Msc.Logopedi].			
Konkluzione	Në programin e studimit Msc në Logopedi shpërndarja e lëndëve dhe praktikave ofron mundësi në përvetësim të aftësive dhe njohurive për punësimin e studentëve. Format e mësimdhënies janë leksione, seminare, ushtrime/laboratorë, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor, praktikë profesionale, diploma/provim formimi. Organizimi dhe realizimi i programit mësimor, shpërndarja e ngarkesës mësimore orë/ ECTS ju mundëson studentëve arritjen e objektivave të programit, marrjen e rezultateve dhe përfitimin e aftësive të nevojshme profesionale. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe përafron me programe të ngjashme ndërkombëtare. Njohuritë e marra në këtë program dhe kurrikula e tij, ju krijojnë mundësi punësimi studentëve në sektorin publik dhe privat brenda dhe jashtë vendit. Në syllabuset e paraqitura të programit të studimit Msc. në Logopedi vërehet se përmbajnë informacionet e nevojshme në lëndët (syllabuset janë të detajuara) për secilën lëndë. Lëndët që zhvillon studenti në këtë program përbëjnë bazën e përfitimit e kompetencës profesionale për punësimin e tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X	

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	Realizmi i programit bën të mundur përfitimin e shprehive dhe aftësive të duhura kompetente të nevojshme në ushtrimin e profesionit të tyre. Programi i studimit është i hartuar në mënyrë të tillë që ju siguron studentëve informacionin e duhur për formimin e tyre profesional në ushtrimin e profesionit të logopedistit në shërbime të ndryshme klinike dhe në çdo grup moshë, si dhe përshtatjen e tyre me tregun e punës. Institucioni referon se për përmirësimin dhe përshtatjen e programit të studimit me kërkesat e tregut të punës njësi bazë merr në konsideratë informacionet e përftuara nga takimet e kryera me institucione shëndetësore vendase dhe të huaja në lidhje me kërkesat e tregut të punës gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit. Të diplomuarit në logopedi në bashkëpunim me specialistë të tjerë të kujdesit shëndetësor, janë punonjës të kujdesit shëndetësor në strukturat spitalore, publike ose private, ku ata ushtrojnë profesionin e tyre si Logopedist. Çdo fillim viti akademik Departamenti realizon përditësimin e programit të studimit bazuar në kërkesat e tregut të punës. Gjatë realizimit të këtij procesi një vend të veçantë zënë informacionet e përftuara gjatë takimeve me përfaqësues nga institucione të tjera të IAL me profil mjekësor në vendin tonë, Urdhrin e Infermierit. Takimi me Drejtues të FSHMT [Evidenca 85 Analiza vjetore 2022-2023 DDRSHIKIOGJ]. [Evidenca 49 Lista e bashkëpunimeve me IAL Kombëtare, Ndërkombëtare dhe Institucione të tjera].
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Studentët përfshihen në ndryshimet që realizohen për përmirësimin e Programit të studimit Msc. në "Logopedi". Duke qenë se studentët që fitojnë në këtë program kanë aftësi të mira përdorimi të teknologjisë dhe janë folës të mirë të gjuhëve të huaja, kjo u jep atyre liri mendimi në të shprehur dhe aftësi të sakta krahasim programesh në mjaft institucione. Si rrjedhojë ata kanë pritshmëri të larta lidhur me realizimin dhe zhvillimin e programit të studimit bazuar në kërkesat e tyre. Për përmirësimin e programit të studimit, gjatë orëve mësimore pedagogët e lëndëve diskutojnë si dhe konsultohen me studentët për të marrë mendimin e tyre në lidhje me përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies dhe përditësimin e literaturës së caktuar. Nëse nevojiten ndryshime madhore si të metoda e vlerësimit dhe shlyerjes së detyrimeve, këto përcillen nga koordinatorët e çdo klase ose përmes këshillit studentor. Studentët përfaqësohen në organet e UMT, marrin pjesë në të gjitha proceset e vendimmarrjes së UMT në përputhje me parashikimet ligjore dhe statutore, ndërsa përfaqësuesit e këshillave studentore shprehin mendime



	dhe paraqesin propozime për programet e studimeve të UMT-së rregulloret për veprimtaritë mësimore. Referuar prej shumë vitesh, FSHMT tashmë bën pjesë të vendimarrjes mendimet e studentëve të dhënë për tregues të ndryshëm të institucionit. Qëndrimi dhe mendimi i studentëve në lidhje me përmirësimin e cilësisë së këtij programi studimi është i mundur nëpërmjet pyetësorëve që organizohen nga fakulteti. Në këtë kontekst, vlerësimi i ecursisë së institucionit bazuar në mendimin e studentëve, ka një rëndësi të madhe. Bazuar në rezultatet e pyetësorit tregohet qartazi në grafikë vlerësimi që kanë studentët për organizimin e lëndëve dhe moduleve të programit të studimit nëse ato janë të duhurat si dhe për zhvillimin e veprimtarive në funksion të mësimdhënies, vlerësimi i tyre është pozitiv. Zhvillimi i veprimtarive të tjera përveç leksioneve apo seminareve, shoqërimi i leksioneve me shembuj shpjegues, gadishmëria e pedagogëve për të asistuar dhe ndihmuar studentët, janë disa nga treguesit e vlerësuar nga studentët. [Evidenca 85 Analiza vjetore 2022-2023 DDRSHIKIOGJ]. Takimi me studentët [Evidenca 124 Lista e aktiviteteve të këshillit studentor]. [Evidenca 126 Rregullore e zgjedhjeve të këshillit studentor].
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Në kuadër të përmirësimit të programit Njësia Përgjegjëse bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me mjaft Institucione kërkimore-shkencore që të mundësojë nëpërmjet propozimeve të caktuara përmirësimin e programit. Impenjimi i stafit në spitale publike dhe private u jep mundësi departamenteve të arsyetojnë mendimet e tyre mbi zhvillimet e fundit teknologjike. Gjithashtu përfshirja e stafit akademik ose ndihmës akademik mundëson bashkëpunimin me shumë profesionistë të fushës, urdhrin e infermierit apo shoqata. Gjatë takimit me drejtuesit e departamenteve u referua se në bazë të propozimeve të pedagogëve ata rishikonin dhe përditësonin syllabuset në funksion të përmirësimit të cilësisë. Pedagogët raportuan gjatë takimit me ta se marrin parasysh zhvillimet e fundit në fushën e tyre dhe mundohen ti përfshijnë ato në leksionet që zhvillojnë. Një vend të rëndësishëm zë organizimi i leksioneve të hapura me lektorë të ftuar nga fusha e shëndetit si dhe realizimi i mobiliteteve me programe të njëjta të stafit akademik dhe studentëve.
Konkluzione	Çdo fillim viti akademik Departamenti realizon përditësimin e programit të studimit bazuar në kërkesat e tregut të punës. Për përmirësimin e programit të studimit, gjatë orëve mësimore pedagogët e lëndëve diskutojnë si dhe konsultohen me studentët për të marrë mendimin e tyre në lidhje me përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies dhe përditësimin e literaturës së caktuar. Nëse nevojiten ndryshime madhore si te metoda e vlerësimit dhe shlyerjes së detyrimeve, këto përcillen nga koordinatoret e çdo klase ose përmes këshillit studentor.

	Përfshirja e stafit akademik ose ndihmës akademik mundëson bashkëpunimin me shumë profesionistë të fushës, urdhrin e infermierit apo shoqata.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.6	
Programi i studimit garanton orientim në fushën e studimeve dhe kërkimit shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit përcakton qartë prioritetet dhe objektivat kryesorë të studimit dhe kërkimit shkencor në përputhje me objektivat madhorë të institucionit.	Programi Master i Shkencave në Logopedi i ofruar nga Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike, Universiteti i Mjekësisë Tiranë është hapur si program studimi Diplomë e Nivelit të Dytë në vitin 2013 me VKM Nr. 744, datë 05.09.2013. IAL ka deklaruar në AMS se programi ofrohet nga 3 departamente: 1. Departamenti i Diagnostikës, Rehabilitimit Shëndetësor dhe Infermieristikës në Kirurgji dhe në Obstetrikë Gjinekologji; 2. Departamenti i Lëndëve Klinike dhe Infermieristikës së Përgjithshme dhe Infermieristikës në Sëmundje të Brendshme dhe në Pediatri; 3. Departamenti i Lëndëve Paraklinike. Programi ka qëllim të formojë logopedistë profesionistë me njohuri të mira të teknikave dhe metodave të reja të trajtimit rehabilitues – logopedike, në pacientët me patologji të ndryshme, trajtimit ambulator dhe hospitalor të tyre si dhe kompetencë të lartë në njohuritë e etikës dhe deontologjisë profesionale, legjislacionit mjekësor dhe ruajtjen e sekretit profesional. Programet që ofron Institucioni janë në përputhje me interesat dhe strategjitë kombëtare të zhvillimit të vendit dhe në përputhje me profilin e institucionit. Programet e studimit të ofruara nga institucioni kanë si synim ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare dhe janë në përputhje të plotë me misionin e UMT si dhe objektivat dhe fushën e veprimtarisë së FSHMT. Në lidhje me kërkimin shkencor, ai është një ndër objektivat kryesor të këtij program studimi. Programi i studimit Msc. në Logopedi ka për qëllim të pajisë studentët me kompetencë në kryerjen e studimeve dhe hulumtimeve shkencore me vlerë në fushën e logopedisë. Programi orienton logopedët e specializuar drejt kërkimit shkencor dhe ju ofron studentëve një diplomë cilësore në përputhje me kërkesat e tregut të punës duke u mbështetur në prioritetet strategjike. [Evidenca 91 Plani mësimor MSH logopedi]. [Evidenca 21 Rregullore Msc.Logopedi]. [Evidenca 5 Rregullore e FSHMT]. [Evidenca 170 Plani Strategjik i zhvillimit të UMT].
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë nxit, bashkërendon dhe	UMT zbaton nenin 3 të ligjit Nr. 80/2015 Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL. Njësia Kryesore dhe Njësia Bazë realizon



administron veprimtaritë e mësimdhënies, veprimtaritë kërkimore ose artistike, duke respektuar lirinë akademike të personelit akademik dhe fushën e veçantë të studimit.	mësimdhënien duke respektuar opinionet, idetë, metodat inovatore, mendimin kritik dhe krijues në procesin e mësimdhënies si dhe veprimtarinë kërkimore shkencore në bazë të fushës së vet dhe etikën në kërkimin shkencor. Gjithashtu organizon dhe administron veprimtari të ndryshme akademike. Pedagogët kanë liri në mësimdhënie dhe në veprimtari kërkimore shkencore. Njësia organizon dhe administron procesin akademik duke nxitur, bashkërenduar dhe respektuar lirinë akademike të stafit që shprehet në tematikat e lëndës, literaturës. Dekani i Fakultetit ndjek ecurinë e veprimtarisë kërkimore dhe raporton në Rektorat mbi ecurinë e veprimtarisë dhe organizimit të programit. Gjatë vitit akademik, shpërndarja e orëve të teorisë praktikave dhe projekteve kërkimore shkencore, bën të mundur ndërthurjen e dijeve. Në këtë mënyrë sigurohet liria akademike e pedagogut duke ndihmuar studentët në mbledhjen e të dhënave klinike për të prezantuar raste konkrete në projektet e tyre sipas fushës së studimit. Institucioni realizon leksione të hapura me profesionistë të shëndetit të cilët bashkëbisedojnë me studentët dhe pedagogët për problematika të veçanta të lidhura me profesionin. FSHMT si një nga njësitë kryesore të UMT, partner në projektin IDEA vë në dispozicion të studentëve me aftësi ndryshe aparatura specifike të domosdoshme për integrimin e tyre në procesin mësimor. Në lidhje me aktivitetet studentore, klubet sportive dhe kampionatet e organizuara janë një tjetër mundësi ku studentët shprehin talentet dhe pasionet e tyre. [Evidenca 5 Rregullore e FSHMT]. [Evidenca 192 Zyra e karrieres]. [Evidenca 82 Raporti Vjetor FSHMT 2022-2023].
Kriteri 3. Programi i studimit mundëson, nxit dhe motivon studentët të angazhohen në studime, projekte dhe aktivitete kërkimore.	Gjatë takimeve në institucion, referon se Departamenti nxit studentët të jenë pjesëmarrës në seminare, ë orkshope dhe konferenca dhe të angazhohen në projekte, studime dhe aktivitete kërkimore shkencore. Bazuar në rregulloren e Departamentit studentët kanë të drejtë të përdorin, bazuar në rregulla përkatëse mundësitë dhe pajisjet që ofron shkolla për të realizuar programin mësimor dhe aktivitetin kërkimor shkencor. Programi i studimit i motivon studentët të përfshihen në punë projektuese dhe kërkimore që kontribuojnë në formimin profesional dhe shkencor. Gjatë takimit me stafin akademik, pedagogët e Departamentit të DDRSHIKIOGJ kanë referuar komunikim konstant me studentët si në mësimdhënie ashtu edhe në udhëheqjen e tyre në aktivitete shkencore në nivel Departamenti, udhëheqje esesh, detyrash kursi, mikrotezash, orientim në tregun e punës. Udhëheqësit shkencorë dhe pedagogët u japin support studentëve për publikime në Buletinet Shkencore të Fakultetit por dhe në revista të tjera. Studentët janë angazhuar me pjesëmarrjen e tyre në organizimin e seminareve, E orkshopeve, konferencave shkencore dhe trajnimeve. Përmendim bashkëpunimin e zyrës së karrierës me Cleanscore për trajnimet online të studentëve. Pjesëmarrja e tyre online në konkursin

	"A Research Paper Competition" ju ka dhënë mundësi studentëve të marrin udhëzime për hartimin e një punimi shkencor. Konferenca e Shkencave Mjekësore është event i ku studentët kanë marrë pjesë në mënyrë aktive referimi pa pagesë, apo organizative me pjesëmarrje me detyra të caktuara. [Evidenca 192 Zyra e karrierës]. [Evidenca 85 Analiza Vjetore 2022—2023 DDRSHIKIOGJ]. [Evidenca 15 Aktivitete studentë libri i abstrakteve Konferenca e Shkencave Mjekësore]. [Evidenca 16 Info Sesion për Konkursine Kërkimit Shkencor dedikuar studentëve]. [Evidenca 18 Konferenca Vjetore, libri i abstrakteve FSHMT]. [Evidenca 30 Konferenca Vjetore 2023 FSHMT në bashkëpunim me UV dhe UISH].
Kriteri 4. Për realizimin e aktiviteteve studimore, kërkimore e shkencore, njësi bazë mbështetet financiarisht nga institucioni dhe administron të ardhurat nga aktivitete të ndryshme.	Institucioni referon se mbështet aktivitetet studimore, por edhe ato kërkimore shkencore duke u bazuar dhe mbështetur në buxhetin e miratuar. Organizimi i konferencave të ndryshme është një ndër metodat kryesore efektive në mbështetje të këtyre aktiviteteve. Në fushën kërkimore shkencore në institucion propozohen plane pune vjetore për nxitjen e kërkimit shkencor, gjithashtu propozohen grupe pune të cilat ndjekin realizimin e projekteve kërkimore shkencore dhe ato të aplikuara. Vlen për tu vlerësuar organizimi i bashkëpunimeve me grupe të tjera kërkimore shkencore jashtë Departamentit, Fakultetit, Universitetit, vendit. Fakulteti ofron revistë free of charge ku secili department ka buxhet të vecantë. Institucioni organizon publikimin e rezultateve të punës shkencore që zhvillon grupi apo anëtarët e tij. Studentët e FSHMT janë përfshirë në Kongresin e Shkencave Mjekësore 2023 madje dhe në Konkursin e Kërkimit Shkencor dedikuar studentëve në Nëntor 2023. Në takimin me stafin akademik u theksua se personeli akademik edhe pse ka patur mbështetje të limituar financiare nga Fakulteti, përmes financimeve nga projektet, donacionet ka mundur të realizojë kërkimin shkencor dhe të impenjohet në mobilitete. FSHMT për të mbështetur stafin dhe studentët ka mundur gjetjen e burimeve alternative si programet COST, programet Erasmus, projekte AKKSHI. Projekte ndërkombëtare në të cilat UMT ka marrë pjesë janë: Projekti MEDIGENE (2012-2015), EUSCREEN (2017 -2020), GRADUA (Erasmus + Capacity Building) (2017 -2020), CEI (Korrik 2020- Janar 2021), Forcimi i kapaciteteve të sistemit shëndetësor për zbatimin e Kontrollit dhe Parandalimit të Infeksioneve në kuadër të COVID-19 (1 Mars - Prill 2021), AUF (2021-2022). Referuar Raportit 2021-2022 FSHMT, lista e veprimtarive shkencore të organizuara dhe financuara nga njësitë bazë në FSHMT për vitin 2022 në të cilin u verifikua se një nga zërat është dhe kërkimi shkencor dhe financimet mbi të. Për të gjitha aktivitetet në lidhje me kërkimin shkencor nuk ka pasur donatorë, dhe shpenzimet janë përballuar nga të ardhurat dytësore të Fakultetit.

	[Evidenca 6 Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ]. [Evidenca 15 Aktivitete studentë libri i abstrakteve Konferenca e Shkencave Mjekësore]. [Evidenca 16 Info Sesion për Konkursin e Kërkimit Shkencor dedikuar studentëve]. [Evidenca 111 Relacion Raportim 2022 FSHMT Financa] [Evidenca 45 Lista e projekteve ndërkombëtare të aplikuara dhe të fituara] [Evidenca 103 Raportimi për zbatimin e buxhetit nga të ardhurat 3 vite]. [Evidenca 104 Raportimi për zbatimin e buxhetit granti 3 vite]. [Evidenca 105 Raport 2021-2022 FSHMT Financa]. [Evidenca 106 Praktika për miratimin e buxhetit 2020-2024].			
Konkluzione	Njësia Kryesore dhe Njësia Bazë realizon mësimdhënien duke respektuar opinionet, idetë, metodat inovatore, mendimin kritik dhe krijues në procesin e mësimdhënies si dhe veprimtarinë kërkimore shkencore në bazë të fushës së vet dhe etikën në kërkimin shkencor. Gjithashtu organizon dhe administron veprimtari të ndryshme akademike. Njësia organizon dhe administron procesin akademik duke nxitur, bashkërenduar dhe respektuar lirinë akademike të stafit që shprehet në tematikat e lëndës, literaturës. Fakulteti, përmes financimeve nga projektet, donacionet ka mundur të realizojë kërkimin shkencor dhe të impenjohej në mobilitete. FSHMT për të mbështetur stafin dhe studentët ka mundur gjetjen e burimeve alternative si programet COST, programet Erasmus, projekte AKKSHI.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.7	
Programi i studimit garanton njohuri të thelluara, ndërkombëtarizim dhe kërkim shkencor.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia përgjegjëse mbështet grupet lëndore dhe projektet kërkimore-shkencore të reja dhe siguron bashkëpunimin me struktura të tjera kërkimore për realizimin e objektivave të programit të studimit në kërkim shkencor.	UMT i kushton rëndësi të vecantë koordinimit të aktivitetit mësimor me atë kërkimor-shkencor. Këtë e realizon nëpërmjet impenjimit dhe përfshirjes së studentëve në kërkim shkencor. Veprimtaria kërkimore shkencore që zhvillohet në UMT i jep mundësi studentëve të aftësohen në metodologjinë e kërkimit, si dhe u jep mundësi të vazhdueshme për plotësimin e disiplinave mësimore me njohuri shkencore dhe praktike të avancuara, kjo nëpërmjet përfshirjes në programet mësimore të metodave, teknikave dhe teknologjive me karakter teorik dhe praktik në lidhje me kërkimin shkencor.



	UMT ka Marrëveshje për Diploma të Përbashkëta me Universitetin e Bolonjës, si dhe Marrëveshja me Universitetin e Vlorës ku janë realizuar aktivitete shkencore nga personeli akademik dhe studentët. Institucioni referon se akumulimi i të dhënave kërkimore shkencore të studentëve për të realizuar detyrat lëndore i mbështet projektet e lëndëve të cilat fokusohen dhe bazohen në objektivat e masterit. Raportimet vjetore bazuar në analizën për aktivitetin kërkimor shkencor për vitet 2017-2022 tregojnë qartazi se ka pasur një rritje me 45% të botimeve në revista shkencore krahasuar me vitet 2017-2020. Rritje me 90% të botimeve në revista me faktor impakti, rritje me 66 % të botimeve me pjesëmarrje të studentëve, rritje me 22 % të referimeve në konferenca, rritje me 146 % të pjesëmarrjes në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare, rritje me 41% të botimeve të librave dhe me 150 % të monografive. Projektet kërkimore shkencore realizohen në struktura mbështetëse dhe departamente që sigurojnë bashkëpunimin me strukturat e tjera kërkimore shkencore për realizimin e objektivave të programit të studimit Msc. në Logopedi. Nga takimi me pedagogët u referua se studentët kanë akses të plotë në realizimin e praktikës spitalore, duke patur në këtë mënyrë akses të mirë të pacientët për të parë dhe studiuar rastet klinike nga afër. Gjithashtu ata referojnë se studentët mund ti mbledhin të dhënat nga qendrat spitalore me të cilat institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi. Nga diskutimet e bëra u raportua se në kuadër të projekteve të AKSHIT, janë përpiluar dhe zbatuar projekte shumë të mira nga profesionistë që jo vetëm kanë aftësi shkruese të projektit por dhe zbatuese të tij. Info-Sessioni për Konkursin e Kërkimit Shkencor dedikuar studentëve, është një tregues shumë i mirë i përfshirjes së studentëve në kërkim shkencor. Pjesëmarrja në projekte me fonde kombëtare ose ndërkombëtare është objektiv i targetuar në vijim. Veprimtaria kërkimore shkencore që zhvillohet në UMT i jep mundësi studentëve të aftësohen në metodologjinë e kërkimit, si dhe u jep mundësi të vazhdueshme për plotësimin e disiplinave mësimore me njohuri shkencore dhe praktike të avancuara, kjo nëpërmjet përfshirjes në programet mësimore të metodave, teknikave dhe teknologjive me karakter teorik dhe praktik në lidhje me kërkimin shkencor. MSHMS-ja dhe UMT bashkëpunojnë për zhvillimin e praktikave klinike/diagnostike, profesionale dhe kërkimin shkencor.UMT ka Marrëveshje për Diploma të Përbashkëta me Universitetin e Bolonjës, si dhe Marrëveshja me Universitetin e Vlorës ku janë realizuar aktivitete shkencore nga personeli akademik dhe studentët. Institucioni referon se akumulimi i të dhënave kërkimore shkencore të studentëve për të realizuar detyrat lëndore i mbështet projektet e lëndëve të cilat fokusohen dhe bazohen në objektivat e masterit. Projektet kërkimore shkencore realizohen në struktura mbështetëse dhe departamente që sigurojnë bashkëpunimin me strukturat e tjera kërkimore shkencore për realizimin e objektivave të programit të studimit MP në
--	--



	Logopedi. Nga takimi me pedagogët u referua se studentët kanë akses të plotë në realizimin e praktikës spitalore, duke patur në këtë mënyrë akses të mirë të pacientët për të parë dhe studiuar rastet klinike nga afër. Gjithashtu ata referojnë se studentët mund të mbledhin të dhënat nga qendrat spitalore me të cilat institucioni ka marrëdhënie bashkëpunimi. Nga diskutimet e bëra u raportua se në kuadër të projekteve të AKSHIT, janë përpiluar dhe zbatuar projekte shumë të mira nga profesionistë që jo vetëm kanë aftësi shkruese të projektit por dhe zbatuese të tij. Info-Sessioni për Konkursin e Kërkimit Shkencor dedikuar studentëve, është një tregues shumë i mirë i përfshirjes së studentëve në kërkim shkencor. Pjesëmarrja në projekte me fonde kombëtare ose ndërkombëtare është objektiv i targetuar në vijim. [Evidenca 1 Statuti UMT]. [Evidenca 5 Rregullore e FSHMT]. Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë Takim me stafin akademik [Evidenca 46 Memorandume bashkëpunimi UMT me MSHMS] [Evidenca 102 Marrëveshje bashkëpunimi praktikat logopedi] [Evidenca 101 Lista e bashkëpunimeve me institucione të tjera] [Evidenca 152 Lista e botimeve të revistës shkencore të FSHMT] [Evidenca 49 Lista e bashkëpunimeve me IAL kombëtare, ndërkombëtare dhe institucione të tjera] [Evidenca 170 Plani strategjik i zhvillimit të UMT 2021-2024] [Evidenca 44.1 Projekte Ndërkombëtare të fituara] [Evidenca 154 Analizë për aktivitetin kërkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik të UMT]. [Evidenca 116 Projekti i Qendrës së Biosimulimit klinik dhe Edukimit në vazhdim]
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse angazhohet për t'iu përgjigjur kërkesave për analiza, studime e projekte me karakter kërkimor shkencor dhe angazhon personelin akademik dhe studentët për realizimin e këtyre objektivave.	UMT ka bashkëpunime në nivel kombëtar me universitete dhe institucione të arsimit të lartë, apo institucione universitare shëndetësore, në fushën akademike, kërkimore shkencore dhe mjekësore me synim ndërkombëtarizimin. Implementimi i marrëveshjeve ekzistuese për bashkëpunim ndërkombëtar, promovimi i marrëveshjeve të reja duke qenë se janë në funksion të veprimtarisë kërkimore – shkencore, me synim ndërkombëtarizimin kanë prioritet: rritjen e numrit të projekteve kërkimore shkencore me grante nga programe të Bashkimit Europian apo ndërkombëtare si dhe ofrimin e programeve të përbashkëta të studimit me universitete të vendeve të Bashkimit Europian. Njësia bashkëpunon me institucione homologe me qëllim kërkimin shkencor. Pedagogë të huaj marrin pjesë në mësimdhënie si dhe organizojnë leksione të hapura. Këto aktivitete mundësojnë rritjen e zhvillimit të kërkimit shkencor. Gjithashtu Njësia inkurajon pedagogët të marrin pjesë në mobilitete jashtë vendit përmes programit Erasmus. Falë këtij programi një pjesë e mirë e pedagogëve kanë zhvilluar mobilitete jashtë shtetit, gjë që i ka ndihmuar ata në aktivitetin kërkimor shkencor në trajnime, dhe ë orkshope të fushës

	së tyre. Aplikime në projekte kërkimore shkencore me partner të brendshëm dhe të huaj u raportua nga Drejtuesit e FSHMT dhe Departamenteve se janë zhvilluar. Pjesëmarrja në projekte me fonde kombëtare ose ndërkombëtare vazhdon të jetë objektiv i Departamentit të DDRSHIKIOGJ. DDRSHIKIOGJ ka pjesëmarrje në projekte ndërkombëtare si projekti “Development of simulation and forecasting models and integration with TCIA database of medical images” me pjesëmarrjen e N. H, pjesë e projekteve të READ & K.S dhe D.XH. Nga analiza e bërë mbi raportimet vjetore për pesë vitet e fundit rezultoi se gjatë vitit akademik 2021-2022 ka pasur një rritje me 45% të botimeve në revista shkencore krahasuar me mesataren vjetore të viteve 2017-2020, rritje me 90% të botimeve në revista me faktor impakti, rritje me 66% të botimeve me pjesëmarrje të studentëve, rritje me 22% të referimeve në konferenca/seminare shkencore me pjesëmarrje të studentëve, rritje me 146% të pjesëmarrjes në projekte kombëtare e ndërkombëtare, rritje me 41% të botimeve të librave dhe me 150% të Monografive. [Evidenca 170 Plani strategjik i zhvillimit të UMT 2021-2024] [Evidenca 154 Analizë për aktivitetin kërkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik të UMT] [Evidenca 45 Lista e projekteve kombëtare të aplikuara dhe të fituara] [Evidenca 44 Lista e projekteve ndërkombëtare të aplikuara dhe të fituara] [Evidenca 166 Lista e mobiliteteve hyrëse dhe dalëse] [Evidenca 44.1 Projekte Ndërkombëtare të fituara] [Evidenca 83, 84, 85 Analiza vjetore DDRSHIKIOGJ] Takim me Drejtuesit e Njesisë Kryesore dhe Njesisë Bazë Takim me stafin akademik
Kriteri 3. Në fushën e programit të studimit, njësia përgjegjëse organizon konferenca ose aktivitete, të cilat ndihmojnë personelin dhe studentët për arritjen e objektivave.	Njësia mbështetëse mbështet realizimin e konferencave kombëtare dhe ndërkombëtare dhe rajonale si dhe organizon aktivitete të ndryshme të cilat ndihmojnë studentët dhe personelin akademik. Studentët kanë patur mundësinë dhe aksesin të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme trajnuese ndërsa personeli akademik ka marrë pjesë në leksione të hapura dhe aktivitete të ndryshme. Në organizimin e seminareve janë alteruar veprimtari që përfshijnë punët individuale, punë në grupe, punë krijuese, prezantime. Aktiviteti shkencor ka një karakteristikë tjetër sepse qartazi duket prirja për bashkëpunim mes kolegësh, bashkëpunim me studentët, bashkëpunim me të tretët. Një vend të rëndësishëm zënë leksionet e hapura me pedagogë të ftuar, ku studentët janë pjesëmarrës aktivë nëpërmjet temave studimore, rezultateve të projekteve ku kanë qenë pjesëmarrës me pedagogët e tyre apo botimeve në revista shkencore të universitetit. Për FSHMT nga analizimi i të dhënave të mbledhura rezultoi se departamenti me numër më të lartë botimesh në total, botimesh me faktor

	impakti, botime librash dhe referimesh në konferenca/seminare shkencore është DRSHIKOGJ, ndërkohë që departamenti me pjesëmarrje më të lartë në projekte dhe botime monografish rezultoi ai i Lëndëve Paraklinike. Në 5 vitet e fundit FSHMT ka botuar 2 numra të Revistës” Mjekësia dhe Infermiera Bashkëkohore dhe është në proces një numër i ri. [Evidenca 1 Statuti UMT]. [Evidenca 5 Rregullore FSHMT] [Evidenca 154 Analizë për aktivitetin kërkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik të UMT] [Evidenca 152 Lista e botimeve të revistës shkencore të FSHMT]
Kriteri 4. Programi i studimit formon profesionistë konkurrues për tregun kombëtar dhe ndërkombëtar të punës.	Programi i studimit bazuar në objektivat dhe misionin e tij synon rritjen e kapaciteteve profesionale në fushën e logopedisë dhe përgatitjen e logopedëve të aftë për të përballuar sfidat e zhvillimit në fushat e shkencave mjekësore. Institucioni referon se programi i studimit Msc. në Logopedi formon logopedistë profesionistë me njohuri të mira të teknikave dhe metodave të reja të trajtimit rehabilitues –logopedike, në pacientët me patologji të ndryshme, trajtimit ambulator dhe hospitalor të tyre si dhe kompetencë të lartë në njohuritë e etikës dhe deontologjisë profesionale, legjislacionit mjekësor dhe ruajtjen e sekretit profesional. FSHMT favorizon punësimin e studentëve. Fakulteti shërben si urë lidhëse midis studentëve që ndjekin studimet, të diplomuarve dhe institucioneve shëndetësore, klinikat. Përmes platformës GRADUA (platformë inovative që ka për qëllim lehtësimin e pozicionimit të të diplomuarve në tregun e punës) studentët pas diplomimit plotësojnë formularin dhe përditësojnë të dhënat individuale në mënyrë të vazhdueshme. FSHMT dhe UMT është ura lidhëse midis të diplomuarve dhe tregut të punës, përmes Marrëveshjeve të lidhura me Ministrinë e Shëndetësisë. Një pjesë e të diplomuarve punësohen jashtë vendit tregues ky i rëndësishëm që paraqet qasjen e programit me atë evropian. [Evidenca 91 Plani mësimor] [Evidenca 154 Analizë për aktivitetin kërkimor-shkencor, projektet dhe mobilitetin e stafit akademik të UMT] [Evidenca 30 Konferenca Vjetore 2023 FSHMT në bashkëpunim me UV dhe UISH] [Evidenca 192 Zyra e karrierës]
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse merr parasysh dhe zbaton rekomandimet e nxjerra nga urdhrat, shoqatat profesionale, rrjetet profesionale, për kompetencat e nevojshme për marrjen e licencës së profesionit	FSHMT ka një bashkëpunim shumë të mirë me Urdhërat e Logopedistëve Shqipëtarë si dhe me Urdhrin e Infermierit të Shqipërisë. Urdhri i Infermierit përbëhet nga profesionistë ndër ta edhe logopedistë të cilët kanë diplomën përkatëse dhe që e ushtrojnë profesionin në Republikën e Shqipërisë. Të drejtën e ushtrimit të një profesioni të rregulluar, çdo kandidat e fiton pasi:

përkatës, sipas akteve ligjore të fushës.	a) kryen praktikën profesionale; b) kryen provimin e shtetit; c) regjistrohet në UP-në përkatëse. Nëpërmjet bashkëpunimit me Urdhrin e Infermierit është mundësuar koordinimi i veprimtarive për realizimin e praktikës pasi kanë përfunduar studimet, provimi i shtetit si dhe liçensimi i studentëve. [Evidenca 52 Ligji UISH 2014 - 140222] [Evidenca 51 Ligj NR 10 171 PRR]			
Kriteri 6. Programi i studimit për profesionet e rregulluara përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian (p.sh. <i>Professional Qualifications Directive, 2005/36/EU</i>).	Në vizitën e GVJ, Institucioni referon se, përputhet me aktet ligjore në vend dhe rekomandimet ndërkombëtare në direktiva dhe rregullore të Bashkimit Evropian.			
Konkluzione	UMT i kushton rëndësi të vecantë koordinimit të aktivitetit mësimor me atë kërkimor-shkencor. Këtë e realizon nëpërmjet impenjimit dhe përfshirjes së studentëve në kërkim shkencor. Veprimtaria kërkimore shkencore që zhvillohet në UMT i jep mundësi studentëve të aftësohen në metodologjinë e kërkimit, si dhe u jep mundësi të vazhdueshme për plotësimin e disiplineve mësimore me njohuri shkencore dhe praktike të avancuara. Projektet kërkimore shkencore realizohen në struktura mbështetëse dhe departamente që sigurojnë bashkëpunimin me strukturat e tjera kërkimore shkencore për realizimin e objektivave të programit të studimit Msc. në Logopedi. Njësia bashkëpunon me institucione homologe me qëllim kërkimin shkencor. Pedagogë të huaj marrin pjesë në mësimdhënie si dhe organizojnë leksione të hapura. Këto aktivitete mundësojnë rritjen e zhvillimit të kërkimit shkencor. Institucioni referon se programi i studimit Msc. në Logopedi formon logopedistë profesionistë me njohuri të mira të teknikave dhe metodave të reja të trajtimit rehabilitues –logopedike. Një pjesë e të diplomuarve punësohen jashtë vendit tregues ky i rëndësishëm që paraqet qasjen e programit me atë evropian.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Standardi III.1	
Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira, me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/estetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Njësia Kryesore/Bazë është përgjegjëse për procesin e mësimdhënies dhe cilësinë në programet e studimit. Programi Msc. në Logopedi e zhvillon veprimtarinë e tij bazuar në parimet e lirisë dhe cilësisë akademike. Kjo zbatohet në përputhje me planet dhe programet mësimore të hartuara dhe të miratuara nga strukturat akademike të FSHMT dhe UMT për të gjitha lëndët dhe modulet që përfshihen në të. Të gjitha lëndët e ofruara janë të detyrueshme. Gjatë ciklit të dytë të studimeve studenti thellon njohuritë lidhur me zhvillimin gjuhësor, problematikat që prekin gjuhën receptive, dhe gjuhën ekspresive gjatë gjatë moshë evolutive si të fëmijët ashtu dhe te adultët me çrregullime të ndryshme të të folurit. Ky program studimi pajisë studentët me kompetencë të lartë në njohuritë e etikës dhe deontologjisë profesionale, legjislacionit mjekësor dhe ruajtjen e sekretit profesional; ofron njohuri të mira të teknikave dhe metodave të reja të trajtimit reabilitues – logopedike, në pacientët me patologji të ndryshme, trajtimit ambulator dhe hospitalor të tyre. Orët e mësimi i përshtaten natyrës së lëndëve me qëllim impenjimin dhe angazhimin e të gjithë studentëve për të arritur nxënie sa më efikase. Për të patur përvetësim më të mirë të njohurive procesi mësimor zhvillohet nëpërmjet orëve teorike, hulumtimit shkencor dhe praktikës klinike: leksioneve, seminareve, detyrave të kursit, prezantimeve, praktikës. Mësimdhënia është realizuar duke organizuar disa forma mësimore si leksione, seminare, mësim praktikë, ushtrime, laboratore, praktika mësimore, prezantime të detyrave, prezantime të rasteve nga praktika. Bazuar në këndvështrimin profesional dhe eksperiencës së pedagogëve, nevojës së paraqitjes së leksionit, leksionet nga pedagogët e departamenteve në të gjitha ciklet e studimit janë realizuar dhe organizuar duke alteruar një gamë të gjerë metodiko-didaktike për të rritur kapacitetin përfitues nga ana e studentëve. Në organizimin e seminareve janë alternuar veprimtari që përfshijnë punë individuale, punë në grupe, punë krijuese, prezantime. Praktikë janë realizuar me qarkullim 2-3 javor në shërbime spitalore të ndryshme sipas kurrikulës mësimore, për të mundësuar përfitime njohurish sa më të mëdha nga ana e studentëve. Pedagogët e departamentit të DDRSHIKIOGJ janë në komunikim të vazhdueshëm pranë tyre në mësimdhënie dhe në udhëheqje të aktiviteteve shkencore në nivel departamenti, udhëheqje esesh, detyrash kursi, mikrotezash, orientim në tregun e punës. Stili i komunikimit ka qenë gjithmonë i hapur, reflektiv, i është përshtatur dinamikës dhe modelit KAIZEN, të përmirësimit dinamik dhe të vazhdueshëm.

	Departamenti realizon leksione të hapura me ekspertë të fushës së shëndetit, referuar kjo nga Institucioni. Kontrolli i dijeve është i vazhdueshëm përgjatë gjithë semestrit. [Evidenca 2 Rregullore UMT] [Evidenca 86 Program Msc. në Logopedi]. [Evidenca 82 Raporti Vjetor FSHMT 2022-2023]. [Evidenca 85 Analiza Vjetore 2022-2023 DDRSHIKIOGJ].
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Institucioni ka siguruar infrastrukturën mësimore, e cila mundëson përdorimin e metodave pedagogjike adekuate dhe fleksible të përshtatshme me temat e lëndëve dhe objektivat e tyre në funksion të formimit profesional. Personeli akademik i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti. Veprimtaria akademike realizohet ndërmjet orëve teorike, hulumtimit shkencor dhe praktikës klinike, leksioneve seminareve, detyrave të kursit, prezantimeve, praktikës. Diskutimi me studentët realizohet gjatë orëve të mësimit me pedagogët e lëndëve për të përmirësuar metodat e mësimdhënies dhe për të konsultuar literaturë të përditësuar. Studentët kanë mundësi të marrin pjesë në konsultime nga personeli akademik për të përvetësuar konceptet themelore të lëndëve. Në programin e studimit Msc. në Logopedi personeli akademik përdor forma të ndryshme të mësimdhënies dhe mësimnxënies përveç atyre klasike, përdoret metoda sanduiç, përdoren mjete audio-vizive. Infrastruktura ekziston me laptop dhe videoprojektor ku paraqiten informacionet të shoqëruara me foto, diskutohen studime rasti nga praktika lëndore. FSHMT ka ngritur një qendër simulimi. Përdoren metodat e simulimit, role – play. Ndërthurren shumë metodika për mësimdhënie, video, shënime, ppt, skica. Gjatë vizitës të realizuar në ambjentet e FSHMT u vu re se klasat ishin të pajisura me mjete bashkëkohore të nevojshme për procesin e mësimdhënies. RVB [Evidenca 21 Rregullore Msc. Logopedi, Syllabusët e lëndëve]. [Evidenca 6 Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ] [takimi me studentët]. [takimi me stafin akademik]. Vizita në institucion [Evidenca 118 Infrastruktura në funksion të mësimdhënies, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë].
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave	Institucioni mbështet pedagogët për përmirësimin e aftësive dhe kompetencave profesionale dhe metodave të mësimdhënies, nëpërmjet mbështetjes për pjesëmarrje në programe bashkëpunimi për shkëmbim experience midis IAL në kuadër të programeve ERASMUS, konferenca

didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	shkencore, aktivitetet trajnuese sipas shkallës së kualifikimit, përgatitje të projekteve, përfshirjen e tyre në marrëveshje bashkëpunimi me institucione publike apo jo publike. Gjatë vizitës që GVJ ka realizuar në institucion, institucioni referon se mbështet dhe ofron mundësinë e mobilitetit të personelit akademik dhe ndihmës akademik pranë institucioneve partnere, për të përmirësuar kompetencat didaktike. Në këto universitete partnere pedagogët kanë mundësi të trajnohen dhe të zhvillojnë leksione. Mbingarkesa e pedagogëve në QSUT dhe FSHMT nuk ndikon në cilësinë e mësimdhënies, pasi ata sjellin shembuj nga praktika në FSHMT dhe e kundërta. [Evidenca 46 Memorandume bashkëpunimi UMT me MSHMS] [Evidenca 102 Marrëveshje bashkëpunimi praktikat logopedi] [Evidenca 101 Lista e bashkëpunimeve me institucione të tjera] [Evidenca 49 Lista e bashkëpunimeve me IAL kombëtare, ndërkombëtare dhe institucione të tjera] [Evidenca 166 Lista e mobiliteteve hyrëse dhe dalëse].
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë. Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin Msc. në Logopedi ka përgatitje profesionale pedagogjike dhe eksperiencë mjekësore në lëndët që zhvillon. Për ta bërë pjesën teorike sa më tërheqëse dhe interesante për studentin institucioni i mundëson stafit akademik përdorimin e metodave të ndryshme në mësimdhënie si: prezantime poëer point, video-projektor, shkrim në tabelë, metoda interaktive dhe diskutime me në qendër studentin Gjatë takimit me studentët, ata referojnë se vlerësojnë stafin dhe programin e studimit përmes pyetësorit që zhvillohet. Studenti mund të përdorë bibliotekën e FSHMT dhe atë online ku mund të konsultojnë libra të mjekësisë rehabilituese. Gjithashtu u theksua nga ana e tyre se ata marrin pjesë aktive gjatë leksioneve dhe pedagogët në mënyrë interaktive i përfshijnë studentët në tematikat e lëndës, në pikat kyçe të tyre ku ndihet nevoja për të diskutuar çështjet thelbësore. [Evidenca 96 CV e personelit akademik të angazhuar në program studimi].
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	Departamenti DDRSHIKOIGJ si njësia bazë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor është njësia përgjegjëse për zhvillimin e këtij programi studimi, ka siguruar infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e pjesës së praktikës mësimore apo zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Pedagogët e këtij departamenti janë në komunikim konstant me studentët dhe pranë tyre si në mësimdhënie ashtu dhe në udhëheqjen e tyre në aktivitete shkencore në nivel departamenti, detyra kursi, projekte, orientim në tregun e punës. Stili i komunikimit ka qenë i hapur, reflektiv dhe i është përshtatur dinamikës dhe modelit KAIZEN, të përmirësimit dinamik dhe të vazhdueshëm. Janë përmirësuar laboratorët dhe janë shtuar pajisjet, mjetet,

	instrumentat demonstrues për rritjen e përqindjes së përfshirjes në total të qasjeve praktike “learning by doing”. Rezultatet e arritura në provime është një mekanizëm me qëllim vlerësimin e mësimdhënies. Në nivel institucional, Institucioni ka zyrat administrative dhe Drejtorinë e Kurrikulave një tjetër mekanizëm që tregon cilësinë e mësimdhënies nëpërmjet plotësimit të pyetësorit të cilësisë. Sondazhi Kombëtar i studentëve merret nga ASCAL. Më pas Fakulteti i merr rezultatet duke parë pikat e forta dhe të dobta. Të gjitha këto analizohen dhe bëhen pjesë e raportit përfundimtar të Departamenteve dhe Raporteve Vjetore. [Evidenca 27 Pyetësi i studentëve FSHMT].
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	Institucioni ka të organizuar me akte rregullatore mënyrën e funksionimit të UMT/Fakulteteve/Departamenteve/Programeve të studimit të cilat janë në funksion të organizimit të mësimdhënies në programe të ndryshme që ka UMT. Institucioni ka në dispozicion të personelit akademik dhe të studentëve për zhvillimin e procesit mësimor, kërkimor shkencor, spitalor e klinik, dhe asetet e strukturave shëndetësore universitare. Infrastruktura në dispozicion të studentëve, personelit akademik dhe administrativ plotëson normat e përcaktuara në standartet shtetërore përkatëse. Njësia kryesore që asiston në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencorë është NJSBC dhe Qendra Kërkimore Shkencore përmes trajnimeve, projekteve të vazhdueshme, aktiviteteve shkencore edukuese dhe ndërgjegjësuere ku përfshihet stafi akademik. Strukturat akademike dhe ndihmës akademike që janë pjesë përbërëse e institucionit kanë qëllim funksione të ndryshme duke përfshirë koordinimin institucional, projektet, cilësinë. Veprimtaria Shkencore është pika e fortë e këtij departamenti (DDRSHIKIOGJ). Vlen të theksohet vijimi i hartimit të monografive si synim i nxitur nga drejtuesi i Departamentit. Institucioni ka NJSBC e cila është përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në nivel institucional. Kjo njësi harton plan pune që miratohet nga Rektori i UMT dhe e ndjek atë në vitin pasardhës, NJSBC-ja harton raporte të vlerësimeve të cilat përdoren si burim për analiza të mëtejshme për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies e të kërkimit shkencor në njësitë kryesore të UMT-së, apo dhe për vlerësimin e jashtëm të cilësisë të cilat janë detyrim institucional. Për ta bërë pjesën teorike sa më tërheqëse dhe interesante për studentin institucioni i mundëson stafit akademik përdorimin e metodave të ndryshme në mësimdhënie si: prezantime poë er point, video-projektor, shkrim në tabelë, metoda interaktive dhe diskutime me në qendër studentin. [Evidenca 169 Raporti i vlerësimit të brendshëm Institucional UMT maj 2022].

Konkluzione	Mësimdhënia është realizuar duke organizuar disa forma mësimore si leksione, seminare, mësim praktikë, ushtrime, laboratore, praktika mësimore, prezantime të detyrave, prezantime të rasteve nga praktika. Në organizimin e seminareve janë alternuar veprimtari që përfshijnë punë individuale, punë në grupe, punë krijuese, prezantime. Praktikantët janë realizuar me qarkullim 2-3 javor në shërbime spitalore të ndryshme sipas kurrikulës mësimore, për të mundësuar përfitime njohurish sa më të mëdha nga ana e studentëve. Personeli akademik i përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin Msc. në Logopedi ka përgatitje profesionale pedagogjike dhe eksperiencë mjekësore në lëndët që zhvillon. Departamenti DDRSHIKOIGJ si njësi bazë e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor është njësi përgjegjëse për zhvillimin e këtij programi studimi, ka siguruar infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e pjesës së praktikës mësimore apo zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies. Institucioni ka NJSBC e cila është përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në nivel institucional.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.2 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore dhe garanton zbatimin e tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Institucioni disponon gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon organizimin e provimeve dhe vlerësimin e njohurive të studentëve të cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik dhe u vihet këtyre të fundit në dispozicion në ebsite e UMT. GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe referuar takimeve të zhvilluara në institucion me stafin drejtues, pedagogë dhe student konstatoi se vlerësimi i njohurive të studentëve, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në rregulloren e institucionit miratuar nga rektori. Në rregulloren e departamentit përcaktohen qartë mënyra e kontrollit të dijeve dhe vlerësimi. Në rregulloren e programit të studimit Msc. në Logopedi përcaktohen procedurat dhe kriteret e vlerësimit, si dhe hyrja në provim dhe zhvillimi i tij.

	Informacioni i detajuar mbi vlerësimin e njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përfshihet në syllabusin e secilit modul. Tashmë prej disa vitesh përdoret sistemi i automatizuar i testimit dhe vlerësimit të njohurive CLEANSORE. Institucioni referon se është realizuar implementimi i tij në këtë Fakultet. Ky system ka rezultuar i saktë dhe është i aplikuar në të tre programet. Mënyra e kontrollit të njohurive në çdo modul/lëndë përcaktohet me rregulloren ku i referohen syllabusit përkatës, i cili u bëhet me dije studentëve që në fillim. Rregulloret janë të aksesueshme nga studentët dhe publiku në faqen zyrtare të UMT. Vlerësimi i përgatitjes së studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. [Evidenca 5 Rregullore FSHMT] [Evidenca 21 Rregullore Msc. Logopedi] [Evidenca 86 Program Msc. Logopedi, syllabuset e Lëndëve]
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Gjatë takimit me pedagogët në institucion ata referuan se studentët informohen nga këshilltari akademik në fillim të vitit akademik dhe titullari i lëndës/modulit me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore apo lëndëve të veçanta të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve, rregulloren e funksionimit të FSHMT si dhe rregulloren e zhvillimit të provimeve. Gjithashtu në fillim të çdo viti akademik është java e informimit të studentëve. Studentët janë të interesuar dhe bashkëpunues. Studentët njihen me mënyrën e vlerësimit të dijeve së bashku me afatet ku duhet të plotësohet secili detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës. Ata pohuan se pedagogu i lëndës në fillim të moduleve i informon për mënyrën e frekuentimit të procesit mësimor, mbi metodologjinë e testimit dhe vlerësimit të njohurive. Frekuentimi i leksioneve është i detyrueshëm në masën jo më pak se 50% të orëve, frekuentimi i seminareve/ushtrimeve është i detyrueshëm në masën jo më pak se 75% të orëve, frekuentimi i laboratorëve dhe praktikës në masën 100%. Vlerësimi i dijeve bëhet në mënyrë të vazhdueshme bëhet sipas rregullores së FSHMT dhe rregullores së programit. Gjithë informacioni rreth lëndës ju vihet në dispozicion studentëve nga pedagogu i lëndës në secilin syllabus. Takim me studentët Takim me stafin akademik [Evidenca 5 Rregullore FSHMT] [Evidenca 21 Rregullore Msc. Logopedi] [Evidenca 86 Program Msc. Logopedi, syllabuset e Lëndëve]
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të	Testimi dhe vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.

ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Bazuar në Rregulloren e programit Msc. në Logopedi vlerësimi në një lëndë mund të bëhet: a) provim me shkrim, me gojë ose i kombinuar; b) me detyra kursi; c) I bazuar në kombinimin e formave të mësipërme të vlerësimit Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistemin prej 10 notash. Notat nga 5 e lart janë kaluese. Me përfundim të të gjitha detyrimeve të përcaktuara në planin mësimor të programit Msc. Logopedi studenti pajiset me diplomë dhe suplementin e saj. Gjatë takimit me pedagogët në institucion ata referuan se gjatë zhvillimit të lëndës vlerësojnë studentët dhe performancat e tyre merren parasysh në notën përfundimtare të vlerësimit të studentit. Proçedura e provimeve kryhet në bazë të rregullores së provimeve/rregullore e Departamentit DDRSHIKIOGJ, Rregullore Programi Msc. Logopedi. [Evidenca 21 Rregullore Msc. Logopedi]			
Konkluzione	Vlerësimi i njohurive të studentëve, dijeve dhe aftësive profesionale dhe shkencore përcaktohen në rregulloren e institucionit miratuar nga rektori. Në rregulloren e departamentit përcaktohen qartë mënyra e kontrollit të dijeve dhe vlerësimi. Në rregulloren e programit të studimit Msc. në Logopedi përcaktohen proçedurat dhe kriteret e vlerësimit, si dhe hyrja në provim dhe zhvillimi i tij. Studentët informohen nga këshilltari akademik në fillim të vitit akademik dhe titullari i lëndës/modulit me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore apo lëndëve të veçanta të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve, rregulloren e funksionimit të FSHMT si dhe rregulloren e zhvillimit të provimeve. Bazuar në Rregulloren e programit Msc. në Logopedi vlerësimi në një lëndë mund të bëhet: provim me shkrim, me gojë ose i kombinuar; me detyra kursi; I bazuar në kombinimin e formave të mësipërme të vlerësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të	Institucioni ka në dispozicion të gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon realizimin e provimeve dhe vlerësimin e njohurive të studentëve të cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik dhe ju vihen në dispozicion nga pedagogu i lëndës në çdo syllabus. Vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet

parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	në parimin e kontrollit të vazhdueshëm. Mënyrat, format dhe elementët e kontrollit të dijeve përcaktohen sipas planit mësimor të miratuar në fillim të vitit kalendarik. Rezultati përfundimtar i kontrollit të dijeve përfshin vlerësimin e të gjithë elementëve të studimit të parashikuar në programin mësimor. Teza e provimit hartohet nga pedagogu që ka zhvilluar leksionet, kontrollohet nga titullari i lëndës dhe miratohet nga përgjegjësi i departamentit. Pedagogu gjatë zhvillimit të lëndëve vlerëson studentët, ky vlerësim përfshihet në vlerësimin përfundimtar. Studentët konfirmuan gjatë takimit me pedagogët se ata ndjekin një metodologji të vlerësimit në vazhdimësi dhe ky vlerësim përfshihet në notën përfundimtare. Mbarëvajtja e proces verbalit të provimit gjenerohet nga sistemi dhe firmoset nga pedagogët që kanë realizuar provimin. Mënyra e testimit pasqyrohet në çdo syllabus lënde. [Evidenca 5 Rregullore FSHMT] [Evidenca 21 Rregullore Msc. Logopedi] [Evidenca 86 Program Msc. Logopedi, syllabuset e Lëndëve]
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.	Prej disa vitesh zbatohet sistemi i automatizuar i koriggjimit të provimeve, në sajë të projektit CLEANSORE i financuar nga AADF. Institucioni referon se e ka implementuar këtë sistem prej disa vitesh dhe e aplikon në të tre programet e studimit. [Evidenca 143 Ndërfaqe Web UMT]. [Evidenca 145 Relacion Clean Score].
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Vlerësimi i dijeve të studentit bëhet sipas rregullores së FSHMT dhe rregullores së programit të studimit. Vlerësimi i dijeve të studentit bëhet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit akademik me qëllim që të mundësoj studimin sistematik të studentit, të vlerësoj ecurinë e procesit mësimor dhe shkallën e asimilimit të lëndës nga student, si dhe vlerësim objektiv të studentit duke e ndarë notën në disa përbërës, jo vetëm në provim përfundimtar. Elementët kryesore të kontrollit të vazhdueshëm në një lëndë të caktuar janë: detyra e kursit 10%, provimi përfundimtar 80%, aktivizimi 5%, pjesëmarrje 5 %. Teza e provimit hartohet nga pedagogu i lëndës dhe vlerësimi i dijeve bëhet me systemin e notave ku 5 është nota minimale kaluese dhe 10 maksimale. Gjatë vizitës në institucion, institucioni referon se vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin, bazuar në Rregulloren e FSHMT, rregulloren e Departamentit dhe Rregulloren e Programit. Testimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga një komision provimesh i përbërë nga dy anëtarë, njëri prej të cilëve është titullari i lëndës. [Evidenca 5 Rregullore FSHMT] [Evidenca 21 Rregullore Msc. Logopedi] [Evidenca 86 Program Msc. Logopedi, syllabuset e Lëndëve]
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale	Testimi i dijeve kryhet me shkrim, në mënyrë anonime me sekretim sipas rregullores së departamentit të DDRSHIKIOGJ. Mënyra e testimit

shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxëniet për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	pasqyrohet në çdo syllabus lënde. Studenti hyn në provim pasi ka kryer detyrimet e procesit mësimor për çdo lëndë dhe detyrimet financiare sipas kontratës që ka me institucionin. Ai paraqitet në provim me dokument identifikues dhe çdo objekt që ka me vete vendoset në një vend të caktuar. Në monitorim janë të pranishëm pedagogët e lëndës, sekretaria që sekreton dhe monitories nga departamenti dhe dekanati. Kur provimi kryhet me gojë vlerësimi shoqërohet me komente dhe këshillime të studentit për performancën e aritur në provim. Ndërsa në provimet me shkrim komentet dhe sygjerimet kryhen në seancën e komunikimit të rezultateve studentëve. Në këto seanca pedagogu i mbledh studentët në klasë dhe i mundëson studentit nëse ky dëshiron, të shikojë rezultatet e provimit. Në rastet kur dikush nuk është i qartë u jepet informacion/feedback i detajuar. Në rastet kur studentët nuk binden, atëherë vazhdohet me procedurën e ankimit. Ky proces u kufizohet gjatë takimit me studentët. Kjo procedurë është e parashikuar në Rregulloren e Departamentit të DDRSHIKIOGJ. [Evidenca 5 Rregullore FSHMT] [Evidenca 21 Rregullore Msc. Logopedi] [Evidenca 86 Program Msc. Logopedi, syllabuset e Lëndëve] [Evidenca 6 Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ]
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Universiteti zbaton një sistem elektronike antiplagjiaturë për të shmangur kopjimin në detyrat e kursit, punimet e diplomës apo doktoraturës. Përpara vlerësimit final nga pedagogët dhe komisionet e vlerësimit të gjitha punimet kalohen në sistemin antiplagjiaturë. Gjatë zhvillimit të provimit nuk lejohet dikush tjetër përveç pedagogut të lëndës dhe monitoruesve (2 persona të paktën) si dhe nuk lejohen të hyjnë persona të paautorizuar. Studentët duhet të lënë në një vend të caktuar sendet personale si telefonat celularë apo material tjetër mësimor dhe informativ që ka lidhje me lëndën. Me rregulloren e zhvillimit të provimit studentët njihen paraprakisht nga pedagogu i lëndës. Plagjatura dhe kopjimi ndërkohë me marrjen e notës 4(katër) si notë përfundimtare pavarësisht vlerësimit të elementëve të tjerë vlerësues. Institucioni ka të miratuar kodin e etikës në kërkim shkencor. [Evidenca 5 Rregullore FSHMT] [Evidenca 21 Rregullore Msc. Logopedi] [Evidenca 86 Program Msc. Logopedi, syllabuset e Lëndëve] Takimi me stafin akademik
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Realizimi i provimit dhe komunikimi i rezultateve bëhet sipas rregulloreve të programit të studimit. Studentët shprehen të kënaqur me procedurën e vlerësimit dhe deklaruan se vlerësimi është real dhe në përputhje me rregulloren e provimeve.

	Rezultatet komunikohen nga pedagogu jepen në kohë sipas afateve të përcaktara në rregulloren e provimit brenda 48 orëve në sistemin Pitagora. [Evidenca 5 Rregullore FSHMT] [Evidenca 21 Rregullore Msc. Logopedi]
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Studentët njihen me rezultatin e provimeve në mënyrë konfidenciale përmes llogarisë së tyre personale në sistemin Pitagora. Nëse provimi realizohet me gojë rezultati merret menjëherë pas provimit. Për çdo provim pasi studentët njihen me rezultatin, kanë të drejtë të kryejnë kërkesë me shkrim për rishikimin e notës në sekretarinë mësimore brenda 48 orëve pas marrjes së rezultatit, sipas procedurës të miratuar në rregulloren përkatëse të provimit. Ata kanë të drejtën e ankimit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi në lidhje me vlerësimin. Me rregulloren e zhvillimit të provimit ata njihen paraprakisht nga pedagogu i lëndës. [Evidenca 5 Rregullore FSHMT] [Evidenca 21 Rregullore Msc. Logopedi] [Evidenca 40 Ndërfaqe Sistemi PITAGORA]. [Evidenca 86 Program Msc. Logopedi, syllabuset e Lëndëve] [Evidenca 6 Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ]
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Nëse ka ankesa i paraqitet me shkrim Drejtuesit të departamentit brenda 24 orëve nga data e zhvillimit të provimit, i cili bën verifikimet e duhura dhe nëse nuk zgjidh ankesën vë në dijeni Dekanin. Dekani brenda 48 orëve ngre komision "ad hoc" për verifikim e ankesës së studentit dhe bën vlerësimin e provimit. Studenti ka të drejtë të sqarohet për çdo paqartësi ose të kundërshtojë rezultatin e marrë nëpërmjet ankimit zyrtar drejtuar komisionit. Komisioni i vlerësimit është i detyruar të sqarojë studentin në lidhje me vlerësimin e bërë duke ballafaquar përgjigjet e dokumentuara me tezën e zgjidhur brenda 24 orëve nga momenti i ankimit. Nëse provimi është zhvilluar me gojë studenti përsërit provimin në prani të komisionit "ad hoc" duke tërhequr një tezë të dytë. Vlerësimi në këtë provim mbetet vlerësimi përfundimtarë i studentit. Ndryshimi i rezultatit të provimit pasqyrohet në proces verbal të fimosur nga komisioni "ad hoc" dhe i bashkangjitet vlerësimit të komisionit të mëparshëm dhe sistemit Pitagora. Rezultati i komisionit të rivlerësimit është i padiskutueshëm, procesverbali i komisionit firmoset dhe dërgohen në sekretarinë mësimore dhe arkivohen. [Evidenca 5 Rregullore FSHMT] Takim me stafin akademik Takim me studentët
Konkluzione	Institucioni ka në dispozicion të gjithë bazën e nevojshme ligjore që rregullon realizimin e provimeve dhe vlerësimin e njohurive të studentëve të cilat bëhen publike dhe njihen nga studentët që në fillim të vitit akademik dhe ju vihen në dispozicion nga pedagogu i lëndës në



	çdo syllabus. Institucioni referon se e ka implementuar systemin CLEANSORE prej disa vitesh dhe e aplikon në të tre programet e studimit. Vlerësimi i dijeve të studentit bëhet sipas rregullores së FSHMT dhe rregullores së programit të studimit. Universiteti zbaton një sistem elektronike antiplagjaturë për të shmangur kopjimin në detyrat e kursit, punimet e diplomës apo doktoraturës. Rezultatet komunikohen nga pedagogu jepen në kohë sipas afateve të përcaktara në rregulloren e provimit brenda 48 orëve në sistemin Pitagora. Studentët kanë të drejtën e ankimit nëse kanë pakënaqësi apo paqartësi në lidhje me vlerësimin. Rezultati i komisionit të rivlerësimit është i padiskutueshëm, procesverbali i komisionit firmoset dhe dërgohen në sekretarinë mësimore dhe arkivohen			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Programi i studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese tek studentët dhe synojnë zhvillimin e thelluar të kompetencave profesionale e shkencore tek studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta shkencore të studentëve.	Programi i studimit Msc. në Logopedi, si program studimi garanton thellimin e njohurive dhe aftësive, si dhe rritjen e kompetencave. Institucioni referon se ky program ka objektiv tu japë studentëve aftësi profesionale të avancuara në trajtimin e situatave mjekësore logopedike, njohjen në detaje të protokolleve, teknikave dhe metodave rehabilituese të ndryshme më të fundit të trajtimit të pacientëve të të gjitha grupmoshave. Programi formon logopedistë profesionistë me njohuri të thella lidhur me zhvillimin gjuhësor, problematikat që lidhin gjuhën receptive dhe ekspresive gjatë moshës evolutive, si dhe rastet e pacientëve pediatrik apo adultë me çrregullime të ndryshme të fituara të të folurit. Qëllimi i këtij program studimi është formimi i logopedistëve profesionistë me kompetencë të lartë në njohuritë e etikës dhe deontologjisë profesionale, legjislacionit mjekësor, ruajtjen e sekretit profesional si dhe i pajis me njohuri të mira të teknikave dhe metodave të reja të trajtimit rehabilitues – logopedike, në pacientët me patologji të ndryshme, trajtimin ambulator dhe hospitalor të tyre. Ky program i referohet nivelit të 7 të KSHK, është i organizuar me 120 kredite, kohëzgjatje 2 vite akademike dhe ndahet në 4 semestra, në gjuhën shqipe, me kohë të plotë studimi, të ndara në lëndë/module bazuar në Ligjin e Arsimit të Lartë 80/2015 bazuar në aktet nënligjore dhe Sistemin Evropian të Transferimit të Krediteve [Vendim Senati

	riorganizim programesh]. Një kredit ka 25 orë mësimore, nga të cilat 12 janë orë në auditor dhe 13 janë orë individuale. Në përfundim të studimeve lëshohet diploma Master i Shkencave në Logopedi. Programi përmban të gjithë elementët që përbëjnë strukturën e programit të përcaktuar në VKM nr.41 datë.24.01.2018 "Për elementët e programeve të studimit të ofruara nga institucionet e arsimit të lartë". Programi i studimit përbëhet nga veprimtari formuese të cilat realizohen me kredite ECTS. Organizimi i programit mësimor si dhe kurrikulat e programit/syllabuset, lëndët mësimore, mundësojnë formimin profesional të thelluar dhe zhvillim të aftësive të veçanta si aftësi organizative, kërkim të pavarur shkencor, punën në grup. [Evidenca 5 Rregullore FSHMT] [Evidenca 21 Rregullore Msc. Logopedi] [Evidenca 91 Plani mësimor Msc. Logopedi] [Evidenca 86 Program Msc. Logopedi, syllabuset e Lëndëve]
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).	Institucioni referon se, bazuar në planin mësimor, Programi mësimor Msc në Logopedi garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit. Në kurrikulat e programit Msc në Logopedi studentët zhvillojnë disa lëndë si: Organizim, Menaxhim dhe Promocion Shëndetësor; Komunikim Profesional; Bioetikë; Psikologji Shëndeti; Analiza e Aplikuar e Sjelljes/ Komunikimi Alternativ Aumentativ, që kontribuojnë në formimin e përgjithshëm të tyre. [Evidenca 91 Plani mësimor Msc. Logopedi] [Evidenca 86 Program Msc. Logopedi, syllabuset e Lëndëve]
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre, si dhe për detyrimet përmbyllëse.	Programi synon të pajisë studentët me aftësi profesionale të avancuara në trajtimin e situatave mjekësore logopedike, njohjen në detaje të protokolleve, teknikave dhe metodave rehabilituese të ndryshme më të fundit të trajtimit të pacientëve të të gjitha grupmoshave. Një element i rëndësishëm i programit është pajisja e tyre me njohuri në fusha të veçanta të komunikimit dhe kërkimit për të cilën zhvillohen lëndë të veçanta si Metodologji e kërkimit, Shkrim akademik, etj. Një vend të rëndësishëm zë diskutimi me studentët për përmbajtjet e syllabuseve, se sa ju ka shërbyer ky program studimi në formimin e tyre profesional, përfitimin e aftësive dhe kompetencave në kryerjen e detyrave si dhe marrin mendimet dhe sygjerimet e studentëve për përmirësimin e programit të studimit. Në përfundim të lëndës, në orën e fundit të mësimit pedagogu bën një përmbledhje të tematikave të trajtuara duke u ndaluar në temat më të rëndësishme, si dhe orienton studentët ku duhet të fokusohen gjatë përgatitjes së tyre për provimin. Gjatë vizitës së GVJ-së, pedagogët referojnë se në fund të semestrit në përfundim të lëndës, pedagogu mundëson që studentët të arrijnë aftësitë dhe të njohin çështjet më të rëndësishme të trajtuara gjatë semestrit dhe të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e secilës lëndë.

	Aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Pedagogu ndalet në veçanti në temat që janë më të vështira për studentin gjatë zhvillimit të lëndës. Pedagogët i asistojnë studentët me konsultime me kërkesë të studentëve sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit gjatë orarit zyrtar të punës. Në fund të praktikës profesionale pedagogu analizon dhe vlerëson aftësitë profesionale të fituara nga studentët. Stafi akademik evidenton çështjet kyçe dhe i drejton studentët në implementimin e tyre si dhe për detyrimet përfundimtare. [Evidenca 86 Program Msc. Logopedi, syllabuset e Lëndëve] [Evidenca 21 Rregullore Msc. Logopedi] Takim me stafin akademik Takim me studentët
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparura kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	Programi Msc. në Logopedi formon logopedistë profesionistë me njohuri të thella lidhur me zhvillimin gjuhësor, problematikat që lidhin gjuhën receptive dhe ekspresive gjatë moshës evolutive, si dhe rastet e pacientëve pediatrik apo adultë me çrregullime të ndryshme të fituara të të folurit, të aftë për tu përballur me kërkesat e tregut të punës. Gjatë vizitës së kryer në institucion pedagogët referojnë se mësimdhënia kryhet mbi bazën e njohurive të marra, në mënyrë që të realizohet arritja e kompetencave. Ata referojnë se këto njohuri u jepen studentëve në auditor, laborator dhe në praktika profesionale. Kjo mënyrë zhvillon dhe përmirëson aftësitë e studentëve. Praktikrat rritin njohuritë e studentëve. Laboratorët që janë në dispozicion të studentëve janë të një rëndësie të veçantë dhe luajnë rol thelbësor në formimin e tyre profesional. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në praktikat profesionale të studentëve. Gjatë takimit me studentët ata pohuan se kanë një qasje pozitive dhe një komportim shumë të mirë nga pedagogët gjatë procesit mësimor. Veprimtaria kërkimore shkencore është pika e fortë e Njesisë Bazë, gjithashtu një objektivi i pedagogëve. Ata realizojnë studime të ndryshme me apo pa përfshirjen e studentëve. Institucioni mbështet studentët në zhvillimin e ideve të tyre inovative apo realizimin e punimeve të ndryshme duke ju vënë në dispozicion laboratorët, bibliotekën e FSHMT apo sallat e kompjuterave të fakulteteve të tjera brenda UMT dhe asistencën nga stafi akademik. Liria akademike ju mundëson pedagogëve përdorimin e metodave të ndryshme në mësimdhënie, në punimin e temave të diplomës. Një ndër mënyrat që motivon studentët në asimilimin e programit është dhe puna e pavarur, puna në grup apo aktivitete trajnuese të cilat ju mundësojnë studentëve aftësi organizuese dhe drejtuese, komunikim me etik mes kolegëve. Studentët janë përfshirë në kryerjen e referimeve në aktivitetet që organizon departamenti, temave të kursit, projekte të ndryshme kërkimi, në realizimin e aktiviteteve në komunitet ku ata përfshihen në plotësimin e pyetësoreve të ndryshëm, mbledhjen e të dhënave në spital

	nga kartelat apo regjistrat, përfshihen në grupet e përgatitjes/shkrimit të projekteve të ndryshme. Institucioni ka një numër të lartë marrëveshesh për të mundësuar mobilitetet e studentëve. [Evidenca 102 Marrëveshje bashkëpunimi praktikat logopedi] [Evidenca 101 Lista e bashkëpunimeve me institucione të tjera] [Evidenca 49 Lista e bashkëpunimeve me IAL kombëtare, ndërkombëtare dhe institucione të tjera] [Evidenca 166 Lista e mobiliteteve hyrëse dhe dalëse]. Takim me stafin akademik Takim me studentët
Kriteri 5. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Gjatë vitit akademik në përputhje me kalendarin e aktiviteteve shkencore apo kalendarit të promocionit shëndetësor, departamenti në bashkëpunim me departamentët e tjera të FSHMT si dhe mjekë nga institucione shëndetësore apo institucione arsimore vendase dhe të huaj organizojnë seminare, konferenca apo leksione të hapura, jashtë strukturës së programit mësimor ku studentët dhe pedagogët kanë mundësi të njihen me zhvillimet e reja në fushën e shëndetit apo të shkëmbejnë eksperiencat dhe dijet e tyre. Pjesëmarrës në këto aktivitete janë dhe studentët të cilët pajisen në fund të aktivitetit me çertifikatën përkatëse të pjesëmarrjes. Institucioni referon se Departamenti zhvillon hera herës leksione të hapura dhe ë orkshope nga personel efektiv dhe me kontratë me tema të caktuara mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit. Aktivitete të tilla i japin mundësi stafit akademik dhe studentëve të informohen mbi aspekte të reja shkencore. Bashkëpunimet e ndryshme në kuadër të programeve Erasmus kanë mundësuar rritjen e shkëmbimit të eksperiencës si dhe përfitimin prej praktikave më të mira të cilat implementohen nga personeli akademik dhe shpërndahen në kolegë të tjerë brenda institucionit. [Evidenca 166 Lista e mobiliteteve hyrëse dhe dalëse]. Takim me stafin akademik
Kriteri 6. Institucioni nxit zhvillimin e ideve inovative, studimeve të përparuara kërkimore nga studentët dhe i mbështet financiarisht ato.	Institucioni mbështet studentët në zhvillimin e ideve inovative, si dhe në veprimtarinë kërkimore-shkencore. Rezultatet e arritura nga kërkimi shkencor janë të publikuara në Revistën e FSHMT e cila është free of charge ku secili departament ka buxhet të veçantë. Institucioni ka dhe një qendër të inkorporimit që akrediton veprimtaritë. Institucioni mbështet studentët për zhvillimin e temës së diplomës apo studimeve të ndryshme nëpërmjet pjesëmarrjes në konferenca studentore si dhe publikimeve të punimeve të ndryshme në Buletinin Shkencor periodik. Takime me studentë
Konkluzione	Organizimi i programit mësimor si dhe kurrikulat e programit/syllabuset, lëndët mësimore, mundësojnë formimin



	profesional të thelluar dhe zhvillim të aftësive të veçanta si aftësi organizative, kërkim të pavarur shkencor, punën në grup. Në kurrikulat e programit Msc në Logopedi studentët zhvillojnë disa lëndë si: Organizim, Menaxhim dhe Promocion Shëndetësor; Komunikim Profesional; Bioetikë; Psikologji Shëndeti; Analiza e Aplikuar e Sjelljes/ Komunikimi Alternativ Aumentativ, që kontribuojnë në formimin e përgjithshëm të tyre. Një element i rëndësishëm i programit është pajisja e tyre me njohuri në fusha të veçanta të komunikimit dhe kërkimit për të cilën zhvillohen lëndë të veçanta si Metodologji e kërkimit, Shkrim akademik, etj. Institucioni mbështet studentët në zhvillimin e ideve të tyre inovative apo realizimin e punimeve të ndryshme duke ju vënë në dispozicion laboratorët, bibliotekën e FSHMT apo sallat e kompjuterave të fakulteteve të tjera brenda UMT dhe asistencën nga stafi akademik. Bashkëpunimet e ndryshme në kuadër të programeve Erasmus kanë mundësuar rritjen e shkëmbimit të eksperiencës si dhe përfitimin prej praktikave më të mira.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton procedurë të posaçme për detyrimet përmbyllëse, para realizimit të tyre dhe i bën ato publike dhe e bën atë publike.	Procedura e detyrimeve përmbyllëse para realizimit të tyre dhe bërjes së tyre publike për studentët e FSHMT është e parashikuar në rregulloren e FSHMT, dhe të programit të studimit në të cilën përshkruhet qartë procedura që ndiqet gjatë diplomimit të studentit. Studentët njihen me rregulloren në fillim të studimeve. Studenti në fund të studimeve pajiset me diplomë Msc. në Logopedi pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e planit mësimor, detyrimet financiare dhe ka kryer provimin përfundimtar me shkrim në përputhje me kreditet e përcaktuara në planin mësimor. Studenti duhet të ketë marrë të gjitha vlerësimet pozitive në të gjitha lëndët mësimore dhe në praktikë duke marrë kreditet e nevojshme dhe më pas të fitojë të drejtën e hyrjes në provimin përfundimtar. Institucioni ka hartuar dhe disponon manual specifik për hartimin e diplomës. Diploma realizohet provim me shkrim. Procedura e provimit përfundimtar dhe mbrojtja e diplomës bazohet edhe në rregulloren e UMT dhe të programit të studimit. Rregullorja është publike në faqen zyrtare. Studentët informohen edhe nga koordinatori i programit të studimeve. [Evidenca 2 Rregullore UMT]

	[Evidenca 5 Rregullore FSHMT] [Evidenca 21 Rregullore Msc. Logopedi] [Evidenca 86 Program Msc. Logopedi, syllabusët e Lëndëve]
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të të detyrimeve përmbyllëse.	Bazuar në Rregulloren e programit të studimeve pedagogët asistojnë studentët dhe i orientojnë ata, ju japin informacion lidhur me temat apo materialet që duhet të konsultohen për provimin final. Drejtuesi i Departamentit është personi përgjegjës i cili koordinon dhe bashkërendon punën për krijimin dhe përmirësimin e rregullores. Në dispozicion të studentëve ai vendos materiale dhe informacione për programin e studimit për përgatitjen e planit mësimor dhe praktikën. Njësia Bazë kujdeset që studentët të pajisen dhe informohen me të gjitha detyrimet përmbyllëse. Gjithë informacioni i nevojshëm në lidhje me dokumentacionin për përmbylljen e detyrimeve përmbyllëse gjendet në rregulloren e programit Msc. në Logopedi. Pedagogët i asistojnë studentët me konsultime me kërkesë të studentëve sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit gjatë orarit zyrtar të punës. Takim me stafin akademik Takim me studentët [Evidenca 21 Rregullore Msc. Logopedi] [Evidenca 9 Udhëzues për hartimin e temës së diplomës]
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Studenti mbron diplomën pasi ka plotësuar të gjitha kreditet e programit të studimit, përmes administrimit të provimit final të diplomës, i cili bazohet në testimin e njohurive të marra gjatë programit të studimit duke përfshirë lëndët në bazë të aftësive individuale të studentit. Për të fituar diplomën Msc. në Logopedi studenti duhet të japë me sukses provimin përfundimtar në përputhje me kreditet e përcaktuara në planin mësimor. Studenti duhet të ketë marrë të gjitha vlerësimet pozitive në të gjitha lëndët mësimore dhe në praktikë duke marrë kreditet e nevojshme dhe më pas të fitoj të drejtën e hyrjes në provimin përfundimtar. Studenti në fund të studimeve pajiset me diplomë Msc. në Logopedi pasi ka shlyer të gjitha detyrimet e planit mësimor, detyrimet financiare dhe ka kryer provimin përfundimtar me shkrim në përputhje me kreditet e përcaktuara në planin mësimor. [Evidenca 2 Rregullore UMT]. [Evidenca 5 Rregullore FSHMT]. [Evidenca 21 Rregullore Msc. Logopedi].
Kriteri 4. Personeli akademik/ Udhëheqësi i diplomës orientojnë dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit	Në realizimin e temës së diplomës studentët asistohen nga stafi akademik i cili konsiston në zhvillimin e konsultimeve që janë orë pune që ndihmojnë studentin në hartimin e strukturës së temës, zgjedhjen e literaturës, metodologjinë e hartimit, shkrimit apo prezantimin e punimit të diplomës. Konsultimet që zhvillon pedagogu kanë karakter interaktiv. Institucioni për realizimin e pjesës teorike vë në dispozicion të studentëve infrastrukturën e nevojshme si dhe ju garanton studentëve

përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	mbledhjen e të dhënave apo realizimin e testeve të ndryshme në funksion të temës. [Evidenca 118 Infrastruktura në funksion të mësimdhënies, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë]. [Evidenca 9 Udhëzues për hartimin e temës së diplomës]
Kriteri 5. Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Temat e diplomës përcaktohen nga departamenti ku zhvillohet ky program studimi, në fillim të vitit të dytë akademik. Temat përcaktohen nga pedagogët në diskutim me studentët. Studentët asistohen nga pedagogët dhe stafi i sekretarisë në caktimin e temës së diplomës, zgjedhjen e udhëheqësit dhe plotësimin e formularit të aplikimit për temën e diplomës. Aplikimet shqyrtohen në departament dhe miratohen nga Dekani. [Evidenca 21 Rregullore Msc. Logopedi].
Kriteri 6. Në përfundim të provimit përfundimtar të përgjithshëm ose të mbrojtjes së punimit të diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Pedagogu udhëzon dhe orienton studentin gjatë punimit të temës, mbledhjes së të dhënave dhe përpunimin e rezultateve, literaturën që do të shfrytëzojë dhe jep miratimin me shkrim nëse studimi është i plotë për tu paraqitur përpara komisionit të vlerësimit. Studenti dorëzon punimin e diplomës komisionit të vlerësimit. Mbrojtja e temës shpallet si datë nga Komiteti Shkencor i Programit dhe miratuar nga Përgjegjësi i Departamentit. Vlerësimi bazohet në disa kritere kyçe si struktura e organizimit, mënyra e zhvillimit të ideve, cilësia e analizës dhe rezultateve të studimit, mënyra e paraqitjes, literatura. Rezultati përfundimtar shënohet në procesverbal. Vendimi i Komisionit të Vlerësimit të Diplomave është përfundimtar dhe nuk mund të ankimohet. [Evidenca 9 Udhëzues për hartimin e temës së diplomës]
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve në programin e studimit Msc. në Logopedi studenti pajiset me diplomë dhe suplementin e diplomës, pasi ka shlyer të gjitha detyrimet mësimore dhe financiare ndaj UMT. Diploma është sipas formatit të miratuar nga Ministria përgjegjëse për arsimin dhe nënshkruhet nga Dekani i Fakultetit dhe Rektori. Përmbajtja dhe forma e suplementit të diplomës është në përputhje me udhëzimet e Ministrisë përgjegjëse për arsimin e lartë. Studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar, pasi ka përfunduar studimet. Diploma lëshohet nga UMT deri në 6 (gjashtë) muaj pas përfundimit të studimeve. [Evidenca 21 Rregullore Msc. Logopedi].
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Dokumentacioni lidhur me studentët ruhet nga institucioni për një afat kohor të pacaktuar dhe mund të jap informacion për studentët nëse kërkohet. [Evidenca 21 Rregullore Msc. Logopedi].

Konkluzione	Procedura e detyrimeve përmbyllëse para realizimit të tyre dhe bërjes së tyre publike për studentët e FSHMT është e parashikuar në rregulloren e FSHMT, dhe të programit të studimit në të cilën përshkruhet qartë procedura që ndiqet gjatë diplomimit të studentit. Pedagogët asistojnë studentët dhe i orientojnë ata, ju japin informacion lidhur me temat apo materialet që duhet të konsultohen për provimin final. Për të fituar diplomën Msc. në Logopedi studenti duhet të japë me sukses provimin përfundimtar në përputhje me kreditet e përcaktuara në planin mësimor. Studenti duhet të ketë marrë të gjitha vlerësimet pozitive në të gjitha lëndët mësimore dhe në praktikë duke marrë kreditet e nevojshme dhe më pas të fitoj të drejtën e hyrjes në provimin përfundimtar. Studentët asistohen nga pedagogët dhe stafi i sekretarisë në caktimin e temës së diplomës, zgjedhjen e udhëheqësit dhe plotësimin e formularit të aplikimit për temën e diplomës. Në përfundim të studimeve në programin e studimit Msc. në Logopedi studenti pajiset me diplomë dhe suplementin e diplomës, pasi ka shlyer të gjitha detyrimet mësimore dhe financiare ndaj UMT.			
Shkalla e përmbushjes sëstandardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.6

Në rastin e programit të studimit në “Master Profesional” institucioni ndjek një procedurë të qartë të zbatimit të njohurive nëpërmjet praktikës laboratorike, praktikës profesionale, praktikave klinike dhe stazheve.


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësitë përgjegjëse, në funksion të mësimdhënies dhe përfitimit të njohurive, garantojnë mjedise brenda ose jashtë institucionit, të përshtatshme për realizimin e praktikës laboratorike, praktikës profesionale.	Institucioni referon se departamentet në FSHMT bashkëpunojnë me aktorë të rëndësishëm në funksion të mësimdhënies për realizimin e praktikës profesionale. Gjatë vizitës në institucion u pa se laboratorët janë në funksion të realizimit të praktikës laboratorike. [Evidenca 117 Lista e laboratorëve didaktikë në të tre Fakultetet UMT]. [Evidenca 118 Infrastruktura në funksion të mësimdhënies, Universiteti i Mjekësisë, Tiranë]. [Evidenca 119 Lista e aseteve infrastrukturore të UMT dhe planimetritë]. [Evidenca 102 Marrëveshje bashkëpunimi e FSHMT për praktikat logopedi].
Kriteri 2. Institucioni, në bashkëpunim dhe partneritet, garanton realizimin e praktikave klinike dhe stazheve me format dhe teknologjinë më të fundit	Institucioni referon se ka nënshkruar marrëveshje të posatshme për realizimin dhe bashkëpunimin në partneritet për praktikat klinike dhe stazhet. [Evidenca 49 Lista e Bashkëpunimeve me IAL kombëtare, ndërkombëtare dhe institucione të tjera].

bashkëkohore me qëllim përfitimin më mirë të njohurive dhe kompetencave profesionale.	[Evidenca 46 Memorandum Bashkëpunimi]. [Evidenca 192 Zyra e karrierës].			
Kriteri 3. Praktikant profesionale, klinike dhe stazhet e zhvilluara gjatë studimeve, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.	Praktika profesionale ka gjithsej 12 kredite dhe zhvillohet viti i dytë semestri i dytë. Studenti në përfundim të praktikës përgatit një relacion për punën e kryer, i cili vlerësohet nga komisioni i ngritur në department. Në përfundim të praktikave profesionale, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës. Vlerësohet me notë. [Evidenca 5 Rregullore FSHMT]. [Evidenca 6 Rregullore Departamenti DDRSHIKIOGJ] [Evidenca 86 Programi MP Logopedi, syllabuset e lëndëve]. [Evidenca 192 Zyra e karrierës]. [Evidenca 205 Shembull Master Logopedia Italia]. [Evidenca 193 Model Teze Praktika Master Shkencor Logopedi 2022].			
Konkluzione	FSHMT bashkëpunon me aktorë të rëndësishëm në funksion të mësimdhënies për realizimin e praktikës profesionale. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje të posaçme për realizimin dhe bashkëpunimin në partneritet për praktikant klinike dhe stazhet. Në përfundim të praktikave profesionale, ekuivalentohen në kredite dhe dokumentohen në dokumente të posaçme duke e shoqëruar me mendimin e trajnerëve dhe vlerësimin përkatës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	Personeli akademik i angazhuar në këtë program studimi në përgjithësi ka përgatitjen profesionale, eksperiencën dhe ekspertizën e duhur mjekësore dhe pedagogjike në lëndët që mbulon. Për vitin akademik 2021-2022 Stafi akademik për programin e studimit Msc në Logopedi në raportin PAE/PAK janë: Lektorë me titullin Prof. Dr në raportin PAE/PAK janë 2/1. Lektorë me titullin Prof. të Asoc. në raportin PAE/PAK janë 4/3. Lektorë me gradën Dr/Phd në raportin PAE/PAK janë 4/8. Asistentë me Msc (ne proces Dr) në raportin PAE/PAK janë 0/0. Asistentë me Msc në raportin PAE/PAK janë 0/12. Për vitin akademik 2022-2023 Lektorë me titullin Prof. Dr në raportin PAE/PAK janë 2/1. Lektorë me titullin Prof. të Asoc. në raportin PAE/PAK janë 4/3. Lektorë me gradën Dr/Phd në raportin PAE/PAK janë 4/8. Asistentë me Msc (ne proces Dr) në raportin PAE/PAK janë 0/1. Asistentë me Msc në raportin PAE/PAK janë 0/11. Për vitin akademik 2023-2024 Lektorë me titullin Prof. Dr në raportin PAE/PAK janë 3/1. Lektorë me titullin Prof. të Asoc. në raportin PAE/PAK janë 3/3. Lektorë me gradën Dr/Phd në raportin PAE/PAK janë 4/8. Asistentë me Msc (ne proces Dr) në raportin PAE/PAK janë 0/3. Asistentë me Msc në raportin PAE/PAK janë 0/6. Evidenca 1.1 Evidenca 97
Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.	Nga vlerësimi i dokumentacionit si Plan i mësimor, angazhimi i stafit akademik për vitin 2021-2022, CV të stafit akademik dhe Programet lëndore, rezulton se sipas evidencës tabelat përmbledhëse. Sqarojmë se, personeli akademik i UMT nuk konsiderohet vetëm stafi që është pjesë e organikës së fakultetit, por edhe stafi i gjithë strukturave shëndetësore universitare (SSHU) spitalore dhe jospitalore të rregulluara me VKM të posaçme, personel potencial i specializuar në fushën e shkencave mjekësore. Ky personel mund të përfshihet në procesin e mësimdhënies, të kërkimit shkencor, të zhvillimit të praktikave mësimore/ klinike-diagnostike, të shërbimeve për mbështetje dhe zhvillim të UMT-së, mbikëqyrje klinike-diagnostike për studentët,



	si dhe veprimtari të tjera, sipas përcaktimeve të rregulloreve specifike (referuar nenit 17, 18 të Statutit të UMT-së). Nga sa më sipër, referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga IAL për programin e studimit Msc në Logopedi për vitin akademik 2023-2024 kostatojmë se, 69% e ngarkesës mësimore mbulohet nga PAE dhe SSHU dhe 31% nga PAK.
Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	Gjatë vizitës në Institucion dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion në sistem GVJ konstatoi se Institucioni disponon një bazë të dhënash për anëtarët e personelit akademik efektiv të angazhuar në programin e studimit Msc në Logopedi. Kjo bazë të dhënash gjendet pranë zyrës së Burimeve Njerëzore në dosjet personale të stafit akademik e cila mban dhe marrëveshjen për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semester, dosjen personale si dhe regjistrin themeltarë të stafit. Në regjistrin themeltarë të stafit hidhen të dhenat si: data e fillimit të punësimit, ndryshimet e vendit të punës nqs ka deri në largimin dhe tërheqjen. e librezës së punës nga individ. Çdo vit Zyra e Burimeve Njerëzore bën dhe përditësimin e CV të stafit dhe mbledhjen e dokumentacionit plotësues përkatës. Institucioni disponon listën e personelit akademik efektiv dhe me kontratë si dhe ngarkesën e tyre mësimore dhe kualifikimin e tyre. Institucioni pajis me kontratë punësimi personelin akademik, duke siguruar qëndrueshmërinë e personelit efektiv në periudhën e akreditimit. Personli nënshkruan kontratën individuale të punës, në të cilën janë të mbuluara edhe sigurimet shoqërore e shëndetsore. Evidenca 4.1 Evidenca 4.2
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Procedura e rekrutimit bazohet në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si edhe në Rregulloren e Institucionit. Ajo bazohet në kritere të përgjithshme dhe specifike për vlerësimin dhe përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur akademik. Departamenti është njesia bazë që inicion kërkesën për mbulimin e vakancave, duke përcaktuar edhe kriteret e posaçme në varësi të pozicionit. Pasi merret miratimi nga Dekani, Zyra e Burimeve Njerëzore procedon me publikimin dhe pritjen e kandidaturave, të cilat kalojnë në vlerësimin e komisionit ad-hoc. Në përzgjedhjen e kandidatëve zbatohen me korrektësi të gjitha elementet e rregullores, duke respektuar kriteret e përgjithshme dhe të posaçme, e mandej në mënyrë transparente përzgjidhet kandidati fitues. GVJ zhvilloi vizitë në Zyrën e Burimeve Njerëzore, ku konfirmohet rregullsia në dokumentacion, si për stafin akademik efektiv, edhe për atë me kohë të pjesshme.
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm	Në realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratoreve, institucioni ka punësuar personel ndihmës akademik- laborant. Gjatë vizitës në Institucion dhe disponimit të dokumentacionit në sistem u evidentua angazhimi i personelit ndihmës akademik të cilët asistojnë



për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	orët laboratorike dhe gjithashtu realizojnë mbarëvajtjen e laboratoreve të programit të studimit Bachelor në logopedi. Personeli akademik është i mjaftueshëm dhe ka kompetencën dhe angazhimin e duhur për realizimin e detyrave të tij. Evidenca 1.11; Evidenca 1.8; Evidenca 2.9
Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	Zyra e Burimeve Njerëzore, e cila funksionon konform Rregullores së UMT, ruan dhe përditëson të gjitha dosjet e personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Nga vizita zhvilluar në ambientet e UMT dhe takimi me përgjegjësen e Zyrës së Burimeve Njerëzore, GVJ u njoh me dosjet individuale të stafit dhe evidentoi ruajtjen dhe përditësimin e dokumentave të nevojshme për secilin peagog, të angazhuar konform shpërndarjes së ngarkesës mësimore, sipas planit të programit të studimit Master i Shkencave në “Logopedi”. Evidenca 4.5
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	FSHMT dhe UMT ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me Qendrën Spitalore “Nene Tereza”, me qëllim realizimin e procesit mësimor, vecanërisht praktikave mësimore.
Kriteri 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	Në mjediset shëndetësore të institucionve me të cilat UMT ka marrëveshje, studentët zhvillojnë praktikat mësimore, të mbikëqyruar nga personeli shëndetësor, si edhe anëtari i stafit akademik i ngarkuar për praktikat mësimore. GVJ i është vënë në dispozicion dosja e praktikës për programin e studimit Master i Shkencave në “Logopedi”, në plotësimin e secilës zhvillohen aftësi të përcaktuara për logopedinë. Evidenca 1.14.1 Evidenca 2.9 Evidenca 1.4 Evidenca 4.1
Konkluzione	Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standartet sasiore dhe me së shumti ka kualifikimin e duhur e të posaçëm

	akademik. GVJ, sugjeron që leksionet të zhvillohen nga pedagogë me gradën "Doktor", si edhe lëndë të specialiteteve të jepen nga specialistë të fushës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	Gjatë vizitës në institucion, GVJ u njoh me mjediset e FSHMT, ku zhvillon aktivitetin njësi bazë, sallat e leksioneve, seminareve, laboratoreve, si edhe zyrat. Mjediset janë të përshtatshme dhe të mjaftueshme – sipas mendimit të stafit akademik. Në diskutim vihet numri gjithnjë në rritje të studentëve të këtij fakulteti që kërkon shtimin e kapacitetit mjedisor të këtij fakulteti.
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	Mjediset e FSHMT janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit që garanton realizimin e procesit mësimor përmes teknologjive bashkëkohore dhe metodologjive bashkëkohore të mësimdhënies e mësimnxënies. Evidenca 4.8
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, ateliet apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	Gjatë vizitës në Institucion, GVJ u njoh me laboratorët e Fakultetit. Laboratorët apo mjediset e tjera, janë të pajisura me të gjithat materialet, mjetet, dhe mulazhet e nevojshme për aplikimin e procedurave të përfshira në programin mësimor teorik dhe praktik si dhe objektivat formuese në tërësi. Evidenca 4.8
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit,	GVJ vizitoi edhe laboratorin e TIK- pjesë e FSHMT, i cili përmban programe profesionale të aksesueshme nga studentët e këtij programi studimi.

të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	Evidenca 4.9.			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	Institucioni ka bashkëpunime dhe marrëveshje kontraktuale sipas kornizës ligjore me institucione mjekësore në mënyrë që studentet të kenë mundësinë për të kryer në mënyre adekuate praktikat profesionale. [Evidenca 1.13].			
Konkluzione	Bazuar në materialet e vëna në dispozicion dhe vecanërisht në vizitën që GVJ zhvilloi në institucion, jemi të mendimit se UMT ka vënë në dispozicion të këtij programi studimi mjedise mësimore dhe infrastrukturë të përshtatshme për realizimin e procesit mësimor, si dhe për formimin praktik, në përputhje me natyrën dhe fushën e programit të studimit. GVJ, është i mendimit se infrastruktura shfrytëzohet maksimalisht, ndaj sugjeron shtimin e kapaciteteve strukturore dhe laboratorike për të ecur paralel me kërkesat në rritje për këtë program studimi.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3	
Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të	Literatura bazë dhe ndihmëse, e përcaktuar në syllabuset lëndore, garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme sipas fushave specifike të lëndëve përkatëse. Literatura e sugjeruar gjendet në formë fizike apo elektronike dhe vihet në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (në shqip). Evidenca 2.7



nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	<i>Mbi përditësimin e literaturës bazë dhe ndihmëse, GVJ vëren se në disa raste në programet lëndore rekomandohet literaturë e vjetër ose mungon viti i botimit. Nga biseda me stafin, pedagogët shprehen se përditësojnë leksionet e tyre (dispencat) me literaturë bashkëkohore, si një mundësi për të qënë më fleksibël në përditësimin e literaturës për studentët.</i> Evidenca 2.7
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.	UMT ve në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore të FSHMT, si dhe Bibliotekën e Universitetit në korpusin universitar qendror. Ne patëm mundësinë t'i vizitojmë këto dy mjedise, të cilat po i nënshtrohen rikonstruksionit, si dhe avancimit teknologjik dhe digjitalizimit. Nga evidencat e vëna në dispozicion vlerësojmë se, studentëve u krijohet mundësia të shfrytëzojnë fondin fizik dhe dixhital të librit në mënyrë të barabartë. Biblioteka e FSHMT ndodhet në katin e pestë të Godinës Nr.1 me një sipërfaqe 400 m2. Ambjenti i saj ka raftë librash, tavolina dhe karrige me sistem ngrohje dhe kondicioner. Librat janë të vendosura në të njëjtin ambient dhe ajo ka një kapacitet prej 138 vende leximi. Biblioteka është e aksesueshme fizikisht nga studentët, pedagogët, punonjësit shkencorë dhe ka një fond të pasur me libra shkencorë. Studentët në bibliotekë nëpërmjet kompjuterave kanë akses për libraritë online që ofron Universiteti i Mjekësisë. Në bibliotekë studentët rregjistrohen me anë të kartës së studentit, çdo ditë evidentohet prezenca e tyre në bibliotekë. Studentët dhe punonjësit shkencorë tërheqin dhe dorëzojnë literaturën brenda kohës së qëndrimit në sallën e leximit. Evidenca 4.11
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	Bazuar në përshkrimin e RVB, biblioteka e UMT është e pajisur me literaturë fizike, si tekste mësimore dhe literaturë tjetër ndihmëse në gjuhën shqipe dhe atë të huaj. Evidenca 2.8.
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	Institucioni garanton shfrytëzim të barabartë dhe pa pagesë për të gjithë studentët në bibliotekat online për fushën e programit të studimit Master i Shkencave në "Logopedi". Studentët mundet të anëtarësohen në J STORE dhe U-Library, vullnetarisht dhe pa pagesë. Evidenca 2.7

Kriteri 6. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentët.	GVJ, përgjatë vizitës në institucion, konstatoi se rristurimi i bibliotekës ishte një proces që e pajis atë me teknologjinë bashkëkohore digjitale dhe krijon mundësi shumë të favorshme në një të ardhme të afërt. Evidenca 4.10			
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	GVJ konstatoi se biblioteka e UMT vihej në dispozicion të studentëve, me orare shërbimi në përshtatje me oraret e studimit dhe përtej tyre. Por biblioteka e FSHMT vihej në dispozicion të studentëve me orar të kufizuar 8:00-15:00. Evidenca 4.11			
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	Në përmbushje të këtij kriteri mbi cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online, përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik ose online nga personeli akademik dhe studentët e programit të studimit Master i Shkencave në “Logopedi”, shfrytëzimin e sallave të studimit dhe eficiencën e përpjekjeve të pasurimit të fondit fizik dhe online, RVB evidenton në materialin e analizës vjetore institucionale të UMT. Evidenca 1.12			
Konkluzione	Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të programit të studimit Master i Shkencave në “Logopedi” është në përputhje me fushën e studimit, por ka vend për përmirësime për të qenë bashkëkohore. Studentëve dhe stafit u mundësohet pa pagesë dhe në mënyrë të barabartë regjistrimi dhe shfrytëzimi i bibliotekës online në J STORE dhe U-Library. Orari i bibliotekës së FSHMT ngelet problem që duhet zgjidhur në të ardhmen			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Standardi IV.4 Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	Në paraqitjen e RVB, si edhe përgjatë vizitës në Institucion, në takimet me Shefin e Departamentit, Stafin dhe Sekretarinë Mësimore, konstatohet se UMT disponon sistem të menaxhimit, nëpërmjet të cilit administrojnë të gjithë informacionin që lidhet me studentët, si dhe aktivitetin e tyre që nga regjistrimi deri në diplomim. Informacioni i ruajtur në regjistra në formë manuale, nga regjistrat e kursit deri në regjistrat e sekretarisë mësimore, si dhe informacioni në formë elektronike (porocesverbalet në sistemin EMS dhe në hard-copy) figuron i rregullt. Evidenca 4.12
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administrojnë informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	GVJ, konstaton se, nëpërmjet sistemeve të brendshme të menaxhimit EMS dhe UMED.EDU.AL, administrohet informacioni dhe dokumentacioni i të gjithë aktorëve dhe partnerëve të angazhuar në procesin mësimor, personel akademik, ndihmës akademik, administrativ, në realizimin e programit. Evidenca 4.12
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	GVJ, konstaton se në respekt të kuadrit ligjor dhe mbrojtjes së të dhënave personale, sistemi i menaxhimit garanton dhe siguron akses të dedikuar në informacione dhe dokumente, për të gjithë personelin dhe studentët e Programit të studimit Master i Shkencave në "Logopedi". Evidenca 4.12
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	Nëpërmjet sistemeve të menaxhimit EMS dhe UMED.EDU.AL mundësohet komunikimi interaktiv, i shpejtë dhe i saktë i informacionit në lidhje me procesin mësimor, lërsimet, kreditet, mbarrëvajtjen e procesit mësimor. Ndërkohë që, nëpërmjet platformave Model umed.edu.al, Microsoft Teams dhe grupeve e hatsapp, realizohen komunikime dhe shkëmbime të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Evidenca 6.1
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	GVJ, vëren se, edhe në sajë të digjitalizimit, sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik dhe administrativ, si edhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale, për organet drejtuese dhe autoritetet drejtuese të UMT. Evidenca 4.12



Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	Në WEB faqen e UMT, informacionet që lidhen me Programin e studimit Master i Shkencave në "Logopedi", personelin akademik, aktivitetet institucionale publikohen në Gjuhën Shqipe dhe Angleze. Evidenca 4.13			
Konkluzione	UMT disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit instucional, i cili edhe në sajë të dixhitalizimit, vihet në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ, për programin e studimit Master i Shkencave në "Logopedi".			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5 Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Çdo vit akademik Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi i cili miratohet nga bordi i administrimit. Fondet burojnë nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e universitetit. Shpërndarja bëhet në bazë të nevojave që paraqesin njësitë kryesore në bazë të kërkesave të planifikuara në çdo fillim viti akademik. Institucioni gjithashtu harton dhe miraton tarifat e shkollimit të studentëve për çdo program bazuar në VKM përkatëse. Tarifat e shkollimit nuk e kalojnë koston e programit të studimit. GVJ i është vënë në dispozicion evidenca me të dhëna mbi koston e programit të studimit, plani për mbështetjen financiare për një cikël të plotë studimi. Gjithashtu, disponojmë edhe evidencat me miratimin e Buxhetit 2022 nga Bordi i Administrimit, miratimi i Regjistrit të prokurimeve dhe shërbimeve. Duke qenë institucion publik, UMT i siguron fondet nga buxheti i shtetit dhe të ardhurat e Universitetit. Evidenca 4.17

Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Mbështetur në RVB dhe në evidenca, vërejmë se në fund të çdo viti akademik njësia bazë harton një raport financiar dhe në çdo fillim viti akademik harton planin për mbështetje financiare të njësisë me zëra për mirëmbajtje mjedisore, mbështetje në teknologji, aktivitete, literaturë, akses në biblioteka online, etj. Evidenca 4.17
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	Konform legjislacionit në fuqi, UMT i nënshtrohet në vazhdimësi auditimit periodik, të bazuar mbi dokumentacionin. Evidenca 4.14
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	Në përmbushje të këtij kriteri, citojmë nga RVB se: Njësia bazë njihet me raportin financiar të institucionit, i cili u bëhet me dije të anëtarëve të njësisë bazë. Raporti është i aksesueshëm edhe në faqen zyrtare https://www.umed.edu.al Evidenca 1.12.1
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve.	Si institucioni publik, me numër të konsiderueshëm studentësh dhe programe studimi; UMT garanton qëndrueshmëri financiare në zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë si edhe kapacitete financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Evidenca 4.14 4.15
Konkluzione	GVJ ka bindjen dhe gjen në evidenca dhe raporte se UMT garanton financimin dhe mbështet financiarisht realizimin e procesit mësimor dhe

	kërkimor dhe siguron mbarëvajtjen e programit Master i Shkencave në “Logopedi”, si edhe mbështetjen e studentëve.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ konstaton se, Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura të cilat mbulojnë ciklin e plotë të studimeve Master i Shkencave në "Logopedi", që nga momenti i regjistrimit deri në diplomim, në përputhje me aktet e veta normative dhe rregullatore të përcaktuara në Statutin e UMT, Rregulloren e FSHMT, Rregulloren e Programit të Studimit Master i Shkencave në "Logopedi" si dhe tërësinë e akteve ligjore dhe nënligjore në fuqi në RSH. Evidenca 1.1 1.7, 1.8
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	GVJ konstaton se, politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë, gjithëpërfshirjen dhe mosdiskriminimin, për të gjithë kandidatët dhe mandej studentët e programit të studimit Master i Shkencave në "Logopedi". Në auditorët e FSHMT ofrohen facilitete për aksesueshmërinë e tyre nga persona me aftësi ndryshe. Evidenca 1.7
Kriteri 3. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse.	GVJ konstaton se UMT harton dhe publikon përpara çdo viti akademik, kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Këto kriteret miratohen me vendim Senati, i cili publikohet online në faqen e e-b-it të UMT. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, bazuar në ligjin dhe udhëzimet përkatëse të MAS. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj vërtetojmë se për këtë program studimi nuk ka kriteret specifike. Evidenca 1.8.1, 1.8.2, 5.1 .
Kriteri 4. Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	Në RVB thuhet dhe në biem dakort se kriteret, procedurat e përzgjedhjes dhe pranimit të studentëve, përparimin gjatë kursit të studimit, transferimi, njohja e studimeve të mëparshme ose të pjesëshme, vlerësimi i dijeve dhe diplomimi, janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku i gjerë, pasi janë të përcaktuara në rregulloren e FSHMT, si dhe mund të aksesohen lehtësisht në çdo kohë online në e-bis-it-in e UMT. Evidenca 1.2; 1.8.
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të	Përpara fillimit të çdo viti akademik, në afatet kohore të përcaktuara nga MAS, në UMT organizohen ditët e informimit të maturantëve. Informacioni jepet në takimet që organizon stafi i ngarkuar për

interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	promocion, shpërndahen fletëpalosje me informacionin e nevojshëm apo gjenden në faqen e ë ebit të UMT. Evidenca 5.2 4.13. 5.4, 2.5		
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	GVJ, gjen se, UMT parashikon kuota të posaçme dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi ndryshe, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Evidenca 5.1, 1.8.1, 1.8.2		
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	GVJ, gjen se, UMT harton dhe publikon kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera. Evidenca: 5.1, 1.8.1 ,1.8.2		
Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimin në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	GVJ, vërteton se UMT harton politika të ndihmës/bursave dhe në çdo fillim viti akademik kryen procedurat përkatëse të ndihmës dhe bursave për shtresat në nevojë, sipas vendimit të Bordit të Administrimit UMT. Evidenca 2.1		
Konkluzione	UMT harton, ndjek dhe zbaton procedura konkrete për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve, në përputhje me legjislacionin në RSH, aktet ligjore dhe nënligjore, mbështetur në Rregulloret përkatëse Institucionale.		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht
			Përmbushet plotësisht X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ, vëren se institucioni ve në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret dhe procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Të dhënat publikohen në faqen e ë ebit të UMT, afishohen në mjediset e FSHMT pranë tabelës së njoftimeve. Në çdo fillim viti akademik, studentët informohen për kriteret e kalimit nga një vit akademik në tjetrin, numrin e krediteve të nevojshme, ndërsa mbi rezultatet e provimeve njoftohen nëpërmjet sistemit EMS. Informacioni mbi ecurinë e studentëve disponohet edhe nga Zyra e Këshillimit të Karrierës e cila



	ua ofron palëve të interesuara. Evidenca 1.2, 1.7, 1.8			
Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.	Bazuar në Rregulloren e Studimeve UMT dhe Rregulloren e FSHMT, institucioni informon studentët mbi kriteret dhe procedurat e njohjes së kualifikimeve të mëparshme, ose studimeve të pjesshme, aktivizon Komisionin e ekuivalentimit të moduleve dhe programeve ngritur në Departament, i cili bën vlerësimin e dosjeve dhe rankimin e kandidatëve sipas kriterëve të parashikuara dhe harton listën përfundimtare me vlerësimet për secilin kandidat. Evidenca 1.2, 1.7, 1.8			
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	Bazuar në Rregulloren e Programit të studimit Master i Shkencave në “Logopedi” si dhe në Programet lëndore, në çdo fillim viti akademik, Përgjegjësi i Departamentit dhe pedagogët e moduleve përkatëse informojnë studentët mbi procedurat e vlerësimit të dijeve dhe aftësive të studentëve e më specifikisht me elementët e vlerësimit të njohurive, pikëzimin dhe konvertimin në notë. Evidenca 1.8, 2.12			
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	Në fillimin e vitit të fundit të studimeve, bazuar në rezultatet e dy viteve të para, bëhet përzgjedhja e studentëve që plotësojnë kriteret e mbrojtjes së diplomës më temë. Udhëheqësi i temës së diplomës, i përcaktuar nga njësia bazë, përgatit programin e punës dhe ndjek procesin e konsultimeve me studentin kandidat për t’u diplomuar. Secili student mundet të aksesojë pranë faqes së UMT edhe manualin për pranimin e diplomës. Studentët e tjerë që nuk të plotësojnë kriteret, i nënshtrohen provimit përfundimtar të formimit. Evidenca 1.7, 1.8			
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	Në lidhje me promocionin për këtë program studimi dhe për çdo program tjetër, GVJ konstaton se, UMT organizon takime të hapura informimi, publikon një spot promovues për programet e studimit që ofron si dhe shpërndan fletëpalosje në çdo fillim viti. Gjithashtu nëpërmjet faqes zyrtare, sekretarive dhe stafit akademik ofron informacion të vazhdueshëm për publikun e interesuar. Evidencat: 5.3, 5.2			
Konkluzione	UMT ve në dispozicion të studentëve informacion të plotë dhe të detajuar mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundimin e studimeve në programin e studimit Master i Shkencave në “Logopedi”.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi V.3	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ, vëren se, informacioni për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit, transmetohet tek studentët nëpërmjet faqes zyrtare, zyrës të sekretarisë mësimore, personave prgjegjës në departament, nga momenti kur kandidatët për studentë paraqesin interes në vazhdimësi. Evidenca 1.8, 4.13
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	Në fillim të cdo viti akademik, përgjegjësi i Departamentit dhe pedagogët e lëndëve përkatëse informojnë studentët për modulet, lëndët, përmbajtjen, numrin e krediteve për çdo lëndë, si dhe veprimtarinë formuese. Studentët aksesojnë të dhënat nëpërmjet llogarisë së dedikuar të EMS. Githashtu, informacioni gjendet i publikuar në faqen e E EB-it të UMT sipas zërave përkatës. Në vazhdimësi studentët asistohen edhe nga sekretaria mësimore. Evidenca 4.12, 4.13
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	Nëpërmjet Zyrës së Këshillimit të Karrierës dhe Alumni, Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe i promovon në tregun e punës nëpërmjet aktiviteteve të ndryshme si veprimtari jashtë mësimore. Krijimi i Bordit Këshillimor i Biznesit, krijon mundësinë që studentët të njihen me kërkesat e punëdhënësve si dhe të përfitojnë nga programi i nxitjes së punësimit. Evidenca 5.6
Kriteri 4. Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij.	Studentëve të sapoardhur në cdo fillim viti akademik, u jepet informacion i gjerë dhe i detajuar mbi mënyrën e organizimit të procesit mësimor në leksione-seminare-labratore, logjistikën infrastrukturën e FSHMT- sallat e leksioneve-seminareve-laboratorëve dhe shërbimet ndihmëse, si dhe organizimi i praktikave profesionale. Në orarin mësimor pasqyrohen të dhënat e nevojshme. Ai afishohet në tabela e njoftimeve në mjediset e FSHMT dhe u dërgohet studentëve në formë elektronike. Evidenca 4.6, 4.7, 4.13
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distancë.	Nëpërmjet llogarisë personale në platformën EMS, studentët mund të marrin informacion të përditësuar mbi programin e studimit, modulet dhe lëndët, pedagogët përgjegjës dhe rezultatet në provime. Nëpërmjet adresës personale në platformën umed.edu.al, të aksesueshme kudo dhe në cdo kohë, studentët mund të komunikojnë edhe me stafin akademik. Evidenca 4.12 4.13



Konkluzione	UMT, vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit si dhe rezultatet e të nxënës dhe mundësitë e punësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4	
Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilit të studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve, në programin e studimit.	UMT disponon statistika vjetore për numrin e studentëve dhe të diplomuarve në programin e studimit Master i Shkencave në “Logopedi”. Njësitë që i disponojnë këto të dhëna janë Sekretaria mësimore, njësia bazë, si dhe Njësia e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI. Evidenca 4.12
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	UMT dhe FSHMT disponojnë statistika vjetore të sakta për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit Master i Shkencave në “Logopedi”, tërheqet dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të çdo viti akademik. Të dhënat menaxhohen nga sekretaria dhe sistemi EMS. Evidenca 4.12 3.7
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	Sistemi i brendshëm i informacionit në UMT i përfaqësuar nga dy strukturat përkatëse Drejtoria e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe Drejtoria Ekonomike, menaxhon të dhënat statistikore të studentëve. Të dhënat janë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar (sekretaria, pedagogët, IT) të cilët plotësojnë kriteret që përcaktohen nga ligji, për mbrojtjen e të dhënave personale. Evidenca 1.4
Kriteri 4. Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretariatë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e	Sipas RVB dhe nga takimet e zhvilluara në Institucion, njësitë përkatëse të administratës në UMT, si edhe Dekanatit e Departamentit, mbështet me akte përkatëse kontrollin periodik pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin: sekretarinë mësimore, sistemin e menaxhimit të brendshëm të informacionit, duke mundësuar vlerësimin dhe dokumentimin e gjendjes, saktësinë e informacionit dhe dokumentacionit që lidhet me studentët dhe veprimtarinë e tyre. Secili nga aktorët, ka akses në çdo kohë për vlerësimin apo kontrollimin e



informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse.	veprimtarisë administrative apo mësimore. Evidenca 1.4; 3.6, 3.7			
Kriteri 5. Njësia bazë duhet të hartojë raporte analitike, periodike, mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.	Nga takimi në Departament, si dhe të dhënat e RVB, konkludojmë se, Departamenti analizon ecurinë e studentëve nga hyrja në dalje, si dhe harton raporte periodike mbi kalueshmërinë dhe cilësinë. Në sajë të bashkëpunimit që FSHMT ka me MISH, merr të dhëna mbi licensimin dhe punësimin e studentëve. Por kjo e dhënë nuk është e plotë për ALUMNI. Mbi bazën e këtyre treguesve, merren masa për përmirësimin e treguesve cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies. Evidenca:5.7			
Konkluzione	UMT mbledh, administraton, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin dhe profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit Master i Shkencave në "Logopedi", nga pranimi deri në diplomim, si dhe bën përpjeke për grumbullimin e të dhënave mbi punësimin e tyre, të cilat duhet të jenë më të plota dhe më të sakta.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.5	
Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit.	Bazuar në Standardin e UMT, Rregulloren e FSHMT si dhe në aktet ligjore e nënligjore në fuqi, studentëve u garantohej e drejta e përfaqësimit në organet e vendimmarrjes dhe këshilluese, Senatin Akademik, KIZ, KZF, NJSBC, RVB, komisioni i mbarëvajtjes së veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët. Përfaqësuesi studentor, votohet dhe zgjidhet nga vetë studentët. Studentët zgjedhin përfaqësuesin e tyre edhe për Këshillin Studentor. Evidencat: 2.1
Kriteri 2. Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me	Nga takimi me studentët, si dhe nga analiza RVB, GVJ, vëren se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillimin dhe vlerësimin e procesit akademik është reale, konkrete, e verifikueshme dhe e matshme. Me studentët zhvillohen takime me transparencë të plotë dhe studentët ndjehen të vlerësuar. Në pyetësorët që zhvillon periodikisht UMT, një zë i vecantë i takon edhe garantimit të pjesëmarrjes së studentëve në vendimmarrje. Evidenca 2,2 5.8 5.10 2.1; 5.11, 5.12



rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.				
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj.	Duke qënë aktor dhe faktor i rëndësishëm për Departamentin, përmes anketave, pyetësorëve fizikë apo Google Form, departamenti gaaranton përfshirjen e tyre në procesin e hartimit, nënshkrimit dhe përmirësimit të programeve. Evidenca 6.2			
Kriteri 4. Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultetit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	Bazuar në Rregulloren e Studimeve FSHMT, studentët kanë të drejtë të njihen me rezultatet e provimeve, zgjidhjen e tezës, të ankimohen për rivlerësim, të rivlerësohen nga i njëjti komision apo nga komision tjetër. Këto janë hallka të një procesi transparent që aplikohet në Departament. Aktualisht, përdoret vlerësimi në formë shkresore, me teza të sekretuara nga një përfaqësues i Sekretarisë Mësimore. Në kuadër të marrëveshjes për implementimin e CLEAN SCORE, procesi i vlerësimit do të jetë më transparent. Evidenca 1.7, 1.8, 3.4			
Konkluzione	UMT përfshin dhe organizon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit Master i Shkencave në "Logopedi", por vihet re një indiferencë nga ana e studentëve për të qënë të angazhuar dhe kjo dëmton procesin. Duke vendosur ura më të mira komunikimi për rritjen e cilësisë së burimeve dhe shërbimeve ndaj tyre.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.6

Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit.	Në shërbim të informimit të studentëve GVJ konstaton se, UMT ve në dispozicion njësi të posaçme të informimit dhe shërbimit: Zyra e IT, zyra e Financës, Zyra e Kurrikulave, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Këshillimit dhe Karriereës dhe ALUMNI. UMT ve në dispozicion të studentëve rubrikën e transparencës, sipas një programi online të miratuar. Evidenca 1.4, 2.4



Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.	GVJ vëren se, informimi, këshillimi dhe ndjekja e përparimit të studentëve është kompetencë dhe detyrim i Shefit të Departamentit dhe pedagogëve të moduleve përkatëse. Gjithashtu sistemi EMS vihet në dispozicion për të gjithë studentët. Evidenca 4.12; 2.12			
Kriteri 3. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.	UMT u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës, nëpërmjet Zyrës së Këshillimit e Karrierës dhe ALUMNI. Studentët informohen dhe orientohen për kompletimin e procesit mësimor, për praktikën profesionale dhe tregun e punës. Evidenca 1.4, 2.4			
Kriteri 4. Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.	UMT u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës, nëpërmjet Zyrës së Këshillimit e Karrierës dhe ALUMNI. Studentët informohen dhe orientohen për kompletimin e procesit mësimor, për praktikën profesionale dhe tregun e punës. Evidenca 1.4, 2.4			
Konkluzione	UMT ka procedura dhe njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, si edhe menaxhimin e problematikave. Këto njësi janë të përherëshme dhe lehtësisht të arritshme nga studentët.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht X
---	----------------	-----------------------	----------------------	----------------------------



VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi VI.1				
Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve.	Në përshtatjen me kërkesat e kohës, UMT harton udhëzues që nxisin zhvillimin me mjete të tilla si: Mësimdhënia në distancë, apo të mësuarit me qëndër studentin, përdorimi i mjeteve bashkëkohore dhe metodave inovative janë bërë praktikë edhe në Programin e Studimit Master i Shkencave në “Logopedi”. Evidenca 6.1			
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.	Dekanati i FSHMT, si dhe njësitë përkatëse të vlerësimit dhe monitorimit të personelit akademik dhe ndihmës akademik si Drejtoria e Kurrikulave dhe e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, bëjnë të mundur që përmes pyetësorve apo pjesmarrjes në veprimtari kërkimore-shkencore, vlerësojnë periodikisht mbi metodat inovative që aplikohen gjatë procesit mësimor. Evidenca 6.2, 5.10, 5.11			
Kriteri 3. Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve, përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.	UMT, në nivel institucional ka ngritur Sektorin e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili bazuar në ligj dhe aktet nënligjore, harton pyetësorin e studentëve për matjen e performancës, për cilësinë e mësimdhënies në cdo program studimi. Kjo njësi mbështetet edhe nga Komisioni i Përhershëm i Sigurimit të Cilësisë, një anëtar i të cilit është student, në nivel Universiteti e Fakulteti. Evidenca 1.1, 5.10, 5.11			
Kriteri 4. Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.	Pyetësori i përgatitur nga Sektori i Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë, i plotësuar nga studentët në cdo fund semestri, analizohet nga strukturat përgjegjëse. Raporti publikohet edhe në faqen zyrtare të UMT. Evidenca 6.2, 1.3; 1.3.1			
Kriteri 5. Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.	Bazuar në RVB, dhe takimet në institucion, UMT, në vecanti NjSBC, vlerëson rezultatet e përfuara nga pyetësorët, raportin e analizës vjetore të fakultetit dhe universitetit dhe bën publikimin në faqen zyrtare të UMT. Veprimtaritë dhe praktikat më të mira si leksione të hapura, ë orkshope, aktivitete të tjera i publikon si modele në faqen zyrtare. Evidenca 6.2			
Konkluzione	UMT ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X



Standardi VI.2

Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.	Për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe me aktet rregullatore institucionale, UMT ka hartuar rregulloren, në të cilën përcaktohen rregullat për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përhershëm për garantimin e Standardeve të Cilësisë. Evidenca 1.1 1.3; 1.3. 5.16
Kriteri 2. Institucioni ka të ngritur, mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.	Në përputhje me Standardet Shtetërore të cilësisë, të parashikuara në Kodin e Cilësisë së Arsimit të Lartë, si dhe në aktet e tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë elementet e programeve të studimit të ofruara nga UMT, është ngritur dhe funksionon Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë, i përbërë nga anëtarë të personelit akademik dhe studentë, i cili ka për qëllim garantimin e Standardeve të Cilësisë së UMT dhe Programeve të Studimit. Evidenca 6.8, 1.1, 1.3
Kriteri 3. Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë në programin e studimit.	GVJ, gjen se, Sigurimi i brendshëm i cilësisë realizohet nëpërmjet procesit të vlerësimit të brendshëm institucional ose të programeve të studimit. Instrumentat e përdorur janë pyetsorët për vlerësimin e studentëve, anëtarëve të stafit akademik, vetëvlerësimi i pedagogëve e cilësisë së mësimdhënies dhe të nxënies. Për sigurimin e vlerësimit të jashtëm të cilësisë, UMT bashkëpunon me ASCAL për vlerësimin e programeve të vecanta apo edhe në rang institucioni. institucional. Në vlerësimin e fundit është akredituar maksimalisht me 6 vite Evidenca 1.6 Certifikata e Akreditimit Institucional; 6.6 Raporti i vetëvlerësimit për akreditimin Institucional; 6.8 Rregullore e NjSBC.
Kriteri 4. Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për	UMT, nëpërmjet NjSBC, si njësi e posaçme përdor tregues të qartë dhe të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim. NjSBC mbikqyr hartimin e programeve dhe planeve mësimore, disiplinave mësimore, si dhe harmonizimin e tyre. Periodikisht rishikohen dhe përmirësohen programet ekzistuese. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime për arritjet më të mira. Evidencat: 6.2

arritjet më të mira në programin e studimit.				
Konkluzione	UMT harton dhe zbaton politika dhe procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit Master i Shkencave në "Logopedi" në kuadër të strukturave të sigurimit të brendshëm të cilësisë.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.3

Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programin e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen periodike të programit të studimit të ciklit të dytë, që i shërbejnë akreditimit të tij. Në këtë proces realizon evidentimin e arritjeve dhe dobësive, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe planin e masave për përmirësim. Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	Në UMT zhvillon aktivitetin e vet, Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë, e cila mbulon aspektet kurrikulare dhe ato të sigurimit të cilësisë në përputhje me aktet ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe me Statutin e UMT. Kjo njësi orienton, monitoron dhe vlerëson programet e studimit. Rezultatet e vlerësimit të cilësisë përfshihen në Raportin Vjetor të FSHMT dhe UMT. Evidenca 1.12
Kriteri 2. Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit, motivimin e praktikave dhe arritjeve më të mira, dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë, si dhe motivimin e arritjeve më të mira në mësim dhe kërkim nga personeli akademik dhe studentët.	Sipas RVB, Departamentet e FSHMT dhe Dekanati i FSHMT, në fund të vitit akademik, përgatisin analizën vjetore të fakultetit të cilën ja dërgojnë Senatit të UMT. Komunikimi i këtij informacioni në Senatin Akademik krijon mundësi të mirë për të përmirësuar dhe garantuar rritjen e cilësisë së programeve të studimit. Evidenca 1.12, 1.12.1 1.12.2

Kriteri 3. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor, metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës, testime lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testime ndërinstitucionale apo kombëtare, si: provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.	Bazuar në Rregulloret dhe Strukturat përkatëse, UMT përdor metoda të drejtpërdrejta për vlerësimin dhe mbarëvajtjen e cilësisë së programit. Instrumentat dhe metodat e përdorura nga NjSBC, Zyra e Marrëdhënieve me Jashtë, Zyra e Këshillimit dhe Karrierës, si dhe Departamenti janë vlerësimi i cilësisë së mësimdhënies, vlerësimi i didaktikës, kurrikulës, vëzhgime në auditor. Në RVB përmendet se ka vlerësime paralele, por ne nuk kemi evidencë për to. Në departament zhvillohen orë të hapura, çka flet për përpjekjen në rritjen e cilësisë së mësimdhënies. Evidenca 1.4,1.7, 1.8,1.15			
Kriteri 4. Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi, si: sondazhe e intervista të studentëve, të atyre të diplomuar (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.	Ndër metodat e instrumentat e tërthortë që përdor UMT për vlerësimin e cilësisë, në RVB, por edhe nga takimet në Institucion përmendet kryerja e pyetësorëve anonimë , rezultatet e të cilave përpunohen nga Sektori i Kurrikulave dhe i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe rezultatet pasyrohen në Raportin Final. ALUMNI mbledh të dhëna në mënyrë periodike, por ky burim ngelet të përmirësohet në të ardhmen. Evidenca 6.2			
Konkluzione	UMT monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme, programin e studimit Master i Shkencave në “Logopedi”, me qëllim që të garantojë arritjen e objektivave formues dhe të rezultateve të pritshme të të nxënës.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Standardi VI.4 Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin akademik e studentët në proceset e SBC-së të programit të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni duhet të parashikojë dhe të garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuara për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit.	FSHMT ka njësinë e tij përkatëse të SBC, e cila përbëhet nga pesë anëtarë: katër anëtarë vijnë nga personeli akademik dhe njëri anëtar është përfaqësues i studentëve. Anëtarët e komisionit, përfaqësues të Universitetit, vetëkandidohen dhe zgjidhen nga Senati Akademik i UMT, me një mandate dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje. Evidenca 6.8
Kriteri 2. Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.	Bazuar në Rregulloren e UMT dhe NjSBC, çdo department ka përfaqësuesin e vet në NjSBC, i cili ka detyrë adresimin konkret të problematikave të njësisë bazë. Komunikimi me studentët realizohet drejtpërdrejt si komunikim pedagog-student, apo indirekt falë pyetësorëve periodikë, të cilët shpërndahen për studentët në periudhën Janar-Qershor të çdo viti akademik. Evidenca 1.4, 6.8, 6.7
Kriteri 3. Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohej përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentëve të programit të studimit.	Kuadri ligjor garanton dhe kërkon përfshirjen e Departamentit dhe të anëtarëve të FSHMT në procesin e sigurimit të cilësisë. Evidenca 1.1, 1.4, 2.4, 6.8
Kriteri 4. Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.	Në RVB citohet, se procedura e vlerësimit të brendshëm i nënshtrohet Kodit të Etikës, të miratuar në UMT. Parimi bazë që udhëheq procesin e vlerësimit është respektimi i integritetit akademik dhe shmangia e çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve. Në UMT është ngritur një strukturë e posaçme në mbrojtje të të drejtave të studentëve. Evidenca 6.5, 2.4
Kriteri 5. Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë, duhet të bëhen edhe	NjSBC administron, organizon dhe përkatit vizita të vlerësimit të jashtëm ose fton ekspertë të jashtëm për të trajnuar stafin që merret me vlerësimin e brendshëm. Në kuadrin e vlerësimit institucional dhe akreditimit të programeve të studimit, janë zhvilluar takime me ekspertë ndërkombëtarë

bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	dhe vendas të përzgjedhur nga ASCAL dhe Bordi i Akreditimit. (Evidencat: https://www.umed.edu.al njoftime.un...akreditimit-institucional)			
Konkluzione	UMT përfshin njësitë akademike, personelin akademik dhe studentët në proceset e SBC dhe informon për rezultatet, palët e interesuara në këtë proces.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi VI.5

Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë që UMT organizon në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë përmbledhen në Raportin vjetor, të cilin UMT e publikon për të gjithë të interesuarit përfshirë edhe studentët. Evidenca 6.2
Kriteri 2. Institucioni i arsimit të lartë publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.	Rezultatet e vlerësimit të programeve të studimit përmbledhen në raportin vjetor përfundimtar, që NjSBC ia përciell Rektorit dhe Senatit Akademik për veprime të mëtejshme. Përmbledhja e Raportit publikohet pa emra konkretë mbështetur mbi ligjin për mbrojtjen e të dhënave personale. Problematikat e evidentuara analizohen dhe diskutohen në mbledhjen e Senatit Akademik, për të adresuar zgjidhjet specifike. Evidenca 6.2, 6.5
Kriteri 3. Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.	Raporti vjetor i NjSBC të FSHMT, si dhe plan-masat e sugjeruara nga Fakulteti, si pjesë e raportit të UMT, diskutohen në Senatin Akademik, i cili nxjerr vendim me masat dhe rekomandimet përkatëse në drejtim të përmirësimit të cilësisë. Evidenca 6.2; 6.6
Kriteri 4. Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe ndikimin e veprimtarive në	UMT nëpërmjet strukturave të veta, Senatit Akademik dhe Bordit të Administrimit siguron efektivitetin e veprimtarive. NjSBC vlerëson periodikisht rezultatet e veprimtarive mësimore e shkencore dhe harton



kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.	raportet përkatëse të Vlerësimit të Brendshëm. Të dhënat e Vlerësimit përdoren për përmirësimin e cilësisë së programit të studimit, përmirësimin e shërbimeve dhe performancës së personelit akademik e ndihmës akademik, për planifikimin vjetor e strategjik. Evidenca 6.6; 6.2			
Kriteri 5. Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.	NjsBC organizon takime periodike me anëtarët e saj, stafi dhe studentët e interesuar njihen me konkluzionet e takimeve, ndërkohë që UMT ka zhvilluar takime me përfaqësues të ASCAL, duke mundësuar informimin dhe ndërgjegjësimin e personelit dhe studentëve, për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programeve të studimit dhe konkretisht të programit Master i Shkencave në “Logopedi”. Evidenca: 6.8			
Konkluzione	UMT harton dhe kryen politika, procese dhe veprimtari për sigurimin e brendshëm të cilësisë për programin e studimit Master i Shkencave në “Logopedi” të cilat janë publike transparente dhe efektive, me synimin e krijimit të kulturës së brendshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X




Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të dytë Master i shkencave në “Logopedi” të ofruar nga Institucioni i Arsimit të Lartë Universiteti i Mjekësisë Tiranë

Pikat e forta dhe afirmime:

1. Programi i studimit Msc në Logopedi i hartuar, është në përputhje të plotë me qëllimet dhe misionin e institucionit UMT dhe fushës së veprimtarisë së FSHMT sipas akteve ligjore dhe rregullatore të IAL.
2. Programi Msc në Logopedi u mundëson studentëve aftësi profesionale të përparuara në trajtimin e situatave mjekësore logopedike, njohjen e teknikave dhe metodave të ndryshme rehabilituese për trajtimin e grupmoshave të ndryshme të pacientëve.
3. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie në programin Msc. në Logopedi ka përgatitje profesionale pedagogjike dhe eksperiencë mjekësore në lëndët që zhvillon.
4. Institucioni mbështet studentët në zhvillimin e ideve të tyre inovative apo realizimin e punimeve të ndryshme duke ju vënë në dispozicion laboratorët, bibliotekën e FSHMT apo sallat e kompjuterave të fakulteteve të tjera brenda UMT dhe asistencën nga stafi akademik.
5. UMT dhe FSHMT kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi për mobilitetin e pedagogëve dhe studentëve në kuadër të programit ERASMUS, si dhe një sërë projekte ndërkombëtare në funksion të edukimit dhe kërkimit shkencor.
6. Për realizimin e praktikave profesionale angazhohen mjekë logopedistë nga qendra spitalore.
7. Raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe përafron me programe të ngjashme ndërkombëtare.
8. Për përmirësimin e programit të studimit, gjatë orëve mësimore pedagogët e lëndëve diskutojnë si dhe konsultohen me studentët për të marrë mendimin e tyre në lidhje me përmirësimin e metodologjisë së mësimdhënies dhe përditësimin e literaturës së caktuar.
9. UMT disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional, i cili edhe në sajë të dixhitalizimit, vihet në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ, për programin e studimit Master i Shkencave në “Logopedi”.

Pika të dobëta:

1. Mungesa e stafit me kohë të plotë me kualifikim në fushën e Logopedisë, e cila është një problematikë në të gjithë sistemin arsimor në vendin tonë
2. Në një pjesë të syllabuseve nuk paraqitet kodi i lëndës, tipologjia e lëndës, nuk paraqiten vërejtjet përfundimtare nga pedagogu i lëndës dhe në disa lëndëve duhet të përmbahen literaturës së 5 viteve të fundit.
3. Fakulteti ka mundësi të limituara financiare të mbështesë studentët për mobilitete jashtë vendit ose të ftojë studentë të huaj për periudha të shkurtra kohore.



Rekomandime:

1. GVJ rekomandon të rishihet mundësia rritjes së personelit akademik me kualifikim në fushën e Logopedisë.
2. Sugjerojmë ofrimin e mundësive financiare për mbështetjen e studentëve në mobilitete jashtë vendit ose studentë të huaj për periudha të shkurtra kohore.
3. Sugjerojmë shtimin e kapaciteteve strukturore dhe laboratorike për të ecur paralel me kërkesat në rritje për këtë program studimi.
4. Sugjerojmë që në një pjesë të syllabuseve të paraqitet kodi i lëndës, tipologjia e lëndës, të paraqiten vërejtjet përfundimtare nga pedagogu i lëndës.
5. Sugjerojmë përditësimin e literaturës së disa lëndëve të ofruara e cila duhet ti përmbahet 5 viteve të fundit.




Conclusions of the Evaluation of the study program of the second cycle Master of Science "Speech Therapy" offered by the Institution of Higher Education University of Medicine, Tirana.

Strengths and Affirmations:

1. The Master of Science study program in Speech Therapy is fully in line with the goals and mission of the institution and the field of activity of the FSHMT according to the legal and regulatory acts of the HEI.
2. The Program in Speech Therapy provides students with advanced professional skills in the treatment of speech therapy medical situations, knowledge of various rehabilitation techniques and methods for the treatment of different age groups of patients.
3. Academic personnel engaged in teaching in the Master of Science program in Speech Therapy he has professional pedagogical training and medical experience in the subjects he develops.
4. The institution supports students in the development of their innovative ideas or the realization of various works by making available to you the laboratories, the library of FSHMT or the computer rooms of other faculties within UMT and the assistance of the academic staff.
5. UMT and FSHMT have signed a cooperation agreement for the mobility of lecturers and students within the ERASMUS program, as well as a series of international projects in the function of education and scientific research.
6. For the realization of professional practices, speech therapists from the hospital center are engaged.
7. The theory-practice report is consistent with the profile of the study program and aligns with similar international programs.
8. For the improvement of the study program, during the lessons the lecturers of the subjects discuss and consult with the students to get their opinion regarding the improvement of the teaching methodology and the updating of certain literature.
9. UMT has an internal institutional management system, which thanks to digitization, is available for administration, information and monitoring of academic, financial and administrative activity for the Master of Science in "Speech Therapy" study program.

Weak Points:

1. Lack of qualified full-time staff in the field of speech therapy, which is a problem in the entire educational system in our country



2. In some of the syllabuses, the subject code, the typology of the subject, the final remarks of the subject lecturer are not presented, and in some subjects, the literature of the last 5 years should be kept.

3. The faculty has limited financial opportunities to support students for mobility abroad or to invite foreign students for short periods of time.

Recommendations:


1. GVJ recommends to revisit the possibility of increasing the academic staff with qualification in the field of Speech Therapy.

2. We suggest providing financial opportunities to support students on mobility abroad or foreign students for short periods of time.

3. We suggest the addition of structural and laboratory capacities to keep up with the growing demands for this study program.

4. We suggest that in a part of the syllabuses, the subject code, the typology of the subject, and the final remarks by the subject teacher are presented.

5. We suggest updating the literature of some courses offered, which should be contained within the last 5 years.



Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Nuk përmbushen	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË CIKLIT TË DYTË				X
III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT				X
IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE				X
VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT TË STUDIMIT				X
VLERËSIMI TËRËSOR				X